



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

Regjimi pasuror i bashkëshortëve në Republikën e
Maqedonisë së Veriut dhe në të drejtën Evropiane

Kandidati:

Bardhyl Limani

Mentor:

Prof.Dr.Emine Zendeli

Tetovë, 2020

Deklaratë

Me anë të kësaj deklarate unë Bardhyl Limani deklaroj me përgjegjësin më të lartë se jam autor i këtij disertacioni, puna e raportuar këtu ka përbërje tërësisht origjinale dhe nuk përmban punën e personave të tjerë pa u cituar. Bibliografia e shënuar përmban të gjithë literaturën që kam përdorur në shkrimin e disertacionit, dhe se të gjitha referencat i referohen kësaj bibliografie. Informacini i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekstë dhe referencat janë shënuar në listen e burimeve. Unë e kuptoj që çdo shkelje e këtyre rregullave do të konsiderohet mashtrim dhe do të ketë pasoja juridike.

Po ashtu, vërtetoj se disa pjesë të këtij punimi janë botuar nga unë në një konferencë me karakter rajonal organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Evropës Juglindore më temë: “E drejta, drejtësia dhe sfidat e reformimit të sistemit juridik në epokën e globalizimit”.¹

¹ <https://drive.google.com/file/d/1nsAcYcuUigJM8MIbNtDxH2MUBsCrTiBw/view>

Falënderim

Kam nderin dhe kënaqësinë, që me këtë rast të shpreh falënderimet e thella dhe të sinqerta për të gjithë profesorët e fakultetit juridik të Universitetit të Evropës Juglindore, për përkrahjen dhe mbështetjen që më kanë dhënë në rrugëtimin tim, si gjatë studimeve deridiplomike po ashtu edhe në studimet pasdiplomike, ndërsa një falënderim i veçantë shkonë për mentoren time Prof.Dr. Emine Zendeli për këshillat, udhëzimet, komentet dhe drejtimin që më dha që nga përzgjedhja e tezës e deri në përfundimin e tezës së masterit.

Falënderim i veçantë shkon për familjen time e cila më ka mbështetur dhe më kanë përkrahur tanë kohës e posaçërisht babain tim nga i cila kam marrë këshillat dhe ligjëratat më të rëndësishme të jetës. Së fundi, falënderimet e mia të sinqerta shkojnë për shoqen time të jetës, e cila është përkrahëse e rrugimit tim akademik, duke më motivuar dhe ndihmuar në çdo moment.

Abstrakt

Në këtë punim të magjistraturës në fillim do të trajtohen njohuri të përgjithshme mbi martesën dhe të drejtat dhe detyrimet pasurore të cilat dalin prej saj, regjimin ligjor dhe atë subsidiar, pasurinë e veçantë dhe të përbashkët, administrimin dhe disponimin e pasurisë. Më pastaj në mënyrë të detajuar do të elaborohet regjimi pasuror ligjor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke filluar nga përkufizimi i pasurisë së përbashkët dhe asaj të veçantë, administrimi dhe disponimi me pasurinë e veçantë dhe pasurinë e përbashkët, përparsitë e regjimit ligjor të RMV-së dhe mangësitë e tij, mirëpo për të pasur një pasqyrë më të qartë do të analizohet dhe studiohet edhe zhvillimin historik i marrëdhënieve juridiko-pasurore të bashkëshortëve që nga fillimet e tija e deri më sot. Kujdes të veçantë do t'i kushtohet edhe regjimeve subsidiare (kontraktore) të shteteve Evropiane pasi që ky punim do të ketë edhe studim komparativ të regjimit ligjor të Republikës së Maqedonisë së Veriut me regjimet ligjore të shteteve evropiane duke përfshirë shtete të sistemit kontinental por edhe të sistemit anglo-sakson apo common law. Poashtu do të analizohet edhe kontrata martesore si rregullator, jo vetëm i marrëdhënieve juridiko-pasurore të bashkëshortëve, por edhe i marrëdhënieve juridiko-familjare në përgjithësi, gjatë martesës por edhe në rastë të shkurorëzimit.

Autori beson se puna e tij do të jep një kontribut të rëndësishëm shkencor drejtë reformimit të legjislacionit për pronësi dhe të drejta tjera sendore që trajton marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në RMV dhe harmonizimit me legjislacionet Evropiane, si dhe të arrijë të ndikojë në shoqëri që të shmangen mendimet pesimiste se me lidhjen e kontratës martesore, bartet esenca e marrëdhënieve bashkëshortore nga marrëdhëniet personale(emotive) në ato pasurore.

Fjalët Kyçe: *Regjimi Ligjor, Regjimi subsidar(kontraktor), Pasuria e përbashkët, Pasuria e veçantë, Administrimi dhe Disponimi me pasurinë, Kontrata Martesore.*

Tabela e përmbajtjes

Deklaratë	2
Falënderim.....	3
Abstrakt	4
Tabela e përmbajtjes.....	5
Tabela e grafikoneve	8
Hyrje.....	9
Kapitulli-I	11
1.Martesa	11
2.Marrëdhëniet martesore	15
2.1.Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve	15
2.1.1. Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve për të cilat nuk mund të lidhet marrëveshje.....	16
2.1.2. Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve për të cilat mund të lidhet marrëveshje	16
2.2.Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve.....	17
2.2.1. Të drejtat dhe detyrat pasurore-personale të bashkëshortëve	17
2.2.2. Të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve.....	18
3.Regjimi pasuror	19
4.Regjimi pasuror ligjor	20
4.1 Pasuria e veçantë e bashkëshortëve.....	22
4.2 Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve	23
4.2.2. Administrimi dhe disponimi me pasurinë	25
4.3. Partnerët jashtëmartesor	27
5. Regjimi pasuror i kontraktuar (subsidiar)	28
Kapitulli i II.....	29
1.Regjimi pasuror i bashkëshortëve në të drejtën e Republikës së Maqedonsië së Veriut	29
1.1. Aspekti historik i rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në RMV deri në nxjeren e ligjiti për pronësi dhe të drejta tjera sendore të vitit 2001	30
1.1.1. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve deri në nxjeren e ligjit për martesë nga Republika Popullore Federative e Jugosllavisë në vitin 1946	31
1.1.2. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me “Ligjin për martesë” të vitit 1946	35
1.1.3. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me “Ligjin për martesë” të vitit 1973	36
1.1.4. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me “Ligjin për familje” të vitit 1992	38

2.Regjimi pasuror ligjor i bashkëshortëve – sipas Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore 2001.	38
2.1.Pasuria e veçantë	39
2.2.Pasuria e përbashkët.....	40
2.2.1.Kushtet e krijimit të pasurisë së përbashkët.....	41
2.2.2.Objekt i pasurisë së përbashkët.....	42
2.3.Administrimi dhe disponimi me pasurinë e veçantë dhe me pasurinë e përbashkët	43
2.4.Pushimi i pasurisë së përbashkët dhe ndarja e saj	45
4.3. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me personat e tretë	47
3.Kontratat pasurore të bashkëshortëve.....	47
4.Marrëdhëniet juridiko-pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesorë.....	48
Kapitulli-III	49
1.Rregullimi i marrëdhënieve juridiko-pasurore të bashkëshortëve në të drejtën evropiane.....	49
2. Aspektet krahasuese të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në sistemet juridike bashkëkohore.....	51
2.1. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik Gjerman	52
2.1.1. Regjimi i bashkësisë së vlerës së shtuar (ose siç njihet ndryshe edhe si regjim i prolonguar i pasurisë së përbashkët) – regjim ligjor	53
2.1.2. Regjimi i pasurisë së ndarë – regjim kontraktor (subsidiar)	54
2.1.3. Regjimi i pronësisë së përbashkët – regjim kontraktor (subsidiar)	54
2.2. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik Francez.....	57
2.2.1. Bashkësia e pasurisë së krijuar - regjimi pasuror ligjor.....	58
2.2.2. Bashkësia e të mirave pasurore – Regjim kontraktor (subsidiar)	60
2.2.3. Regjimi i pasurisë së ndarë – regjim kontraktor (subsidiar)	61
2.2.4. Regjimi i vlerës së shtuar – regjim kontraktor (subsidiar)	62
2.3. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik Anglez	63
Kapitulli - IV	68
1.Kontrata Martesore	68
1.1. Dallimi në mes Kontratës paramartesore dhe kontratës martesore.....	69
2. Elementet thelbësore të përgjithshme të kontratës martesore	70
2.1. Zotësia e palëve për lidhjen e kontratës martesore	71
2.2. Pëlqimi i vullnetit	71
2.3. Objekti i kontratës martesore.....	72
2.4. Forma e kontratës martesore	74
3.Anët pozitive dhe negative të kontratës martesore.....	75
3.1. Kontrata martesore konsideohet si ide e mire për tu lidhur – avantazhet e kontratës martesore.....	76

3.2. Kontrata martesore nuk konsideohet ide e mire për tu lidhur – disavantazhet e kontratës martesore.....	77
4.Përpunimi i të dhënave të fituara nga anketa e realizuar me qytetarët	79
Përfundimi dhe Rekomandimet.....	91
Biblografia	96
Shtojcë	101

Tabela e grafikoneve

Grafikoni 1 - Moshë e të anketuarve	79
Grafikoni 2- Gjinia e të anketuarve	80
Grafikoni 3- Statusi Martesor i të anketuarve	81
Grafikoni 4- Regjimi pasuror i bashkëshortëve.....	81
Grafikoni 5- Ndarja e pasurisë së përbashkët në mes bashkëshortëve.....	82
Grafikoni 6- Situata kurrë bashkëshorti fiton më tepër se gjysa e pasurisë.....	83
Grafikoni 7- Interesimi për pjesët e pasurisë martesore	84
Grafikoni 8- Menaxhimi me pasurin gjatë martesës.....	84
Grafikoni 9- Disponimi me pasurin pa lejen e njërit bashkëshortë	85
Grafikoni 10- Kontrata martesore.....	86
Grafikoni 11- Kontrata martesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut	86
Grafikoni 12- Me lidhjen e kontratës martesore, a humbet lidhja emocionale dhe i jepet rëndësi asaj pasurore	87
Grafikoni 13- Lidhja e kontratës martesore	88
Grafikoni 14- Arsye për të mos lidhurë kontratë martesore	89
Grafikoni 15- Shkaqet për të cilat lidhet kontrata martesore	90

Hyrje

Familja si dukuri shoqërore e ka shoqëruar njerëzimin që nga fillimet e tij, e deri në ditët tona, për këtë arsye, familja përbën njësinë bazë të shoqërisë dhe shtetit.² E drejta Familjare është një nga fushat më të rëndësishme të së drejtës civile, respektivisht të së drejtës private. Ajo rregullon marrëdhëniet familjare, të cilat paraqesin bazën e shoqërisë. Duke pasur parasysh se marrëdhëniet familjare janë në zhvillim të hovshëm, është mirë të analizohet njëri ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës familjare i cili është *Martesa*, e që nënkupton bashkësi jetësore e një burri dhe një gruaje e rregulluar me ligj, në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. së Martesa është një bashkësi jetësore në të cilën marrëdhëniet juridike ndërmjet bashkëshortëve themelohen në bazë të vullnetit të lirë, në bazë të barazisë, respektit reciprok dhe ndihmës së ndërsjelltë ndërmjet burrit dhe gruas.

Pasi që martesa është bashkësi jetësore ajo njëkohësisht është edhe bashkësi ekonomike, ku bashkëshortët sjellin të mira materiale të fituara më parë të cilat i kanë poseduar në momentin e krijimit të bashkësisë martesore, por edhe krijojnë të mira materiale gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore. Pasuria të cilën e krijojnë bashkëshortët gjatë martesës është rrezultat i punës dhe jetës së përbashkët të bashkëshortëve, prandaj është shumë me rëndësi që të caktohet rrethi i të drejtave dhe obligimeve të bashkëshortëve në raport me të. Absolutisht, shikuar nga pikëpamja morale dhe fetare, askush nuk lidh martesë për ta shkëputur atë më vonë po ashtu askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në marrëdhëniet e tyre ose të tentojë ti ndajë bashkëshortët, por në jetën e përditshme përballemi me sfida nga më të ndryshmet të cilat disa martesa nuk arrijnë t'i rezistojnë dhe t'i tejkalojnë, për këtë arsye është parashikuar instituti i të drejtës familjare i njohur si “Zgjidhja e Martesës”.

Në momentin e zbatimit të këtij instituti “zgjidhjes së martesës”, vjen deri tek situata e ndarjes së pasurisë së krijuar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore, ku jo çdoherë çiftet këtë problematikë e zgjidhin me marrëveshje, por në të shumtën e rasteve kjo çështje është tepër e ndërlikuar dhe problematike pasi në momentin që

² Spirovik Trpenovska, Liljana, Dejan Mickovik & Angel Ristov: “Semejno pravo”, Shkup 2013 fq.73-74

prishet harmonia ndërmjet bashkëshortëve, pra kur acarohen marrëdhëniet në mes bashkëshortëve çështja e ndarjes së pasurisë së krijuar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore bëhet shumë serioze, ku procedurat gjyqësore zgjasin jo me muaj por me vite të tëra. Kjo situatë është shumë aktuale në shtetin tonë, ku sistemi gjyqësor është jo efektiv dhe jo efikas, ku gjithashtu nuk mungon edhe korrupcioni. Ndërsa sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i atill që të gjithë bashkëshortët aktual dhe ato të ardhëshëm i detyron që ti nënshtrohen regjimit pasuror ligjor, pra nuk ju ofron mundësi tjetër bashkëshortëve, por i detyron me norma imperative, të cilat norma në situatat e shkurrorëzimit të martesës në të shumtën e rasteve janë të komplikuar dhe të padëshiruara për bashkëshortët mes të cilëve harmonia martesore ka marrë fund.

Duke pasur parasyshë që sot ndodhemi në epokën kapitalizimit ku çdo individ gëzon kapitalin e tij, thënë më saktë çdonjëri nga bashkëshortët ka pasurinë e vetë me të cilën administron dhe disponon vetë, për këtë shkak rregullimi i marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve ka rëndësi të veçantë, marrë parasysh edhe jetën dinamike ku të ardhurat pasurore nuk janë statike, por të ndryshueshme, pra të drejtat pronësore apo pasuria e bashkëshortëve mund të ndryshojnë, pasi që numri më i madh i tyre zhvillojnë veprimtari të ndryshme që sjellin të ardhura financiare të larta.

Në këtë studim do të shtjellohet rëndësia e marrëdhënieve juridiko-pasurore duke analizuar regjimin pasuror ligjor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, filluar nga ajo se çka është pasuri e përbashkët e çka pasuri e veçantë, administrimi dhe disponimi me pasurinë e veçantë dhe pasurinë e përbashkët. Gjithashtu do të shprehen pikëpamjet për regjimin pasuror ligjor, si dhe për atë që siguron barazinë gjinore ndërmjet burrit dhe gruas. Kujdes të veçantë do t'i kushtohet nevojës që në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të parashihen edhe regjime subsidiare apo plotësuese, të cilat do t'ju mundësonin bashkëshortëve që marrëdhëniet e tyre pasurore t'i rregullojnë ndryshe nga regjimi ligjor, duke sqaruar regjimet subsidiare të analizuar nga shtetet evropiane të cilat u ofrojnë bashkëshortëve mbi 2-3 regjime subsidiare. Po ashtu do të analizohet edhe kontrata martesore si rregullator, jo vetëm i marrëdhënieve juridiko-pasurore të bashkëshortëve po edhe i marrëdhënieve juridiko-familjare, gjatë martesës por edhe në rast të shkurrorëzimit.

Përzgjedhja e kësaj teme është bërë duke pasur parasysh faktin që dita ditës numri i shkurorëzimeve rritet. Martesa klasike e ka humbur efektin e vetë në të cilën gjithçka ka poseduar dhe ka administruar burri, ndërsa gruaja e cila ka pasur rrolin e amvises, nuk ka pasur të ardhura financiare dhe në rastet e shkurorëzimit gjithçka i ka takuar burrit.

Kapitulli-I

1.Martesa

Fjala "martesë" rrjedh nga Latinishtja, "marītāre" që do të thotë të sigurojë një burrë ose grua dhe "marītāri" që do të thotë të martohesh, pastaj nga "marriage" e Anglisë së Mesme, e cila u shfaq për së pari herë në vitet 1250-1300, dhe në fund, kjo rrjedh po ashtu nga frëngjishtja e vjetër, "mariere" (për tu martuar).³ Në vitin 1866 Hyde v Hyde dha një përkufizim për martesën: Martesa është një bashkimi vullnetar i një burri ndaj një gruaje, për tanë jetën deri në përjashtimin e të gjith tjerëve., ky përkufizim nuk është as një përshkrim adekuat dhe as një pasqyrim i saktë i asaj që është martesa sot⁴.

Martesa është një ndër institucionet më të lashta e gjithsesi më i rëndësishëm shoqëror dhe juridik⁵, po ashtu paraqet një institucion kompleks dhe dinamik.⁶ Konsiderohet institucion shoqëror pasi është formë e organizimit shoqëror, ndërsa institucion juridik pasi që krijonë të drejta dhe detyrime për personat që lidhin martesë.⁷ Martesa ndryshe konsiderohet si një bashkim i njohur kulturor midis njerëzve të quajtur bashkëshortë, ku vendos të drejta dhe detyrime midis tyre, po ashtu ndërmjet tyre dhe fëmijëve të tyre apo të adoptuarve të tyre.

Kur përcaktohet gjerësisht martesa konsiderohet si një kulturë univerzale, pasi që është pjesë më e rëndësishme e së drejtës familjare e cila rregullon marrëdhëniet të cilat krijohen me rastin e lidhjes së martesës si dhe pasojat të cilat mund të paraqiten në rastin e shkurorëzimit të martesës. E drejta martesore i rregullon: kushtet, formën dhe marrëdhëniet pronësore të bashkëshortëve martesor, si dhe pasojat juridike në rast të shkurorëzimit të martesës.

³ Marriage, Wikipedia – (parë me 01.12.2019)- <https://en.wikipedia.org/wiki/Marriage>

⁴ Mary Welstead, Susan Edwards: "Family Law" 4th Edition – Oxford 2013, fq.17.

⁵ Marina Janjic-Komar, Radoje Korac, Zoran Ponjavic: "Porodico pravo" – Beograd 1999, fq.73

⁶ Jens M. Scherpe: "European Family Law" Volume III – Cheltenham 2016, fq.38

⁷ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi: "E drejta Familjare" – Prishtinë 2007, fq.83

Martesa për ne është status, themelimi dhe shkëputja e të cilës rregullohet me ligj, dhe nga e cila dalin të drejta dhe detyrime jo vetëm për partnerët, por ka reflektimin e vetë edhe ndaj personave tjerë.⁸ Krahasuar me martesat e mëhershme, ku martesa më tepër kishte karakter social dhe ligji thuajse nuk kishte aspak efekt në rregullimin juridik të martesës. Përkufizimi i martesës ndryshon në të gjithë botën, jo vetëm mes kulturave dhe mes feve të ndryshme, por edhe gjatë gjithë historisë së ndonjë kulture ose feje të caktuar, duke evoluar si për tu zgjeruar ashtu edhe për tu ngushtuar në atë se kush, si rregullohet dhe çfarë përfshihet. Në disa kultura, martesa rekomandohet ose konsiderohet e detyrueshme përpara se të krijohet ndonjë marrëdhënie ndërmjet personave të gjinis së kundërt, e në disa të tjera ju lejohet në dispozicion palëve që vetë të vendosin. Martesa është një bashkësi e vetme në mes burrit dhe gruas, por mundet të ndodhë që ndonjë ligji kombëtar të njeh edhe forma tjera të bashkësisë, si poligamia dhe partnerët e gjinis së njëjtë⁹. Duke pasur parasysh që marrëdhëniet seksuale jashtë konceptit të martesës janë pranuar nga shoqëria në shumë shtete evropiane, dhe një numër i madh i partnerëve kanë fëmijë pa u martuar.¹⁰

Historikisht, në shumicën e kulturave, gratë e martuara kishin shumë pak të drejta duke u konsideruar së bashku me fëmijët e familjes pronë e burrit, si të tilla, ata nuk mund të zotëronin ose të trashëgonin pronën, ose të përfaqësoheshin ligjërisht. Në Evropë, Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera në botën e zhvilluar, duke filluar nga fundi i shekullit të 19 dhe duke zgjatur deri në shekullin 21, martesa ka pësuar ndryshime graduale ligjore, që synojnë përmirësimin e të drejtave të gruas. Këto ndryshime përfshinin njohjen e subjektivitetit juridik grave, heqjen e të drejtës së burrave për të disiplinuar fizikisht gratë e tyre, duke i dhënë grave të drejta pronësore, duke liberalizuar ligjet e shkurorrëzimit, duke siguruar gratë me të drejtat e tyre riprodhuese.¹¹ Këto ndryshime pozitive i kanë dhënë rëndësi të veçantë çështjes së marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve.

Deri tek lidhja e martesës mund të vijë për arsye të ndryshme, duke përfshirë për qëllime juridike, sociale, libidinale, emocionale, financiare, shpirtërore dhe fetare.

⁸ Berry Nicholas: „Вовед во Римско Право„ – Shkup 2009, fq.80

⁹ Dominik Buro, Horatia Muir Watt: “E drejta ndërkombëtare private” botimi i dytë, pjesa e veçantë— Shkup 2011, fq.115

¹⁰ Jens M. Scherpe: “European Family Law” Volume III – Cheltenham 2016, fq.21

¹¹ Marriage, Wikipedia – (parë me 01.12.2019) - <https://en.wikipedia.org/wiki/Marriage>

Ndërsa deri tek zgjedhja e personit me të cilin do lidh martesë mund të ndikohet nga disa faktor siç janë: gjinia, rregullat e përcaktuara shoqërore, rregullat e martesës së aranzhuar, rregullat e martesës së detyruar, zgjedhja nga ana e prindërve dhe në fund dëshira individuale. Mirëpo në disa zona të botës: *martesa e aranzhuar*, *martesa e fëmijëve*; *poligamia* dhe *martesa e detyruar*, mund të praktikohet si një traditë kulturore. Ndërsa praktikat e tilla mund të jenë të jashtëligjshme dhe të ndëshkueshme në pjesën tjetër të botës, duke pasur parasysh shqetësimet e shkeljes së të drejtave të grave, ose shkeljes së të drejtave të fëmijëve (pavarsisht asaj se a bëhet fjalë për vajzë apo djalë), dhe për shkak të shkeljes së legjislacioneve ndërkombëtare të cilat rëndësi të veçantë i kushtojnë, të drejtave dhe lirive të individëve pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër; barazisë ndërmjet burrit dhe gruas; mbrojtjes së fëmijëve të mitur; etj.¹²

Burrat dhe grate që kanë mbushur moshën për martesë kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte¹³. Në literaturën juridike është theksuar se e drejta për martesë num mund të jetë vetëm çështje e ligjeve kombëtare (brendshme) që të mund të vendosin vetëm, konventa është një dokument publik i ligjit ndërkombëtar i miratuar me qëllim të sigurimit të një niveli të caktuar themelor të mbrojtjes, pavarësisht nga ato që parashikojnë ligjet e brendshme.¹⁴ Në të gjithë botën, kryesisht në demokracitë e zhvilluara, ka pasur një prirje të përgjithshme drejt sigurimit të të drejtave të barabarta në martesë në mes bashkëshortëve si dhe njohjen me ligj të martesave ndërfetare. Kjo e drejtë garantohet dhe mbrohet edhe me dokumente tjera ndërkombëtare siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e cila në nenin 16 garanton se: "1. Burrat dhe gratë në moshë madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi. 2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen. 3. Familja është bërthama e

¹² Marriage, Wikipedia - (parë me 01.12.2019) - <https://en.wikipedia.org/wiki/Marriage>

¹³ Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore – Romë 1950, Neni 12

¹⁴ H Danelius, Mänskliga rättigheter i europeisk praxis (4th Edition, Norstedts Juridik 2012) 503. White and Ovey, The European Convention on Human Rights (n 118) 353.

natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.”.¹⁵

Martesa është e drejtë e garantuar me kushtetutë, ku në nenin 40 të kushtetutës së RMV thuhet: “Republika i siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë familjes. Marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësinë jashtëmartesore rregullohen me ligj. Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët e kanë për detyrë që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pamundur. Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdes prindëror”.¹⁶

“Martesa është gurthemeli i të gjitha marrëdhënieve bashkëshortore, të cilat pa dyshim janë të kushtëzuara nga natyra dhe qëllimi i martesës. Kjo është arsyeja pse në këtë kapitull trajtohet martesa si një strukturë paraligjore, e cila fillimisht është rregulluar nga normat morale shoqërore dhe religjioze. Vetëm me kodifikimet e mëdha europiane të shekullit 19, martesa shndërrohet në një institut të fuqishëm juridik dhe marrëdhëniet martesore në përgjithësi e ato pasurore të bashkëshortëve në veçanti gjejnë rregullim të detajuar ligjor.”¹⁷

¹⁵ Universal Declaration of Human Rights, 1948

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Numër 08-4642/1, 17.11.1991) - Neni 40

¹⁷ Albana Metaj-Stojanova: “Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin Shqiptar”, Tiranë 2019, fq.10-11

2.Marrëdhëniet martesore

Martesa vlersohet si modeli ideal i familjes, ato që martohen fitojnë një status dhe u jepen të drejta të përshtatshme për atë pikpamje, ajo ka një pikë hyrëse fikse me rregulla të rrepta në lidhje me formimin dhe shpërbërjen e saj.¹⁸ Veprimet juridike që rrjedhin nga martesa kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e ndërsjella të partnerëve martesorë, të cilat përbëjnë përmbajtjen e marrëdhënies martesore.¹⁹ Me lidhjen e martesës krijohen një tërësi e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet bashkëshortëve. Këto të drejta dhe detyrime janë reciproke ndërmjet burrit dhe gruas, pasi që ditët e sotme martesa ngrihet mbi bazën e barazisë ndërmjet bashkëshortëve si në aspektin juridik ashtu edhe në atë moral. Këto të drejta dhe detyra e përbëjnë përmbajtjen e marrëdhënieve martesore, duke pasur parasysh natyrën specifike të marrëdhënieve martesore vlen të theksohet se nuk mundet që të gjitha këto marrëdhënie të rregullohen me norma juridike për shkak të intimitetit apo privatësisë së disa marrëdhënieve.

Varësisht prej karakterit dhe natyrës së të drejtave dhe detyrave marrëdhëniet martesore ndahen në dy grupe: 1) *marrëdhëniet personale të bashkëshortëve*; dhe 2) *marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve*.

2.1.Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve

Të drejtat dhe detyrat të cilat janë të lidhura ngushtë me personalitetin e bashkëshortit dhe të cilat nuk janë të karakterit pasuror quhen marrëdhënie personale të bashkëshortëve. Një pjesë e këtyre marrëdhënieve, të cilat për nga natyra janë të lidhura me etikën, moralin, arsimimin dhe traditën e rrethit prej të cilit vin partnerët martesore, janë të papërshtatshme për tu rregulluar me ligj²⁰. Duke pasur parasysh natyrën e normave juridike me të cilën rregullohen marrëdhëniet personale të bashkëshortëve, ato ndahen në dy grupe: 1) Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve për të cilat bashkëshortët nuk mund të lidhin marrëveshje; 2) Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve për të cilat bashkëshortët mund të lidhin marrëveshje;

¹⁸ Mary Welstead, Susan Edwards: "Family Law" 4th Edition – Oxford 2013, fq.12.

¹⁹ Lilana Spiroviq Trpenovska, Dejan Mickoviq, Angel Ristov: "Semejno Pravo" – Shkup, 2013, fq.120

²⁰ Po aty, fq.120

2.1.1. Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve për të cilat nuk mund të lidhet marrëveshje

Të drejtat dhe detyrat të cilat janë të rregulluar me norma imperative (urdhëruese), janë të drejta dhe detyra që nuk mund të ndryshohen me marrëveshjen e bashkëshortëve. Pra, duke pasur parasysh se disa të drejta dhe detyrime të bashkëshortëve nuk janë me interes vetëm për bashkëshortët por edhe për mbarë shoqërinë, nuk është e mundur që të mos rregullohen me norma juridike, pasi që rregullimi i tyre vetëm me marrëveshje të bashkëshortëve nën ndërgjegjen morale e etike mund të mos jetë efikas. Martesa ndërtohet mbi bazën e barazisë morale dhe juridike të bashkëshortëve, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji, me qëllim që të garantohet uniteti familjar²¹. Në këtë grup të marrëdhënieve personale bëjnë pjesë: a) barabarësia e bashkëshortëve në marrëdhëniet martesore; b) jetesa e përbashkët e bashkëshortëve; c) besnikëria bashkëshortore; ç) ndihma reciproke e bashkëshortëve; dhe d) e drejta e çdo bashkëshorti për të zgjedhur dhe ushtruar profesionin.²²

Me ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të parapara veprimet e mëposhtme ligjore, lidhur me marrëdhëniet personale të partnerëve martesorë si: a) pavarësia në zgjedhjen e punës dhe profesionit; b) përcaktimi i vendbanimit të përbashkët; c) udhëheqja e amvisërisë së përbashkët; d) përmbushja e nevojave të familjes.²³

2.1.2. Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve për të cilat mund të lidhet marrëveshje

Përveç të drejtave dhe detyrave për të cilat palët nuk mund të lidhin marrëveshje ekzistojnë edhe të drejtat dhe detyra të cilat mund të rregullohen me marrëveshje të lirë ndërmjet bashkëshortëve. Këto të drejta dhe detyra janë të rregulluara me norma të karakterit dispozitiv, domethënë bashkëshortët mund ti rregullojnë me marrëveshje ndryshe nga si parashihet në ligj. Këto të drejta janë: a) caktimi i mbiemrit; b) zgjedhja e vendbanimit; c) zgjedhja e shtetësisë; ç) lindja e fëmijëve dhe ekonomia e përbashkët familjare.²⁴

²¹ Francesco Galgano: "E drejta Private" – Tiranë 1999, fq.794

²² Abdulla Aliu, Haxhi Gashi: "E drejta Familjare" – Prishtinë 2007, fq.126

²³ Lilana Spiroviq Trpenovska, Dejan Mickoviq, Angel Ristov: "Semejno Pravo" – Shkup, 2013, fq.121

²⁴ Hamdi Podvorica: "E drejta Familjare" – Prishtinë 2005, fq.106

2.2.Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve

Marrëdhëniet pasurore janë një pjesë thelbësore dhe e domosdoshme e marrëdhënieve familjare dhe e drejtës familjare, ato janë të lidhura ngushtë dhe të ndërthurura me marrëdhëniet personale që ndodhin midis anëtarëve të familjes²⁵. Në këtë kuptim, marrëdhëniet pasurore të natyrës së të drejtës familjare, ndryshe nga marrëdhëniet e tjera pronësore, lindin vetëm midis anëtarëve të familjes: a) partnerët martesor; b) partnerët jashtëmartesor; dhe c) prindërit dhe fëmijët.²⁶ Në marrëdhëniet mes bashkëshortëve përveç të drejtave dhe detyrave të natyrës personale krijohen edhe të drejta dhe detyra të cilat janë të natyrës pasurore. Këto marrëdhënie nuk janë të lidhura ngusht me personalitetin e bashkëshortëve, por nuk do të thotë që janë të një rëndësie të vogël për bashkëshortët pasi që të drejtat dhe detyrat pasurore janë komponenta kryesore që nga themelimin i marrëdhënieve martesore.

Duke pasur parasysh natyrën e të drejtave dhe detyrave pasurore ato klasifikohen në dy grupe: 1. Të drejtat dhe detyrat pasurore-personale të bashkëshortëve; dhe 2. Të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve. Ndarja e kështu bëhet për shkak se disa të drejta dhe detyra janë të karakterit pasuror, por janë të lidhura me subjektin e caktuar, ndërsa disa janë thjeshtë të karakterit pasuror.²⁷

2.2.1. Të drejtat dhe detyrat pasurore-personale të bashkëshortëve

Këto të drejta dhe detyra janë të karakterit pasuror, por të lidhura me subjektin e caktuar, pra janë të lidhura ngushtë me personalitetin e çdo bashkëshorti dhe rrjedhimisht nuk mund t'i kalojnë një personi tjetër me ndonjë veprim juridik as për së gjalli e as në rast të vdekjes. Si të drejta të kësaj natyre janë: a) Mbajtja e bashkëshortit të pasiguruar; b) Mbajtja e familjes; c) Përgjegjësia e bashkëshortit për detyrimet e krijuara rreth plotësimit të nevojave të bashkësisë martesore dhe familjare.²⁸

²⁵ Lilana Spiroviq Trpenovska, Dejan Mickoviq, Angel Ristov: "Semejno Pravo" – Shkup, 2013, fq.307

²⁶ Po aty, fq.307

²⁷ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi: "E drejta Familjare" – Prishtinë 2007, fq.135

²⁸ Po aty, fq.135

2.2.2. Të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve

Në marrëdhëniet martesore ndërmjet bashkëshortëve paraqiten edhe të drejta dhe detyra të karakterit pasuror, të cilat janë të një rëndësie të posaçme pasi që si subjekte të marrëdhënieve pasurore paraqiten vetë bashkëshortët, të cilët janë të lidhur personalisht. Egzistenca e lidhjes emotive në mes bashkëshortëve rritë shkallën e vlefshmërisë së marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre, pasi që në këtë situat nuk kemi thjeshtë një marrëdhënie pasurore e cila zhvillohet ndërmjet dy personave të cilët ndërmjet vete nuk kanë asnjë lidhje tjetër, por bëhet fjalë për dy persona të cilët përveç marrëdhënies pasurore, ndërmjet veti kanë një lidhje shpirtërore, emotive dhe familjre, e cila nvaret shumë nga fati i marrëdhënies pasurore.

Martesa nuk është vetëm bashkësi jetësore, por njëkohësisht është edhe bashkësi ekonomike, ku gjatë kohëzgjatjes së martesës bashkëshortët fitojnë të mira materiale, por edhe sjellin të mira materiale të cilat i kanë fituar më parë, bashkëshortët gjatë jetës së tyre të përbashkët ndërmarrin veprime nga më të ndryshmet duke u munduar të sigurojnë kushte sa më të mira për jetesë, pra ato punojnë, krijojnë të mira materiale, blejnë dhe mirëmbajnë shtëpinë e tyre të përbashkët, rrisin dhe edukojnë fëmijët e tyre, kujdesen për mbajtjen e amvisërisë së përbashkët, po ashtu bashkarisht përmbushin edhe detyrimet e tyre siç janë: pagesa e faturave, pagesa e tatimit, mirëmbajtja e shtëpis etj.

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë të pa rëndësishme për bashkëshortët për aq kohë sa në mes tyre lulzon harmonia, nuk ka mosmarrëveshje e keqkuptime dhe niveli i tolerancës është i lartë, në këto situata gjithçka është e pranushme, e pakontestueshme dhe e parëndësishme. Mirëpo në momentin kur ajo lidhje emotive në mes tyre fillon të zbehet, po ashtu humbet toleranca fillojnë konfliktet e mosmarrëveshjet, pikërisht në këtë moment marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve ngrihen në piadestalin më të lartë dhe paraqesin pjesën më delikate e më të komplikuar, pasi tek këto marrëdhënie egziston edhe karakteri emocional, për dallim nga marrëdhëniet pasurore në mes subjekteve tjerë të së drejtës civile në përgjithësi, tëk të cilët nuk egziston lidhja personale emotive. Në këto raste rëndësi të veçantë ka mënyra e rregullimit juridik të marrëdhënieve pasurore ndërmjet

bashkëshortëve pasi që nuk mund të zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës civile.

“Marrëdhëniet pasurore që krijohen ndërmjet bashkëshortëve dallohen nga marrëdhëniet pasurore që krijohen ndërmjet subjekteve të së drejtës në përgjithësi, pasi specifikat e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve duhet të trajtohen në lidhje të ngushtë me natyrën juridike të institucionit të martesës, brenda së cilit ato krijohen.”²⁹ Këto raste janë të komplikuar pasi kemi dy pasuri, pasurinë të cilën bashkëshortët e kanë sjellur në martesë dhe pasurinë të cilën bashkëshortët do ta krijojnë gjatë martesës – e cila ëshët rrezultat i punës dhe jetës së përbashkët. Në këtë drejtim është mirë që të përcaktohet rethi i të drejtave dhe detyrave të bashkëshortëve lidhur me këtë pasuri dhe rregullimi i tyre në praktikë, aq më tepër duke pasur parasyshë që shpesh herë, bashkëshortët bashkërisht ose veç e veç hynë në marrëdhënie pasurore edhe me persona të tretë.

3.Regjimi pasuror

Në mes burrit dhe gruas mund të ketë bashkëpronësi ose ndarje të të mirave materiale.³⁰ Me lidhjen e martesës, bashkëshortët fitojnë pronë sipas bazave të ndryshme ligjore, siç janë të ardhurat nga puna, dhuratat, trashëgimia, etj.³¹ Martesa dhe marrëdhëniet personale midis partnerëve martesor janë parakusht për shfaqjen e marrëdhënieve specifike të pasurisë martesore dhe kusht për shfaqjen e formave të veçanta të pasurisë dhe regjimit për administrimin, disponimin dhe ndarjen e saj.³² Prandaj, rregullimi i pasurisë martesore ka një rëndësi të madhe për bashkëshortët dhe funksionimin e martesës, si gjatë martesës ashtu edhe pas mbarimit të saj.³³

Marrëdhëniet pasurore të cilat janë të lidhura drejtpërsëdrejti me bashkëshortët martesorë, bashkëshortët jashtëmartesorë dhe në mes të personave nga bashkësitë e gjinisë së njëjtë, nuk mund të rregullohen me normat e përgjithshme të së drejtës civile me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore ndërmjet subjekteve të së drejtës në përgjithësi, por është e nevojshme krijimi i një

²⁹ Emine Zendeli : Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve – 2017, fq.3

³⁰ Francesco Galgano: “E dretja Private” – Tiranë 1999, fq.802

³¹ Dejan Micković, Angel Ristov: Semejno parvo – Skopje 2015, fq.331

³² Po aty, fq.331

³³ Lilana Spiroviq Trpenovska, Dejan Micković, Angel Ristov: “Semejno Pravo” – Shkup, 2013, fq.307

tërësie të normave të posaçme me të cilat rregullohen këto marrëdhënie. Kjo tërësi e normave quhet *regjim pasuror* e që nënkupton tërësinë e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve në njërën anë si dhe marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve me personat e tretë në anën tjetër.

Shikuar në aspektin krahasues (komperativ) marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë rregulluar në mënyra të ndryshme varsisht nga legjislacionet e shteteve përkatëse. Njihen dy regjime pasurore të bashkëshortëve: **1.Regjimi pasuror ligjor; dhe 2.Regjimi pasuror i kontraktuar.**

Disa legjislacione njohin vetëm regjimin pasuror ligjor, pra ata janë decid në rregullimin e marrëdhënieve pasurore martesore ndërmjet bashkëshortëve, këto legjislacione nuk i mundësojnë bashkëshortëve që ata vetë sipas dëshirës së tyre të vendosin se si do të rregullojnë marrëdhënie e tyre martesore. Ndërsa disa legjislacione parashohin edhe regjimin pasuror ligjor edhe të kontraktuar, pra përveç rregullimit ligjor nga ana e shtetit parashihet edhe mundësia që me anë të kontratës të përcaktohen për ndonjë regjim tjetër alternativ. Në shtetet të cilët përveç regjimit pasuror ligjor njohin edhe regjimin e kontraktuar, bashkëshortët me anë të kontratës mund të shmangin regjimin ligjor dhe të përcaktohen për ndonjë regjim të kontraktuar, p.sh. bashkëshortët shmangin regjimin ligjor i cili parasheh regjimin e pasurisë së përbashkët dhe përcaktohen për regjimin e pasurisë së ndarë.

Duke u ndalur në ndarjen e pasurisë në rast divorci, tre qasje dalluese mund të gjenden në juridiksionet evropiane: a) ato që krijojnë një formë të bashkësisë së pasurisë gjatë martesës, b) ato kur nuk krijohet një bashkësi e tillë por kur ekziston një regjim ligjor që rregullon pjesëmarrjen në pronën e bashkëshortit tjetër në rast divorci dhe c) ato ku të gjitha pasojat financiare të divorcit, përfshirë këtu edhe ndarjen e pasurisë, janë subjekt i gjykimit të gjykatësve³⁴.

4.Regjimi pasuror ligjor

Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve sipas regjimit të cilin e ka përcaktuar shteti në rregullativën e tij ligjore nënkupton regjim pasuror ligjor. Sipas regjimit ligjor marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve rregullohen ashtu siç

³⁴ Jens M. Scherpe: "European Family Law" Volume III – Cheltenham 2016, fq.149

është parapar me ligj, ku në disa shtete parashihet me ligjin për familje, në disa tjerë sipas ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore, e në numrin më të madhë sipas kodit civil. Një numër i madh i shteteve marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve i rregullojnë vetëm sipas regjimit ligjor, pra në ato shtete nuk është paraparë regjim i kontraktuar, bashkëshortët nuk kanë zgjidhje tjetër përpos nënshtrimit ndaj regjimit ligjor si regjim i vetëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, në këto shtet ky regjim njihet si regjim i rept ligjor.

Në teorinë e të drejtës familjare dhe në të drejtën krahasuese njihen një numër i madhë i regjimeve ligjore varësisht nga shteti përkatës, ndër regjimet më të vjetra dhe më të njohura janë: 1.Regjimi i pasurisë së përbashkët; 2.Regjimi i pasurisë së ndarë; dhe 3.Regjimi mix. Kjo do të thotë se që në të kaluarën i është kushtuar rëndësi e veçantë rregullimit juridik të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve.

Regjimi i pasurisë së përbashkët është model i cili daton që nga krijimi i familjes për herë të parë pasi pasuria ishte e përbashkët dhe e pandarë e me të udhëhiqte kryefamiljari. Edhe pse në të kaluarën pasuria e bashkëshortëve është konsideruar si pasuri e përbashkët mirëpo rolin primar e ka pasur burri i cili ka administruar dhe disponuar me pasurinë pavarësisht dëshirës së gruas. Ky regjim thuhet se është rezultat i sistemit patriakal ku gjithçka ka udhëhequr burri. Ky regjim vazhdon të jetë regjim kryesor dhe i pranishëm gati se në të gjitha shtetet edhe ditëve të sotme, mirëpo me ndryshime shumë të rëndësishme, pra në këtë regjim është inkorporuar parimi i barazisë dhe solidaritetit në mes bashkëshortëve që do të thot se ato me pasurin e përbashkët nuk mund të administrojnë dhe disponojnë pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër.

Regjimi i pasurisë së ndarë - veçantë është modeli i dytë më i pranishëm në legjislacionet e shteteve të ndryshme. Sipas këtij regjimi pasuria ndërmjet burrit dhe gruas është e ndarë, dhe çdonjëri është titullar i pasurisë së tij me të cilën administron dhe disponon në mënyrë të pavarur në çdo kohë pa marrë parasysh se këtë pasuri e ka sjellur në martesë apo e ka fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Më vonë këto dy modele u plotësuan me të ashtuquajturin sistem i përzier (mix) i cili u pranua në rregullativën ligjore të një numri të madh shtetesh, si një zgjidhje e pranueshme që më tepër u përgjigjej marrëdhënieve reale në jetë.³⁵

4.1 Pasuria e veçantë e bashkëshortëve

Pasuri e veçantë e bashkëshortëve konsiderohet pasuria e çdonjërit nga bashkëshortët, e cila nuk i është nënshtruar regjimit juridik të pasurisë së përbashkët.³⁶ Pra me termin pasuri e veçantë e bashkëshortëve kuptojmë pasurinë të cilën bashkëshorti e ka pasur në momentin e lidhjes së martesës, pasurinë që do ta fitojë gjatë kohëzgjatjes së martesës në bazë të trashëgimisë, legut, dhuratës etj. Po ashtu në pasurinë e veçantë hynë edhe ajo pasuri dhe të drejta që do t'i fitojë gjatë martesës por që shërben për plotësimin dhe kënaqjen e nevojave personale, në qoftë se vlera e tyre nuk është në disproporcion të madhë me vlerën e pasurisë së përbashkët në përgjithësi.

Pra, duke e ndarë në disa kategori pasuria e veçantë e bashkëshortëve konsiderohet:

- 1.Pasuria që bashkëshortët e kanë pasur në momentin e lidhjes së martesës;
- 2.Të ardhurat nga pasuria e veçantë, për të cilat nuk është kontribuar me punë për fitimin e tyre, si p.sh: qiraja, kamata, shitja e pronësisë etj.. ;
- 3.Pasurinë që bashkëshortët do ta fitojnë gjatë martesës por në bazë të dhuratës, trashëgimisë, legut;
- 4.Pasuria që do t'i takojë bashkëshortit kur të bëhet ndarja e pasurisë së tyre të përbashkët e cila ndarje mund të bëhet edhe gjatë martesës;
- 5.Pasuria që gruaja e sjell në martesë në momentin e lidhjes së martesës ose gjatë kohëzgjatjes së saj, si p.sh: mirazi, prika;
- 6.Kërkesat detyimore të cilat dalin nga pasuria e veçantë, shpërblimi i dëmit material dhe jo material.³⁷

Me pasurinë e veçantë bashkëshortët administrojnë dhe disponojnë në mënyrë të pavarur, pra ato vazhdojnë të jenë titullarë të pasurisë së tyre të veçantë edhe pse

³⁵ Emine Zendeli : Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve – 2017, fq.7

³⁶ Emine Zendeli - “Perspektiva e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik të republikës së maqedonisë” – 2014, fq.6

³⁷ Emine Zendeli : Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve – 2017, fq.8

kanë lidhur martesë. Vlen të ceket se pavarësisht dëshirës së tyre ato nuk mundet që të bashkojnë pasurinë e veçantë me pasurinë e përbashkët, sepse është në kundërshtim me normat kogente të regjimit pasuror.

Lidhur me pasurinë e veçantë egzistojnë disa situata kontestuese të cilat na shkaktojnë vështirësi gjatë zgjidhjes së tyre, një ndër to është edhe pyetja se: Të ardhurat nga pronësia intelektuale e njërit bashkëshort a do të konsiderohen si pasuri e veçantë apo pasuri e përbashkët?. “Për këtë pyetje egzistojnë dy qëndrime: Sipas *qëndrimit të parë* të ardhurat nga pronësia intelektuale duhet të hynë në pasurinë e veçantë, pasi ato janë rezultat i intelektit, aftësive dhe kreativitetit të njërit bashkëshort; ndërsa sipas *qëndrimit të dytë* të ardhurat nga pronësia intelektuale duhet të llogariten si pasuri e përbashkët, pavarësisht asaj se ato të hyra janë si rezultat i aftësive intelektuale dhe veprës së njërit bashkëshort, por konsiderohet se edhe bashkëshortit tjetër në mënyrë të tërthortë ka dhënë kontribut në krijimin e veprës intelektuale ose të drejtës së autorit.³⁸

4.2 Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Pasuria e përbashkët paraqet një institut të veçantë juridiko-pasuror, i cili paraqitet vetëm në raste të caktuara me ligj, njëra nga ato situatat është pasuria e përbashkët e bashkëshortëve. Specifika e saj qëndron në atë se të dy bashkëshortët kanë të drejtën e pronësisë mbi të njëjtin send pjesët e të cilit janë të ndashme, mirëpo pjesa e tyre nuk është e caktuar që më parë.

Pasuri e përbashkët konsiderohet pasuria të cilën bashkëshortët martesor do ta fitojnë gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore. Pasuri e përbashkët po ashtu konsiderohet edhe ajo pasuri të cilën bashkëshortët e fitojnë nëpërmjet dhuratës e cila u është bërë të dy bashkëshortëve, të ardhurat të cilat i realizojnë nga sendet në pronësi të përbashkët, nga kamata e mjeteve të deponuara, të ardhurat nga sendet në pronësi të veçantë por të cilat janë fituar me kontribut, pra me punë.

Që të konsiderohet pasuri e përbashkët e bashkëshortëve duhet që të plotësohen disa kriterë: 1.Pasuria të jetë fituar gjatë egzistimit të bashkësisë martesore; dhe 2.Të jetë rezultat i angazhim aktiv – pra të jetë fituar me punë.

Kriteri i parë – egzistimi i bashkësisë martesore paraqet bazë juridike mbi të cilën

³⁸ Lilana Spiroviq Trpenovska, Dejan Mickoviq, Angel Ristov: “Semejno Pravo” – Shkup, 2013, fq.311

themelohet pasuria e përbashkët. Me termin bashkësi martesore nuk nënkuptohet vetëm egzistimi i martesës formale por ajo duhet të jetë reale - bashkëshortët të jetojnë me njëri tjetrin, pra të përmbushet kushti i bashkëjetesës. Nga kjo del që si pasuri e përbashkët do konsiderohet edhe në qoftë se nuk egziston martesa formale, por egziston ajo reale, pra jeta e përbashkët në mes çiftit, me këtë ju mundësohet trajtim të barabartë edhe bashkëshortëve jashtë martesor po edhe pratneriteteve të gjinisë së njejtë.

Kriteri i dytë – Puna - angazhimi aktiv (kontributi) gjithashtu paraqet kusht ligjor për fitimin e pasurisë së përbashkët, puna duhet të shikohet në kuptimin e gjërë, pra si punë të mos konsiderohet vetëm ajo punë që sjell të mira materiale ekonomike, por edhe aktivitetet tjera të cilat nuk sjellin të mira materiale por ndihmojnë dhe janë mjaft të rëndësishme për bashkësinë martesore, siç është rritja dhe edukimi i fëmijëve, mirëmbajtja e shtëpisë etj.

Regjimi i pasurisë së përbashkët paraqitet si regjim dominant krahasuar me regjimet tjera pasi që është i pranishëm në të gjitha legjislacionet e shteteve, qoftë si regjim ligjor apo si regjim subsidiar. Ky dominim është si rezultat i asaj që ky regjim i përgjigjet frymës së barazisë midis burrit dhe gruas, pasi që si punë llogariten edhe punët që nuk sjellin të ardhura materiale siç janë: 1.Rritja dhe edukimi i fëmijëve; 2.Puna në amëvisëri – përgatitja e ushqimit, pastrimi, mirëmbajtja e shtëpisë.

Me pasurin e përbashkët bashkëshortët administrojnë dhe disponojnë bashkë, përveç nëse bashkëshortët janë përcaktuar ndryshe me marrëveshje.

4.2.1. Objekt i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve

Me fjalën pasuri nënkuptohet: Tërësia e sendeve, e mjeteve materiale dhe e vlerave të tjera që ka në zotërim një njeri, një grup njerëzish ose shoqëria; burim të ardhurash e të mirash materiale; pronë.³⁹ Pasuria është tërësi e sendeve dhe të drejtave subjektive civile me karakter pasuror që janë të lidhura për personin e caktuar⁴⁰. Subjekti ka vetëm një pasuri dhe ajo mund të jetë e madhe ose e vogël por nuk mund të thuhet se ka shumë pasuri.⁴¹

³⁹ <https://fjale.al/pasuri> - (parë më 01.03.2020)

⁴⁰ Abdulla Aliu: “E drejta civile” – Prishtin, 2013, fq.331

⁴¹ Po aty, fq.331

Objektin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve e përbëjnë të gjitha të drejtat subjektive civile me karakter pasuror që u takojnë të dy bashkëshortëve, pra të drejtat mbi sendet që përfshihen në masën pasurore, e cila përbën pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve.⁴² Objekti i pasurisë së përbashkët përbëhet nga të drejtat sendore siç janë e drejta e pronësisë mbi sendet e luajtshme e të paluajtshme dhe frytat që jep sendi (e drejta e pengut, e drejta e servitutit, e drejta nga barra sendore dhe e drejta e ndërtimit), gjithashtu nga të drejtat e detyrimeve me karakter pasuror siç është dëmshpërblimi për pasurinë e përbashkët, duke përfshirë edhe të hyrat nga pasuria e veçantë që janë fituar me punën e përbashkët.⁴³

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve zakonisht krijohet nëpërmjet punëve juridike komutative me shpërblim, por, ajo mund të krijohet edhe me anë të punëve juridike pa shpërblim të tilla si: trashëgimia testamentare, dhuratat, lojërat e fatit etj.⁴⁴

Objektin e pasurisë së përbashkët e përbëjnë:

1. *Të drejtat sendore* - a) e drejta e pronësisë mbi sendet e paluajtshme dhe sendet e luajtshme; b) e drejta e servitutit; c) e drejta e pengut (hipotekës); d) pronësia etazhe, e drejta e ndërtimit.
2. *Të drejtat detyrimore* - a) kompensimet për fitimin e humbur; b) kamata; c) shpërblimi i dëmit nga pasuria e përbashkët; d) kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga sendet në pronësi të përbashkët; dh) pasuria e fituar nga lojrat e fatit; e) renta etj.
3. Të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të ngjajshme si dhe të drejtat nga pronësia industriale.

4.2.2. Administrimi dhe disponimi me pasurinë

Administrimi dhe disponimi me pasurinë kur është në pyetje pasuria e bashkëshortëve martesorë varet nga lloji i regjimit pasuror i cili është në fuqi, duke pasur parasysh se egzistojnë disa lloje të regjimeve pasurore. Kur kemi të bëjmë me *regjimin e pasurisë së veçantë* çdonjëri nga bashkëshortët administron dhe disponon me pasurinë e tij në mënyrë të pavarur nga bashkëshorti tjetër, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që bashkëshortët të meren vesh që me pasurinë e veçantë të njërit bashkëshort të administrojë dhe disponojë bashkëshorti tjetër.

⁴² Emine Zendeli : Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve – 2017, fq.10

⁴³ Violeta SMAJLAJ: "THE MARITAL PROPERTY REGIME IN KOSOVO'S LEGISLATION AND ISLAMIC LAW" (UDC 347. 2: [348 : 28) – VIZIONE 31/2019, fq.138

⁴⁴ Mladenovic, Marko: "Porodичno Pravo", Beograd 1981, fq.643

Situata më specifike paraqitet kur bëhet fjalë për *regjimin e pasurisë së përbashkët* pasi që pjesët e bashkëshortëve në pasurinë e përbashkët nuk dihen, dhe për këtë arsye bashkëshorti nuk mundet të disponojë me pjesën e vet nga pasuria e përbashkët e as ta ngarkojë me ndonjë punë juridike, e njehta vlen edhe për administrimin me pasurinë e përbashkët, për këtë arsye administrimin dhe disponimin me pasurinë e përbashkët bashkëshortët e bëjnë bashkërisht dhe me marrëveshje.

Bashkëshortët kanë detyrë të ndërmarrin veprime juridike dhe faktitke lidhur me ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë së përbashkët, me rritjen dhe me shtimin e vlerës së saj.⁴⁵ Si dhe marrjen e masave dhe veprimeve të cilat kanë të bëjnë me tjetërsimin, ngarkimin dhe vërtetimin e së drejtës së pasurisë së përbashkët.⁴⁶ Nga kjo mund të nxjerrim se ekzistojnë dy lloje të administrimit: administrimi i rregullt dhe administrimi i jashtëzakonshëm i pasurisë.

Administrimi i rregullt i pasurisë – do të thotë që secili nga bashkëshortët mund të ndërmerr në mënyrë të lirë dhe të pavarur pa pasur nevojë për pëlqimin e tjetrit disa veprime të caktuara si: ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë së përbashkët, riparimin e sendit të përbashkët, punimin e rregullt të tokës, mbledhjen e frutave, pagimi i tatimit.

Administrimi i jashtëzakonshëm i pasurisë – do të thotë që bashkëshortët nuk mund të ndërmarrin veprime të caktuara, të cilat i tejkalojnë kufijtë e asaj që quhet administrim i rregullt i pasurisë, pa pasur edhe pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Si veprime juridike dhe faktike të jashtëzakonshme llogariten: shitja e sendit të përbashkët, dhënia me qira, lënja në hipotekë e sendit të përbashkët, themelimi i së drejtës së servitutit, thënë më saktë gjithçka që ka të bëjë me tjetërsimin, ngarkimin dhe vërtetimin e pasurisë së përbashkët. Pëlqimi i bashkëshortit duhet të jetë i dhënë në formën e cila kërkohet për lidhjen e punës juridike përkatëse.

Edhe pse administrimi dhe disponimi me pasurinë e përbashkët bashkëshortët e bëjnë bashkërisht dhe në mënyrë solidare, mirëpo ato mund të meren vesh që vetëm njëri prej tyre të administrojë dhe disponojë me tërë pasurinë e përbashkët ose vetëm një pjesë të saj. Marrëveshja mund të përfshijë kryerjen e të

⁴⁵ Hamdi Podvorica: “E drejta Familjare” – Prishtinë, 2005, fq.245

⁴⁶ Po aty, faqe 245

gjitha punëve të administrimit dhe disponimit me pasurinë ose vetëm punë të administrimit të rregullt, gjegjësisht punë të caktuara saktë⁴⁷. Konsiderohet se me anë të rregullave për administrimin dhe disponimin e pasurisë së përbashkët, ligjdhënësi siguron në rradhë të pare splidaritetin ndërmjet bashkëshortëve.⁴⁸

4.3. Partnerët jashtëmartesor

Bashkësia jashtëmartesore është bashkësi e jetës së vazhdushme, e themeluar me vullnetin e shprehur të një burri dhe një gruaje, të cilët kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë bashkarisht për një kohë të gjatë në bashkësi jashtëmartesore, ndërsa bashkësia është e njohur edhe nga mjedisi ku ajo është themeluar.⁴⁹ Edhe pse bashkësia jashtë martesore një kohë të gjatë nuk ka qenë e rregulluar me norma ligjore, megjithatë shumë raste i ka paraprirë martesës pasi përmban mjaft elemente të martesës.

Kjo neglizhencë nga ana e ligjvënësve për një kohë të gjatë, ka bërë shpesh që partnerët e bashkësisë jashtëmartesore të ndjehen të pabarabartë në krahasuar me bashkëshortët martesorë. Mirëpo duke pasur parasysh që vit pas viti bashkësia jashtëmartesore fillojë të përhapet gjithnjë e më shumë, pasi që gjeneratat e reja parapëlqenin që para se të martoheshin të jetonin në bashkësi jashtëmartesore, për këtë arsye bashkësis jashtëmartesore i'u kushtua më tepër rëndësi, duke i rregulluar marrëdhëniet e partnerëve jashtëmartesorë me norma juridike.

Me gjithë faktin që bashkëjetesa nuk është martesë, ajo prodhon disa efekte juridike të pashmangshme, sidomos në përkujdesin ndaj bashkëshortit, përkujdesin ndaj fëmijëve si dhe pasuria e përbashkët e partnerëve jashtëmartesorë.⁵⁰ Se çfarë efekte juridike do të paraqiten nga bashkëjetesa varet nga legjislacionet e shteteve konkrete. Sa i përket pjesës së rregullimit të marrëdhënieve pasurore të partnerëve jashtëmartesorë, mund të thuhet se partnerët jashtëmartesor janë barazuar thuajse plotësisht me bashkëshortët martesorë pasi zbatohen të njejtat rregulla të cilat zbatohen për bashkëshortët martesor në varësi të regjimit pasuror i cili është në fuqi.

⁴⁷ Emine Zendeli : Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve – 2017, fq.13

⁴⁸ Po aty, fq.13

⁴⁹ Hamdi Podvorica: “E drejta Familjare” – Prishtinë, 2005 , fq.143

⁵⁰ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi : “E drejta Familjare” – Prishtin, 2007, fq.191

5. Regjimi pasuror i kontraktuar (subsidiar)

Përveç regjimit ligjor si regjim i obligueshëm në një numër të madh shtetesh egzistojnë edhe regjimi i kontraktuar (subsidiar). Regjimi i kontraktuar (subsidiar) nënkupton që bashkëshortët me kontratë mund të zgjedhin ndonjë nga regjimet tjera egzistuese dhe t'i shmangen regjimit ligjorë. Me ndihmën e këtij regjimi i cili është gjithnjë e më i pranishëm thuajse në të gjitha shtetet, bashkëshortët kanë mundësi që marrëdhëniet e tyre juridiko-pasurore t'i rregullojnë në atë mënyrë të cilën do e përcaktojnë me marrëveshje vetë bashkëshortët.

Regjimi i kontraktuar pasuror i bashkëshortëve, u jep të drejtën bashkëshortëve që të lidhin kontratën martesore, me të cilën përcaktojnë pozitën e tyre Juridiko – Pasurore në martesë⁵¹. Bashkëshortët me anë të kontratës martesore e deklarojnë vullnetin e tyre të lirë, me të cilën ju shmangen dispozitave ligjore për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-pasurore të bashkëshortëve, dhe përcaktohen për ndonjë mënyrë tjetër të rregullimit të marrëdhënieve pasurore.

Mund të ndodh që bashkëshortët të mos kenë dëshirë të lidhin kontratë martesore, duke menduar se me lidhjen e kontratës martesore humbë ajo lidhja emocionale në mes tyre dhe se martesës i mveshet karkateri pasuror. Në këto situata kur bashkëshortët nuk lidhin kontratë martesore, për të përzgjedhur ose përcaktuar një regjim të kontraktuar (subsidiar), atëher me automatizëm zbatohet regjimi ligjor.

Regjimi i kontraktuar pasuror i bashkëshortëve është një mundësi që u ofrohet bashkëshortëve në shtetet evropiane, ku sipas këtij regjimi i cili po afirmohet gjithnjë e më shumë respektohet autonomia e vullnetit të palëve, atyre u lejoheq që marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre t'i rregullojnë në mënyrën të cilën e përcaktojnë vetë me marrëveshje. Mundësitë të cilat i kanë në disponim bashkëshortët varen nga regjimi pasuror ligjor që është në fuqi, kështu në qoftë se kemi regjimin ligjor të pronësisë së përbashkët, bashkëshortët mund ta ndyshojnë regjimin pasuror përkatës dhe të kontraktojnë ndonjërin nga rregjimet subsidiare, si përshebull: Regjimi i pasurisë së ndarë, Regjimin e vlerës së shtuar ose ndonjë regjim të përzier (mix).

⁵¹ Emine Zendeli : Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve – 2017, fq.15

Kapitulli i II

1.Regjimi pasuror i bashkëshortëve në të drejtën e Republikës së Maqedonsië së Veriut

Me lidhjen e martesës krijohet një tërësi e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet bashkëshortëve, njëkohësisht me lidhjen e martesës paraqitet edhe bashkësia jetësore - jetesa e përbashkët e bashkëshortëve, në të cilën bashkësi realizohen interesat pasurore respektivisht funksioni ekonomik i martesës brenda amvisërisë së përbashkët. Për plotësimin e nevojave jetësore dhe ekonomike që do të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë jetësore, bashkëshortët krijojnë të mira materiale gjatë kohëzgjatjes së martesës, sjellin të mirat materiale që i kanë pasur para lidhjes së martesës po ashtu fitojnë të mira materiale nëpërmjet trashëgimisë, legut, dhuratës. Po ashtu gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore bashkëshortët hynë edhe në marrëdhëniet detyimore me persona tjerë p.sh. kontrata për mbajtjen e përjetshme etj.

Bashkëshortët në të shumtën e rasteve nuk janë të vetëdijshëm për rëndësin që kanë marrëdhëniet juridiko pasurore për atë kohë sa marrëdhëniet ndërmjet tyre janë të harmonizuara dhe stabile. Në situata kur paraqiten mosmarrëveshje që shpijnë deri në pushimin e martesës, paraqitet nevoja që të zgjidhen pasojat juridike cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, e këto situata zgjidhen me ndihmën e institutit të regjimit pasuror të bashkëshortëve.

Termi regjim pasuror nënkupton: Tërësinë e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridiko pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe marrëdhëniet pasurore që krijohen mes bashkëshortëve dhe personave të tretë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut bashkëshortët i nënshtrohen regjimit ligjor si regjim i vetëm pasuror, pra ata nuk kanë mundësi që të kontraktjnë ndonjë regjim tjetër.

Si regjim ligjor në Republikën e Maqedonisë së Veriut paraqitet regjimi i pronësisë së përbashkët, i cili regjim është i rregulluar me dispozitat e *Ligjit për*

pronësi dhe të drejta tjera sendore i nxjerur në vitin 2001⁵², edhe përkundër faktit që martesë si institucion dhe marrëdhëniet tjera ndërmjet bashkëshortëve trajtohen dhe rregullohen me ligjin për familje⁵³. Gjatë përpilimit të neneve me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, ligjdhënësi është mbështetur në principin e barazisë dhe solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve, duke pasur parasysh që edhe ligji për familjen theks të veçantë i kushton parimit të barazisë, ku thotë: Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve themelohen në bazë të vendimit të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesën, në *bazë të barazisë së tyre, respektit reciprok dhe ndihmës së ndërsjelltë*⁵⁴.

1.1. Aspekti historik i rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në RMV deri në nxjeren e ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore të vitit 2001

Marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve vite me radhë nuk ju është kushtuar trajtim specifik, ku edhe ditëve të sotme vazhdohet me të njejtin avaz. Këto marrëdhënie janë trajtuar në kuadër të marrëdhënieve familjare dhe janë rregulluar me norma imperative (detyruse), edhe ditve të sotme qëndron e njëjta vetëm me një ndryshim të vogël pasi që marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë përfshi në ligjin për pronësi dhe të drejta tjera sendore e jo në ligjin për familje.

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë konsideruar si më pak të rëndësishme, gati për një gjysëm shekulli të sistemit shoqëror socialist në ish Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Republika e Maqedonis së Veriut, si njësi federale e ish shtetit socialist RSFJ-së, për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve i mbeti besnike sistemit socialist të vedneve të Evropës lindore, të cilat shpesh të detyrojnë familjare nga korpusi i së drejtës civile, gjë që u manifestua edhe me nxjerrjen e ligjeve të veçanta nga lëmia e të drejtës familjare, kështu: Hungaria nxori ligj për martesën (1952); Rumania nxori ligj për familjen (1953); Polonia nxori ligj për familjen dhe kujdestarinë (1964) etj.⁵⁵

⁵² "Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore" (Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/ 05 Mars 2001) – Tekst i konsoliduar.

⁵³ "Ligji për familje" (Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.80/ 22 Dhjetor 1992) – Tekst i konsoliduar

⁵⁴ Neni 6 i "Ligji për familje" (Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.80/ 22 Dhjetor 1992) – Tekst i konsoliduar

⁵⁵ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.35

1.1.1. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve deri në nxjerjen e ligjit për martesë nga Republika Popullore Federative e Jugosllavisë në vitin 1946

Në të drejtën e Jugosllavisë së vjetër marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë rregulluar me norma të Kodit Civil Serb (1844), Kodit të përgjithshëm pasuror Austriak (1811), Kodit të përgjithshëm pasuror të Malit të Zi (1888). Ndërsa pjestëtarët e fesë islame, të cilat jetonin në teritorin e Jugosllavisë së vjetër marrëdhëniet e tyre pasurore i rregullonin me dispozita të drejtës së sheriatit, të cilat ishin të përmbajtura në Kuran dhe në Kodin Civil Osman Mexhele, i cili u nxor në vitin 1877.⁵⁶

Në periudhë para luftës së dytë botërore në të drejtën e ish Jugosllavis, pronësia e përbashkët si institut juridik nuk ka figuruar, por është mbrojtur ideja se gjithçka që është fituar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore i ka takuar burrit, deri sa nuk argumentohet e kundërta. Kjo situat mund të mund të shihet edhe nga nenet 109, 110, të Kodit Civil të Mbretërisë Sërbe (1844)⁵⁷ ku thuhet: “*Neni 109*⁵⁸ - Veçanërisht, burri konsiderohet si koka dhe udhëheqësi i shtëpisë dhe i farefisit, dhe për këtë arsye është detyrë e tij, të jetë koka e shtëpisë dhe të menaxhojë me pasurinë, ta furnizojë gruan e tij dhe sipas mundësive të kujdeset, ta mbrojë atë nga çdo tundim dhe ta përfaqësojë atë në çdo vend; ndërsa në *Nenin 110*⁵⁹ - Gruaja, megjithatë, është e detyruar t'i bindet burrit të saj, t'iu bindet urdhrave të tij, të shkojë pas tij dhe ku ai mendon se është mire për të, të jetojë me të atje; për ta ndihmuar atë në përpjekjet e veta në administrimin e punëve të shtëpisë, në blerjen, dhe veçanërisht në ruajtjen e pasurisë, si dhe për të ndihmuar në mirëmbajtjen e shtëpisë dhe pastërtinë, e veçanërisht në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pastërtisë dhe mirëqenjen e fëmijëve.” Edhe pse regjimi ligjor në Jugosllavin e vjetër nuk ka paraparë pronësinë e përbashkët, megjithatë, regjimi i pasurisë së përbashkët ka mundur të kontraktohet.⁶⁰

⁵⁶ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.36

⁵⁷ Kodi civil i Mbretërisë Serbe 11 Mars 1844 <https://www.overa.rs/gradanski-zakonik-kraljevine-srbije-1844-god-sa-kasnijim-izmenama.html> (parë më 18.12.2019)

⁵⁸ Neni 109 i “Kodit civil të Mbretërisë Sërbe” – 11 Mars 1844

⁵⁹ Neni 110 i “Kodit civil të Mbretërisë Sërbe” – 11 Mars 1844

⁶⁰ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.36

Në sistemin ligjor të ish Jugosllavisë i cili ka qenë aplikativ para luftës së dytë botërore, ishin të njohura dy regjime të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, si: 1. *Regjimi i pasurisë së ndarë*; 2. *Regjimi pasuror i kontraktuar*.

1.1.1.1. *Regjimi ligjor i pasurisë së ndarë*

Regjimi ligjor i pasurisë së ndarë ishte i njëjt si në kohën e sotme, pra e gjithë pasuria të cilën e kanë pasurë para se të lidhin martesë dhe ajo të cilën do ta fitojnë gjatë kohëzgjatjes së bashkësis martesore ngelen si pasuri e veçantë e çdonjërit nga bashkëshortët, dhe ato kanë të drejtë që çdonjëri nga bashkëshortët të administroj dhe disponoj me pasurin e vetë. Ato kishin mundësi që në lidhje me administrimin dhe disponimin e pasurisë të merreshin vesht edhe ndryshe duke lidhur kontrat, pra që njëri prej bashkëshortëve të administroj dhe disponojë me pasurin e bashkëshortit tjetër.

Edhe përkundër faktit se e tërë pasuria që e posedonin dhe atë që do e fitonin bashkëshortët ishte e ndarë ndërmjet tyre, mirëpo nga ndikimi i rregullave patriakale kjo ndarje nuk respektohej dhe gjithçka që fitohej gjatë martesës i takonte burrit e ndërsa gruas nuk i jepej asgjë. Ky ishte një supozim ligjor i cili mundë të rrëzohej në procedurë gjyqësore, ku do të arrimentohej e kundërta.

Fakti, se burri edhe përkundër pasurisë së ndarë, megjithatë administronte me pasurinë e gruas, mund të argumentohet edhe me anë të një dispozite të kodit civil serb, sipas të cilës: “Sendet e luajtshme, të cilat në cilësinë e dhuratës, gruaja i sillte në martesë, dhe që shfrytëzoheshin për nevojat e saja ose të bashkëshortit, ngelin në pronësi të veçantë të bashkëshortes, e cila administronte me to. Me këto sende mund të administronte edhe bashkëshorti, mirëpo nuk kishte të drejtë të dispononte, por edhe gruaja nuk mund të dispononte me to pa lejen e bashkëshortit”.⁶¹

1.1.1.2. *Regjimi pasuror i kontraktuar*

Regjimi pasuror i kontraktuar ju jep mundësin bashkëshortëve që të shmangin zbatimin e regjimit ligjor si regjim i detyrueshem, ku nëpërmjet kontratës martesore ato rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre ndryshe nga ajo që parashihet me ligj. Bashkëshortët me anë të kontratës martesore mundë të kontraktonin disa

⁶¹ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.37

regjime, si: a) Regjimi i mehrit; b) Regjimi i mirazit; c) Regjimin e bashkësis së përgjithshme pasurore:

a) Regjimi i mehrit – ishte regjim për të cilin bashkëshortët mundeshin të përcaktohen vetëm nëse lidhnin kontratë, ky regjim buronte nga e drejta e shariatit dhe ishte në dispozicion për bashkëshortët musliman të cilët jetonin në teritorin e Jugosllavisë së vjetër. Me anë të Mehrit (Dhurata e kurorës) i është kushtuar rëndësi përkujdesjes ndaj gruas dhe respektimit të saj duke i dhënë të drejtën e posedimit të pasurisë duke pasur parasysh se një kohë të gjatë gruas i janë mohuar të drejtat dhe kujdestari i saj ka zotëruar gjithë pasurinë e saj duke mos i dhënë mundësi që të posedojë pasuri dhe të menaxhjë pasurinë e saj.

Feja islame e ka çliruar gruan nga kjo padrejtësi duke e obliguar mehrin mbi burrin dhe duke e bërë atë të drejtë të gruas dhe jo të babait të saj, asnjëri prej të afërmëve të saj nuk ka të drejtë të marrë diçka nga pasuria e saj përveç me lejen dhe pëlqimin e saj.⁶² Pra regjimi i mehrit është një obligimi material i burrit ndaj bashkëshortes së ardhshme legjitime, i cili jepet në formë të ndryshme dhe në kohë të caktuar, si një kompensim për hyrjen e saj nën kurorë dhe me qëllim të sigurimit ekonomik të saj⁶³. Por, qëllimi i regjimit të mehrit nuk ishte vetëm kjo, pasi ajo kishte për qëllim të sigurojë edhe kontratën e kurorëzimit, pasi mbronte nga rastet e shkurorëzimit të pa arsyeshme ose në rastet e vdekjes së burrit të mos ngelet pa të mira materiale. Në realitet kjo mund të realizohet kurdoqoftë prej fillimit të martesës, nëse gruaja këtë e kërkon.

b) Regjimi i mirazit – Në Jugosllavinë e vjetër, para Luftës II Botërore, instituti i mirazit gjente gjerësisht zbatim. Për këtë arsye ai rregullohej në mënyrë të detajuar nga Kodi Civil Serb me një sërë dispozitash. Me termin “miraz” nënkuptohej ajo pasuri, të cilën e sillte gruaja në martesë, me qëllim të lehtësimit të jetës së përbashkët bashkëshortore. Regjimi i mirazit mund të krijohet vetëm me kontratë. Si rregull kryesor në këtë regjim shfaqet e drejta e burrit për ta përdorur pasurinë, që gruaja me kontratë të veçantë sillte në martesë, qoftë si pasuri të saj vetjake, qoftë si pasuri të fituar nga prindërit apo persona të tretë.⁶⁴

⁶² Sejjid Sabik: “Fikhus Sunne” - KNJIGA3 Sarajevo, 2008, fq.311

⁶³ <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=8911> (parë më 11.12.2019)

⁶⁴ Albana Metaj-Stojanova: “Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin Shqiptar”, Tiranë 2019, fq.53

Objekt i mirazit mund të ishin sende: të luajtshme, të paluajtshme, të konsumueshme dhe të pa konsumueshme, të cilat kanë vlerë pasurore dhe mund të jenë objekt i kontratës së shitblejres. Objekt i mirazit mund të ishin edhe sende të cilat guraja i fitonte nëpërmjet trashëgimisë gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Vëllimi i autorizimeve që kishte burri mbi pasurinë, që përbënte mirazin varej nga lloji i sendeve për të cilat bëhej fjalë – (para, sende të luajtshme a të paluajtshme, të konsumueshme apo të pakonsumueshme). Nëse sendi ishte i pakonsumueshëm, gruaja ruante të drejtën e pronësisë, por, megjithatë, burri kishte të drejtën e frutgëzimit. Bashkëshorti kishte të drejtën të shpenzonte të hollat apo të harxhonte sendet e tjera të luajtshme që ishin objekt i mirazit, por gruaja kishte të drejtën e hipotekës ligjore mbi pasurinë e burrit për sigurimin e mirazit. Nëse objekt i mirazit ishin sendet e paluajtshme, bashkëshortja e ruante pronësinë mbi to, ndërsa bashkëshorti kishte të drejtën e përdorimit apo frutgëzimit. Pas zgjidhjes së martesës, burri detyrohej të kthente mirazin ose nëse ai ishte shpenzuar, kundërvlerën e tij në të holla.⁶⁵

c) Regjimi i bashkësisë së përgjithshme të pasurisë – po ashtu ishte regjim të cilin bashkëshortët mund ta vendosnin vetëm me kontratë. Për nga funksionimi ishte tepër i ngjashëm me regjimin e pasurisë së përbashkët, me disa ndryshime të vogla pasi ju lejonte bashkëshortëve të përcaktonin se a do ta përfshinin tërë pasurinë e tyre apo një pjesë të caktuar të pasurisë së tyre si pjesë e bashkësisë pasurore. Edhe pse në parim me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve administronte burri, mirëpo bashkëshortët kishin mundësi që me kontratë të përcaktojnë që administrimi dhe disponimi me pasurinë e bashkësisë të mos jetë e drejtë ekskluzive burrit, duke rrugatur çdonjëri të drejtën që të administrojë dhe disponojë me pjesën e vet.

Kodi Civil i Mbretërisë Serbe ishte i ndikuar pothuajse tërësisht nga Kodi Civil Austriak i vitit 1811, me disa përjashtime të diktuar nga ndikimi i ndjeshëm i të drejtës zakonore serbe në rregullimin e marrëdhënieve familjare⁶⁶. Ky kod ka vepruar dhe në territorin e Maqedonisë së Veriut deri në vitin 1946, kur federatat e

⁶⁵ Albana Metaj-Stojanova: “Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin Shqiptar”, Tiranë 2019, fq.53-54

⁶⁶ Stanimirovik Vojislav: “Snaga Obicaja – Porodica u Srpskom Graganskom Zakoniku Imzegu Starog i Novog”, në Srpski Graganski Zakonik – 170 Godina, (ed.) Milena Polojac, Zoran Mirkovic, Marko, Gurgevic, Beograd 2014, fq.145-165

veçanta të ish Jugosllavisë krijojnë sisteme të veçanta juridike si dhe legjislacionet e tyre përkatëse⁶⁷.

1.1.2. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me “Ligjin për martesë” të vitit 1946

Përfundimisht pas mbarimit të luftës së dytë botërore, në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë u nxor ligji i ri i cili do të rregullonte lëmin e të drejtës familjare, më saktësisht martesën. Ky ligj u nxjer në prill të vitit 1946 dhe u emërua si “Ligji bazë për martesën”⁶⁸, ky ligj gjithashtu rëndësi i kushtoi edhe rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve duke vendosur një regjim ligjor, pra regjimin e pasurisë së përbashkët.

Edhe në atë periudhë bashkëshortët kanë pasur pasurinë e tyre të veçantë dhe pasurinë e përbashkët, për të sqaruar më hollësisht këtë do të ndalemi në nenin 9 dhe nenin 10 të ligjit për martesën, ku në nenin 9 thuhet: “Pasurinë të cilin e ka njëri nga bashkëshortët në kohën e lidhjes së martesës mbetet në pronësinë e tij, dhe ai ose ajo mbajnë të drejtën që të administrojnë dhe disponojnë në mënyrë të pavarur”⁶⁹; ndërsa në nenin 10 thuhet: “Pasurinë të cilën bashkëshortët e kanë fituar me punë gjatë kohëzgjatjes së martesës është pronësi e tyre e përbashkët. Se sa e madhe është pjesa e çdonjërit nga bashkëshortët në pasurinë e përbashkët, në rast të konfliktit e përcakton gjykata sipas kontributit të tyre, duke vlersuar të gjitha rethanat. Përveç kësaj do të merret parasysh jo vetëm të ardhurat e secilit bashkëshort, por edhe ndihma e njërit bashkëshortë ndaj tjetrit, për udhëheqjen e punëve shtëpiake, për kujdesin për mirëmbajtjen e pronave dhe për çdo formë tjetër të punës dhe bashkëpunimit në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ritjen e pasurisë së përbashkët”⁷⁰.

Pra, ky ligji rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve e bën me anë të normave imperative, që do të thotë se bashkëshortët me anë të kontratës martesore nuk mund të shmangin zbatimin e regjimit ligjor më konkretisht të zgjedhin ndonjë regjim tjetër, si përshembull: regjimi i pasurisë së ndarë. Mirëpo ky

⁶⁷ Abdulla Aliu: “E drejta civile” – Prishtin, 2013. fq.73

⁶⁸ “Ligji bazë për martesën” – Gazeta zyrtare e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, nr.29/1946, e publikuar me 09.04.1946

⁶⁹ Neni 9 i “Ligjit bazë për martesën” - Gazeta zyrtare e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, nr.29/1946, e publikuar me 09.04.1946

⁷⁰ Neni 10 i “Ligjit bazë për martesën” - Gazeta zyrtare e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, nr.29/1946, e publikuar me 09.04.1946

ligj lejon që bashkëshortët të lidhin ndërmjet tyre të gjitha kontratat të cilat nuk janë në kundërshtim me ligjin, dhe me to të themelojnë të drejta dhe detyrime.

Pastaj në vitin 1965 u nxjer versioni i konsoliduar (i spastruar) i “Ligjit bazë për martesën”⁷¹, mirëpo nuk kishte asnjë ndryshim në përmbajtjen e dispozitave të cilat rregullonin marrëdhëniet juridiko-pasurore të bashkëshortëve, përveç ndryshimit të radhitjes së neneve, ku u bë bartja e tyre nga neni 9 dhe 10, në nenet 7 dhe 8 - në tekstin e konsoliduar të ligjit bazë për martesë.

1.1.3. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me “Ligjin për martesë” të vitit 1973

Në shtator të viti 1973 Republika Socialiste e Maqedonisë solli ligj të ri me të cilin do të rregullohej lëmia e martesës, i cili ligj u emërua njëjtë “Ligji për martesë”⁷². Ky ligj gjithashtu i ka kushtuar rëndësi rregullimit të marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve duke trajtuar këto marrëdhënie në mënyrë më të detjauar. Edhe ky ligj kishte paraparë një regjim ligjor pra regjimin e pasurisë së përbashkët duke mos ju lënë bashkëshortëve mundësi që t’i shmangen zbatimit të regjimit ligjor.

Ligji për martesë i viti 1973⁷³ në mënyrë të njëjtë e definoi pasurinë e veçantë dhe pasurinë e përbashkët, por në kuptim më të gjërë dhe më të kuptueshëm. Në vijim do të citohen disa pjesë më të rëndësishme nga nenet me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve.

Pasuria të cilën njëri nga bashkëshortët e kishte në kohën e lidhjes së martesës paraqetë pasurinë e tij të veçantë. Si pasuri e veçantë do të konsiderohet edhe pasuria dhe të drejtat mbi pasurinë që bashkëshorti do ta fitojë në bazë të trashëgimisë, legut ose dhuratës, si dhe sendet që shërbejnë vetëm për plotësimin e nevojave personale të njërit prej bashkëshortëve, përveç nëse ato nuk paraqesin në mënyrë disproporcionale vlerë të lartë krahasuar me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët.⁷⁴

⁷¹ Ligji bazë për martesën” – Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, nr.28/1965, e publikuar me 23.06.1965

⁷² Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë, nr.35/1973, e publikuar me 15.10.1973

⁷³ Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë, nr.35/1973, e publikuar me 15.10.1973

⁷⁴ Neni 30 i “Ligjit për martesë” – 1973, Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë, nr.35/1973

Pasurinë të cilën bashkëshortët do ta fitojnë gjatë martesës paraqet pronën e tyre të përbashkët⁷⁵, me të cilën bashkëshortët bashkërisht dhe me marrëveshje administrojnë dhe disponojnë⁷⁶. Bashkëshortët mund të meren vesht që administrimin dhe disponimin me pasurinë e përbashkët ose një pjesë të sajë ta kryej vetëm njëri prej tyre⁷⁷. Kontrata mund të referohet për të gjitha çështjet e administrimit dhe disponimit, ose vetëm për administrimin e rregullt ose për punë të caktuara saktësisht⁷⁸. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, administrimi përfshinë edhe disponimin në kornizë të punëve të zakonshme⁷⁹. Për kryerjen e punëve që tejkalojnë kornizën e administrimit të rregullt të pasurisë kërkohet pëlqimi i bashkëshortit tjetër, të shprehur në formën e cila kërkohet për veprimin e duhur juridik⁸⁰.

Gjatë kohëzgjatjes së martesës, bashkëshortët mund të ndajnë pasurinë e përbashkët vetë ose ta kërkojnë atë nga gjykata në procedurë jashtëkontestimore. Me ndarjen e pasurisë së përbashkët ndërmjet bashkëshortëve, krijohet regjimi i pasurisë së veçantë në lidhje me pasurinë e fituar deri në rastin e ndarjes.⁸¹

Me përfundimin e martesës, bashkëshortëve u takon nga një pjesë e barabartë nga pasuria e përbashkët. Me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve, gjykata mund t'i caktojë pjesë më të madhe nga pasuria e përbashkët, nëse e dëshmon se kontributi i tij në pasurinë e përbashkët është dukshëm dhe në mënyrë të konsiderueshme më i madh se ai i bashkëshortit tjetër.⁸²

Bashkëshortët mund që ndërmjet tyre të lidhin kontrata që nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe me ato të vendosin të drejta dhe detyrime.⁸³

⁷⁵ Neni 31 i "Ligjit për martesë" – 1973, Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë, nr.35/1973

⁷⁶ Ibid., Neni 31

⁷⁷ Ibid., Neni 33

⁷⁸ Ibid., Neni 33

⁷⁹ Ibid., Neni 33

⁸⁰ Ibid., Neni 34

⁸¹ Ibid., Neni 35

⁸² Ibid., Neni 37

⁸³ Ibid., Neni 40

1.1.4. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me “Ligjin për familje” të vitit 1992

Në dhjetor të vitit 1992 pas pavarësisë, Republika e Maqedonisë nxori ligjin e parë me të cilin do t'i rregullonte marrëdhëniet familjare, martesore, adoptimin, etj. Ky ligj u emërtua “Ligji për familje”⁸⁴ - (LF), edhe pse i nxjerë në vitin 1992 ende edhe sot e kësaj dite është në fuqi me disa ndryshime. Mirëpo vlen të ceket që në 9 vitet e para të egzistimit të tij, ky ligj në materien e tij ka përfshirë edhe rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, për rregullimin e të cilave janë përpiluar 16 nene.⁸⁵ Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve ka qenë thuajse identik me atë të ditëve të sotme në “Ligjin për pronësi dhe të drejta tjera sendore”, dhe për këtë arsye nuk do të ndalemi që ti sqarojmë në mënyrë të detajuar pasi që do të sqarohen në pjesën në vijim si pjesë e ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore.

Vlenë të theksohet se ky ligj krahasuar me ligjet e mëparshme të cilat kanë rregulluar marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, për herë të parë përfshin rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesorë, pra për herë të parë barazohet bashkësia jashtëmartesore me bashkësin martesore sa i përket pasurisë së krijuar në bashkësi.⁸⁶

Konsideroj se arritje tjetër pozitive e këtij ligji është zgjidhja sipas të cilës me rastin e ndarjes së pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, bashkëshortit të cilit i janë dhënë fëmijët për ruajte dhe edukim, duhet t'i jepen edhe sendet nga pronësia e përbashkët që u shërbejnë fëmijëve.⁸⁷

2.Regjimi pasuror ligjor i bashkëshortëve – sipas Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore 2001

Që nga viti 2001 kur është sjellur Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore⁸⁸ – (LPDTS), normat të cilat rregullonin marrëdhëniet juridiko-pasurore të bashkëshortëve kaluan nga “ligji për familje” i viti 1992 në materien e Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore. Ky ndryshim u prit me mjaft entuziazëm pasi

⁸⁴ “Ligji për Familje” – Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/1992 e publikuar me 22.12.1992

⁸⁵ Nenet 203 – 218 të “Ligji për Familje” – Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/1992

⁸⁶ Neni 218 i Ligji për Familje” – Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/1992

⁸⁷ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.40

⁸⁸ “Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore” – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001 e publikuar me 05.03.2001

pritej që të sillte ndryshime të mëdha në sistemin juridik për sa i përket rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve pasi që gati të gjitha shtetet këto marrëdhënie i rregullonin me ligje familjare, e rregullimi i tyre në LPDTS pritej që të kishte një qasje më të gjërë, më të hollësishme dhe të detajuar, po ashtu në të njëjtën kohë pritej që ti jepej rëndësi parimit të autonomis së vullnetit për tu përshtatur me ligjet evropiane. Edhe përkundër pritshmërive të mëdha për ndryshim ky ligj nuk solli asnjë risi përveç se një transferim i neneve nga LF në LPDTS të RMV.

Aktualisht sipas të drejtës pozitive të RMV, respektivisht sipas LPDTS, marrëdhëniet juridiko pasurore të bashkëshortëve regullohen me nenet 66-81 të të njëjtit ligj, vlen të theksohet se egzistonë vetëm regjimi ligjor, pra nuk kemi regjime subsidiare, të cilët bashkëshortët do mund t'i zgjidhnin me kontratë, si regjim ligjor kemi *Regjimin e pasurisë së përbashkët*, ndërsa pasuria e bashkëshortëve mund të jetë e veçantë dhe e përbashkët.

2.1.Pasuria e veçantë

Pasuri e veçantë e bashkëshortëve konsiderohet pasuria e çdonjërit nga bashkëshortët, e cila nuk i është nënshtruar regjimit juridik të pasurisë së përbashkët.⁸⁹

Pasuria e veçantë – konsiderohet pasuria të cilën njërit prej bashkëshortëve e ka pasur në momentin e lidhjes së martesës dhe paraqitet si pasuri e veçantë e tij. Në pasurinë e veçantë hynë edhe pasuria që njëri prej bashkëshortëve do ta fitojë gjatë kohëzgjatjes së martesës mirëpo në bazë të trashëgimisë, legut, dhuratës etj. Po ashtu vlenë të theksohet se në pasurinë e veçantë të njërit bashkëshortë, përfshihen edhe sendet e fituara në martesë, por të cilat shërbejnë vetëm për kënaqjen e nevojave personale të njërit bashkëshort, me kusht që ato të mos paraqesin një vlerë të lartë që është në disproporcion të madh në krahasim me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët.

Duke e ndarë në disa kategori pasuria e veçantë e bashkëshortëve konsiderohet: 1.Pasuria që bashkëshortët e kanë pasur në momentin e lidhjes së

⁸⁹ Emine Zendeli: Perspektiva e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë, - Shkup 2014, fq.6

martësës; 2.Të ardhurat nga pasuria e veçantë, me kusht që mos jetë kontribuar me punë për fitimin e tyre; 3.Pasurinë që bashkëshortët e fitojnë gjatë martësës por në bazë të dhuratës; trashëgimisë; legut; 4.Pasuria që do t'i takojnë bashkëshortit kur të bëhet ndarja e pasurisë së tyre të përbashkët; 5.Pasuria që gruaja e sjell në martësë në momentin e lidhjes së martësës ose gjatë kohëzgjatjes së saj.

Çdonjëri nga bashkëshortët administron dhe disponon në mënyrë të pavarur me pasurinë e veçantë, përveç nëse bashkëshortët nuk meren vesh (dakordohen) ndryshe në formë me shkrim.⁹⁰ Pasi që ato kanë mundësi që me kontratë ta autorizojnë bashkëshortin tjetër që të administroj dhe disponoj me pasurin e veçantë të bashkëshortit.

2.2.Pasuria e përbashkët

Pasuri e përbashkët - Konsiderohet pasuria që bashkëshortët e fitojnë apo krijojnë me punë gjatë kohëzgjatjes së martësës. Pasuri e përbashkët konsiderohet edhe ajo të cilën bashkëshortët e fitojnë nëpërmjet dhuratës e cila u është bërë të dy bashkëshortëve, të ardhurat të cilat i realizojnë nga sendet në pronësi të përbashkët, nga kamata e mjeteve të deponuara, të ardhurat nga sendet në pronësi të veçantë por të cilat janë fituar me kontribut, pra me punë.

Regjimi i pasurisë së përbashkët dominon për shumë vite si regjim pasuror i vetëm në RMV-së por edhe në ish RSFJ-së pasi që nuk ka regjime tjera subsidiare. Ky dominim i përgjigjet frymës së barazisë midis burrit dhe gruas, pasi që si punë llogariten edhe punët që nuk sjellin të ardhura materiale siç janë: 1.Rritja dhe edukimi i fëmijëve; 2.Punën në amëvisëri – përgaditja e ushqimit, pastrimi, mirëmbajtja e shtëpis.

E drejta e pronësisë së bashkëshortëve mbi pasuritë e paluajtshme, që hynë në pasurinë e tyre të përbashkët, regjistrohet në librat publik në emër të dy bashkëshortëve si pasuri e tyre e përbashkët⁹¹. Nëse vetëm një nga bashkëshortët është regjistruar në librin publik si pronar i pronës së përbashkët, regjistrimi do të konsiderohet se është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Nëse të dy bashkëshortët janë regjistruar në librat publik si bashkëpronarë të pjesëve të

⁹⁰ Neni 68 i "Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore" – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

⁹¹ Ibid., Neni 69

caktuara, do të konsiderohet se në këtë mënyrë i kanë përcaktuar pjesët e pasurisë së përbashkët.⁹²

2.2.1.Kushtet e krijimit të pasurisë së përbashkët

Vetëm me përmbushjen e kushteve të parashikuara nga ligji, mund të përcaktohet nëse e drejta e pronësisë do të hyjë në pronësinë e përbashkët të subjekteve të caktuara.⁹³ Edhe pse LPDTS i RMV gjatë definimit të pasurisë së përbashkët nuk e përmend punën si kusht për krijimin e pasurisë së përbashkët mirëpo len të nënkuptohet, që përveç egzistimit të bashkësisë martesore duhet të plotësohet edhe kushti tjetër puna pasi ajo logjikisht as që mund të përjashtohet. Në shumicën e legjislacioneve, ndër të cilat bëjnë pjesë dhe të gjitha legjislacionet e ish vendeve jugosllave, pasuria e përbashkët përkufizohet si e drejtë pronësie mbi sendet që bashkëshortët i fitojnë me punë gjatë jetës bashkëshortore. ajo logjikisht as që mund të përjashtohet.⁹⁴

Pra, si kushte për fitimin e pronësisë (pasurisë) së përbashkët të bashkëshortëve në vendet e ish Jugosllavisë theksohen: puna dhe bashkësia jetësore e bashkëshortëve.⁹⁵ Nga e gjitha kjo del që për krijimin e pasurisë së përbashkët duhet të plotësohen dy kushte: a) Egzistimi i bashkësisë martesore; dhe b) Puna e bashkëshortëve;

a) Egzistimi i bashkësisë martesore apo bashkësisë jetësore është kushti i parë i cili duhet të plotësohet që të mund të krijohet pasuria e përbashkët. Ky kusht nënkupton që partnerët përveç se duhet të jenë të martuar, ata gjithashtu duhet të jetojnë bashkërisht në momentin e fitimit të pasurisë, që ajo pasuri të llogaritet si pasuri e përbashkët e tyre. Kjo tregon që martesë nuk duhet të egzistojë vetëm formalisht por ajo duhet të jetë reale, pasi që nuk mund të filtet për egzistimin e pasurisë së përbashkët, deri sa mungon baza juridike mbi të cilën krijohet pasuria e përbashkët.

⁹² Neni 69 i "Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore" – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

⁹³ Gavella, Nikola, Tatjana Josipovic, Igor Gliha, Vlado Belaj, Zlatan Stipkovic: "Stvarno Pravo: Svezak I", Narodne Novine, Zagreb 2007, fq.722

⁹⁴ Albana Metaj-Stojanova: "Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin Shqiptar", Tiranë 2019, fq.81

⁹⁵ Marija Draskic: "Porodичno Pravo i Prava Deteta", - Beograd, 2005, fq.397 dhe

Alincic M., Hrabar D., Jakovac-Lozic D., Korac Graovac A.: "Obiteljsko Pravo" – Zagreb, 2007, fq.501

Kur bashkëshortët ndërpresin jetesën e përbashkët martesore, qoftë për shkak të trazimit të marrëdhënieve martesore apo për ndonjë shkak tjetër, të paraparë me dispozita ligjore, atëher pasuria që krijohet është pasuri e veçantë, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me martesat e quajtura “të vdekura”.⁹⁶ Këto martesë egzistojnë vetëm juridikisht në letër, sepse bashkëshortët martesorë nuk jetojnë bashkërisht, ashtu që nuk egziston baza ligjore për lindjen apo krijimin e pasurisë së përbashkët.⁹⁷ Nga kjo që u tha më lartë nënkuptojmë që pavarësisht asaj se martesë juridikisht ende nuk ka pushuar, pasuria të cilën do ta fitojnë bashkëshortët gjatë kohës kur bashkësia jetësore ka pushuar do të konsiderohet pasuri e tyre e veçantë.

b) Puna e bashkëshortëve konsiderohet si kushti i dytë për krijimin e pronësisë së përbashkët, qoftë ajo punë e përbashkët në bujqësi, zejtari apo tregti, qoftë puna e ushtruar veçmasi nga bashkëshortët në veprimtari apo profesione të ndryshme. Kontributi për krijimin e pasurisë së përbashkët mund të jetë i drejtpërdrejtë, nga të ardhurat nga puna, ose i tërthortë, kur puna e njërit bashkëshort mundësohet nga ndihma e tjetrit, që nuk punon jashtë familjes, por përkujdeset për amvisërinë dhe rritjen e fëmijëve.⁹⁸

2.2.2. Objekt i pasurisë së përbashkët

Objekt i pasurisë së përbashkët janë të gjitha të drejtat reale dhe të drejtat e kërkesave, që do të thotë se në pasurinë e përbashkët bëjnë pjesë të gjitha sendet dhe të drejtat sendore, të tilla si: e drejta e pronësisë, pengut, hipotekës, servitutit, e drejta e pronësisë në kate, si dhe të gjitha kërkesat, frutat civile (si psh. kamatat) dhe detyrimet e krijuara për përmbushjen e nevojave të familjes.⁹⁹ Në pasurinë e përbashkët bëjnë pjesë dhe të ardhurat që rrjedhin nga pasuria e përbashkët si dhe sendet e blera nga pasuria e përbashkët ose të shkëmbyera me pasurinë e përbashkët.¹⁰⁰

⁹⁶ Hamdi Podvorica: “E drejta Familjare” – Prishtinë, 2005, fq.242

⁹⁷ Po aty, fq.242

⁹⁸ Albana Metaj-Stojanova: “Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin Shqiptar”, Tiranë 2019, fq.53-54

⁹⁹ Hadzivasilev, Mile, (1987), “Semejno Pravo”, Skopje fq.146

¹⁰⁰ Komar-Janjic, Marina, Radoje, Korac, Zoran, Ponjavic, (1999), “Porodicno pravo”, Izdavacko preduzece “Homoc”, Beograd fq.362

Objekt i pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve janë të gjitha sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat shërbejnë për plotësimin e nevojave jetësore, pasurore, të bashkëshortëve gjatë jetës së përbashkët bashkëshortore.¹⁰¹

Punët juridike komutative me shpërblim janë baza kryesore për krijimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, mirëpo ndonjëherë ndodhë që edhe me punë juridike pa shpërblim të fitohet pasuri e përbashkët si p.sh (dhurata e dedikuar për të dy bashkëshortët, të ardhurat nga lojrat e fatit, si dhe mënyrat tjera të fitimit të pronësisë pa shpërblim). Në shumicën e rasteve, këto janë sende të krijuara nga puna e përbashkët ose e veçantë e bashkëshortëve, por meqenëse ligjvënësi nuk e ka përcaktuar punën si kusht për krijimin e pasurisë së përbashkët, pra nuk ekziston kufizim ligjor, si pasuri e përbashkët do të konsiderohen dhe sendet që janë fituar sipas ndonjë baze tjetër, siç janë dhuratat dedikuar të dy bashkëshortëve.¹⁰²

“Me ligjin për pronësi dhe të drejta tjera sendore të vitit 2001 është marrë qëndrim se në pronësinë e përbashkët të bashkëshortëve bëjnë pjesë:

1. Sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të fituara gjatë kohëzgjatjes së martesës;
2. Të ardhurat që fitohen nga sendet në pronësi të përbashkët;
3. Kompenzimet për sendet që janë shkatëruar ose që janë marrë nga pronësia e përbashkët;
4. Sende të blera nga mjetet e fituar nga shitja e sendeve nga pronësia e përbashkët, ose të fituar me këmbim të sendeve në pronësi të përbashkët;
5. Sendet që shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale të bashkëshortëve ose të njërit nga bashkëshortët;
6. Sendet që shërbejnë për nevojat personale të njërit nga bashkëshortët;
7. Sendet që shërbejnë për kënaqjen e nevojave të përbashkëta të bashkëshortëve;
8. Të holla të kursyera në bashkësin martesore;
9. Sende të fituara nga bashkëshortët jashtëmartesor, të cilët më vonë kanë lidhur martesën.”¹⁰³

2.3.Administrimi dhe disponimi me pasurinë e veçantë dhe me pasurinë e përbashkët

¹⁰¹ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.53

¹⁰² Albana Metaj-Stojanova: “Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin Shqiptar”, Tiranë 2019, fq.86

¹⁰³ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.54

Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore gjithashtu parasheh që bashkëshortët bashkërisht dhe me marrëveshje të administrojnë dhe disponojnë me pasurinë e përbashkët. Me pjesën e vet në pasurinë e përbashkët para se ajo të përcaktohet, bashkëshorti nuk mund të administrojë në mënyrë të pavarur dhe as ta ngarkojë me anë të punëve juridike inter vivos (në mes të gjallëve). Gjatë shitjes së pjesës së caktuar nga pasuria e përbashkët, e cila i takon njërit bashkëshort zbatohen rregullat për parablerje të bashkëpronarëve.¹⁰⁴

Bashkëshortët po ashtu mund të merren vesh në formë të shkruar, që njëri prej tyre të administrojë dhe disponojë me pasurinë e përbashkët ose të paktën me një pjesë të pasurisë së përbashkët. Kontrata mund të lidhet për të gjitha çështjet e administrimit dhe disponimit ose vetëm për administrimin e rregullt ose për punë të caktuara saktësisht. Kur bashkëshortët nuk janë marrë vesh më ndryshe, administrimi do të përfshijë edhe disponimin brenda kornizës së punëve të rregullta.¹⁰⁵

Për kryerjen e punëve të cilat e tejkalojnë fushën e administrimit të rregullt, domethënë kur bëhet fjalë për disponimin me pasurinë, kërkohet që pëlqimi i bashkëshortit tjetër të jetë dhënë në formën e cila kërkohet për punën juridike përkatëse e cila duhet të realizohet.¹⁰⁶

Vlen të theksohet se çdonjëri nga bashkëshortët ka të drejtë që në çdo kohë të prish marrëveshjen e lidhur mes tyre për administrimin ose disponimin me pasurinë e përbashkët. Bashkëshortët nuk kanë një mundësi të tillë vetëm në situata kur me prishjen e marrëveshjes në këtë formë i shkaktohet dëm bashkëshortit tjetër.¹⁰⁷

Ndonjëherë mund të paraqiten situata të komplikuar ku bashkëshortët nuk mund të bien dakord në lidhje me administrimin e pasurisë së përbashkët ose për administrimin e punëve të caktuara, ndërsa asnjëri nga bashkëshortët nuk kërkon që të përcaktohen pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët, e atëherë gjykata mund që

¹⁰⁴ Neni 70 i "Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore" – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

¹⁰⁵ Ibid., Neni 71

¹⁰⁶ Ibid., Neni 72

¹⁰⁷ Ibid., Neni 71

me propozim të njërit prej bashkëshortëve në procedurë jokontestimore, të përcaktojë masat e duhura të cilat i referohen administrimit (menaxhimit).¹⁰⁸

2.4.Pushimi i pasurisë së përbashkët dhe ndarja e saj

Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve, ashtu sikundër edhe të gjitha format e tjera të pronësisë së përbashkët, nuk është kategori e pandryshueshme dhe e përhershme. Prandaj pushimi i kësaj bashkësie, respektivisht ndarja e saj është paraparë me ligj.¹⁰⁹ Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve pushon gjatë martesës ose pas pushimit të martesës:

a) *Pushimi i pronësisë së përbashkët gjatë martesës* – Edhe gjatë kohëzgjatjes së martesës bashkëshortët kanë të drejtë që të bëjnë ndarjen e pasurisë së përbashkët, të cilën e kanë krijuar gjatë martesës, mirëpo kjo nuk do të thotë se ndarja do të vlejë edhe për pasurinë të cilën bashkëshortët do ta krijojnë pas ndarjes, pasuria e mëpastajshme përsëri do të jetë pasuri e përbashkët e tyre. Këtu kemi një përjashtim pasi që ndarjen e pasurisë së përbashkët gjatë martesës mund ta kërkojnë edhe personat e tretë të cilët kanë ndonjë të drejtë, të cilën dëshirojnë ta realizojnë nga njëri prej bashkëshortëve;

b) *Pushimi i pronësisë së përbashkët pas pushimit të martesës* – Dihet që pasuria e përbashkët e bashkëshortëve pushon me pushimin e martesës. Martesa mund të pushojë në disa raste: 1.në rast të shkurorëzimit; 2.në rast të anulimit të martesës; dhe 3.në rast të vdekjes së njërit prej bashkëshortëve ose shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur. Mirëpo vlen të theksohet se ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve më së shpeshti bëhet në rast të shkurorëzimit të martesës.

Si gjatë martesës po ashtu edhe pas përfundimit të martesës, bashkëshortët mund të ndajnë pasurinë e përbashkët në mënyrë miqësore, pra me marrëveshje.¹¹⁰ Me rastin e ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve krijohet regjim i pasurisë së veçantë, apo thën më sakt ajo pjesë që fitohet me ndarjen e pasurisë së përbashkët hynë në pasurin e veçantë të bashkëshortëve.¹¹¹

¹⁰⁸ Neni 73 i “Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore” – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

¹⁰⁹ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve III – 2017, fq.19

¹¹⁰ Vendim i gjykatës themelore Shkupi II “Shkurorëzohet martesa në pajtim me nenin 39 të Ligjit për familje, me pëlqimin e ndërsjellë të bashkëshortëve” - П-1774/10 të datë 01.07.2010

¹¹¹ Neni 74 i “Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore” – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

Mirëpo nëse bashkëshortët nuk mund të merren vesh për ndarjen e pasurisë së përbashkët atëherë, njëri prej bashkëshortëve me kërkesë i drejtohen gjykatës që të bëjë ndarjen e pasurisë së përbashkët në procedurë jokontestimore. Gjatë përcaktimit të pjesëve që u takojnë bashkëshortëve nga ndarja e pasurisë së përbashkët, gjykata fillon nga fakti se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ndahet në pjesë të barabarta.¹¹² Pasi që sipas regjimit ligjor të RMV-së gjithçka që përfshihet në pasurinë e përbashkët, në rastë të pushimit të martesës ajo do të ndahet në pjesë të barabarta për të dy bashkëshortët pra 50% e pasurisë së përbashkët do t'i takoj burrit dhe 50% do t'i takoj gruas.

Mirëpo legjislacioni i RMV-së ka parapar mundësinë që çdonjëri nga bashkëshortët i cili pretendon se ka kontribuar më shumë në fitimin e pasurisë së përbashkët apo vetëm në blerjen e një shtëpie, një parcele tokësore, apo një veturë, ka mundësi që të kundërshtoj ndarjen e pasurisë së përbashkët në gjysëm pra, në 1/2 për çdonjërin nga bashkëshortët. Por për të realizuar këtë pretendim të tij, ai ose ajo duhet të posedojnë prova me të cilat do të vërtetojnë pretendimin e tyre - se kontributi i tij / saj në fitimin e pronës së përbashkët është dukshëm dhe në mënyrë të konsiderueshme më i madh se i bashkëshortit tjetër.

Vlen të theksohet se gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët, me kërkesë të njërit bashkëshort, në pjesën e tij / saj së pari do të përfshihen ato sende nga pasuria e përbashkët, të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së tij / saj. Po ashtu përveç pjesës së tij /saj nga pasuria e përbashkët do të ndahen dhe do t'i jepen bashkëshortit edhe sendet, të cilat janë fituar me punë gjatë kohëzgjatjes së martesës, por, të cilat shërbejnë vetëm për përdorimin e tij personal.¹¹³

Nëse vlera e sendeve të lartpërmendura në mënyrë disproporcionale është më e lartë se e tërë vlera e pasurisë së përbashkët, sendet e tilla gjithashtu do të ndahen, vetëm nëse bashkëshorti që do duhej t'i marrë këto sende nuk i'ja kompenson vlerën përkatëse bashkëshortit tjetër, ose kur bashkëshortit tjetër me pëlqimin e vetë nuk i jep (lëshonë) sende të tjera.¹¹⁴

Duke mos haruar gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët rëndësi të veçantë u kushtohet edhe fëmijëve, pasi që bashkëshortit të cilit i është besuar kujdestaria

¹¹² Neni 75 i "Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore" – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

¹¹³ Ibid., Neni 76

¹¹⁴ Ibid., Neni 76

dhe edukimi i fëmijëve, përveç pjesës së tij /saj do t'i jepen në pronësi edhe sendet që u shërbejnë fëmijëve ose janë të rezervuara vetëm për përdorimin e tyre direkt. Po ashtu bashkëshortit që i është besuar kujdestaria dhe edukimi i fëmijëve, i jepen edhe ato objekte (sende) për të cilat është e qartë se është në interes që ato të jenë në pasurinë dhe pronësin e bashkëshortit të cilit i janë besuar fëmijët.¹¹⁵

Nëse gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët vërtetohet se njërit prej bashkëshortëve i takonë dukshëm një pjesë më e vogël, gjykata me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve mund të përcaktojë që ajo pjesë të kompensohet në para.¹¹⁶

4.3. Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve me personat e tretë

Për obligimet të cilat njëri prej bashkëshortëve i ka pasur në momentin e lidhjes së martesës, si dhe për obligimet personale që do t'i marrë gjatë kohëzgjatjes së martesës, nuk mund të thirret në përgjegjësi bashkëshorti tjetër. Bashkëshortët përgjigjen në mënyrë solidare për obligimet që njëri bashkëshort i ka marrë ndaj palës së tretë për përmbushjen e nevojave aktuale të bashkësisë martesore, si dhe obligimet të cilat sipas rregullave të përgjithshme i ngarkojnë të dy bashkëshortët. Bashkëshorti i cili e ka përmbushur obligimin solidar nga pasuria e tij e veçantë, ka të drejtë të kërkojë nga bashkëshorti tjetër që tja kompenzoj pjesën e detyrimit që bie mbi të.¹¹⁷

3.Kontratat pasurore të bashkëshortëve

Barazia ndërmjet bashkëshortëve reflektohet edhe në kuptim të lirisë së kontraktimit ndërmjet tyre. Ata në parim janë të lirë të lidhin të gjitha kontratat që lejon rendi juridik, ashtu si edhe të gjithë personat e tjerë fizik.¹¹⁸ Edhe përkundër faktit që në RMV proklamohet barazia ndërmjet bashkëshortëve si dhe parimi i autonomis së vullnetit apo thën më saktësisht vullneti i lirë i palëve, legjislacioni i RMV-së nuk e lejon lidhjen e kontratës martesore ndërmjet bashkëshortëve, edhe pse për lidhjen e martesës para ofiqarit të gjendjes civile kërkohet thuaj se të gjitha kushtet si për lidhjen e kontratës.

¹¹⁵ Neni 77 i “Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore” – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

¹¹⁶ Ibid., Neni 78

¹¹⁷ Ibid., Neni 79

¹¹⁸ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve III – 2017, fq.57

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë të rregulluara me norma imperative, prandaj bashkëshortët nuk mundën t'i ndryshojnë me anë të kontratës. Në LPDTS nuk ka dispozita të cilat rregullojnë çështjen e kontratave pasurore ndërmjet bashkëshortëve, por ato mund të lidhin të gjitha kontratat të cilat nuk janë në kundërshtim me dispozitat e përgjithshme të së drejtës civile, me natyrën juridike të institutit të martesës e veçanërisht me rregullat e regjimit pasuror ligjor.

Që nga momenti i lidhjes së martesës e deri në momentin e pushimit të saj bashkëshortët kanë të drejtë të lidhin një mori kontratash ndër të cilat: Kontrata për administrim dhe disponim – e cila mund të lidhet si për pasurin e përbashkët po ashtu edhe për pasurin e veçantë; Kontrata për shitblerjen; Kontrata për dhuratë; Kontrata e këmbimit; Kontratën për mbajten e përhjetshme; Kontrata për ndarjen e pronës së përbashkët; Kontratë për punë si dhe të gjitha kontrata tjera të cilat nuk janë në kundërshtim me natyrën e martesës dhe ligjin.

Njejtë si të gjitha kontratat edhe kontratat të cilat lidhen ndërmjet bashkëshortëve u nënshtrohen rregullave të së drejtës civile, respektivisht, të drejtës së detyrimeve, kontrata që lidhen ndërmjet bashkëshortëve njejtë si kontratat tjera duhet të lidhen në atë formë që kërkohet për lidhjen e asaj pune juridike përkatëse, po ashtu nëse vjen deri ndryshimi plotësimi ose pushimi i kontratës duhet të jetë në formën e cila kërkohet për llojin e punës juridike përkatëse.¹¹⁹

4.Marrëdhëniet juridiko-pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesorë

Marrëdhëniet juridike të bashkëshortëve jashtëmartesorë për herë të parë janë rregulluar me ligjin për familje të vitit 1992, ku në nenin 13 thuhet: bashkëshortët jashtëmartesorë barazohen me bashkëshortët martesorë për sa i përket të drejtës për mbajtje reciproke dhe pasurisë së fituar gjatë kohëzgjatjes së kësaj bashkësie¹²⁰. Mirëpo kjo barazi është e kufizuar me një kusht që bashkësia jashtëmartesore të ketë zgjatur më së paku 1 vitë. Vlen të ceket që edhe pas ndryshimeve që ndodhën në legjislacionet e RMV-së në vitin 2001, edhe LPDTS

¹¹⁹ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve III – 2017, fq.57

¹²⁰ Neni 13 i “Ligjit për familje” Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.80/1992

rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe rregullimit të marrëdhënieve juridiko-pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesore.

Sipas LPDTS – pasuria që bashkëshortët jashtëmartesorë do ta fitojnë gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë jashtëmartesore do të konsiderohet si pasuri e tyre e përbashkët. Ndërsa sa i përket administrimit dhe disponimit, identifikimit të pjesëve të pasurisë së fituar në bashkësinë jashtëmartesore si dhe gjatë ndarjes së pasurisë në bashkësinë jashtëmartesore, do të zbatohen apo vlejnë të njëjtat dispozitat ligjore me të cilat rregullohet pasuria e përbashkët e bashkëshortëve martesorë.¹²¹

Kapitulli-III

1.Rregullimi i marrëdhënieve juridiko-pasurore të bashkëshortëve në të drejtën evropiane

Çdo shtet ka legjislacionin e vet, ku në mënyrë të pavarur rregullon çdo degë të së drejtës, apo thënë më ndryshe çdo institut juridik përfshirë edhe ato të së drejtës familjare. Mirëpo me krijimin e Bashkimit Evropian u liberalizua qarkullimi i qytetarëve nga një shtet në shtetin tjetër, qarkullimi i mallrave u bë më i lirë, numri i bizneseve ndërkombëtare u rrit ndjeshëm, filloi lidhja e kontratave të ndryshme ndërmjet shtetasëve të huaj, po ashtu me qarkullimin e lirë të qytetarve filloj edhe lidhja e martesave ndërmjet personave me shtetësi të ndryshme, e në këto situata paraqitet problematike rregullimi i këtyre marrëdhënieve, për arsye se nuk dihet se cili legjislacion do të zbatohet. Këto situata ndikuan në paraqitjen e nevojës për përpilimit e një kodi civil evropian, qëllimi i të cilit është i njëjtë me atë të një kod civil nacional, që në mënyrë gjithëpërfshirëse të merret me fushat thelbësore të së drejtës private. E drejta private e përfshirë në një kod civil zakonisht përfshin: të drejtën familjare, të drejtën trashëgimore, të drejtën sendore, të drejtën tregtare dhe të drejtën detyrimore. Fushat kryesore që janë sugjeruar të rregullohen me kodin civil evropian janë: kontratat, pronësia, dëmshpërblimi dhe gjithashtu e drejta tregtare. Ndërsa për të drejtën familjare dhe të drejtën trashëgimore ekziston dyshimi nëse

¹²¹ Neni 81 i “Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore” – Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/2001

është e mundur përfshirja e tyre në një kod evropian gjithëpërfshirës, pasi ato janë të lidhura ngusht me kulturën e një kombi.¹²²

Edhe përkundër përpjekjeve për të nxjerrë një kod civil evropian, ai nuk u arrit të realizohet me sukses, edhe pse me kodin civil evropian do të arrihej evropianizimi i të gjitha shteteve dhe do të eleminoheshte kolizioni i ligjeve, po ashtu do lehtësohej rregullimi i martesave ndërmjet shtetasëve të huaj e shumë problematika tjera. Mirëpo është shumë e vështirë që të arrihet deri te unifikimi i të drejtës në përgjithësi, ndërsa ende më i vështirë është unifikimi i ligjeve të së drejtës familjare, pasi çdo shtet ka kulturën dhe traditën e vetë dhe nuk është e lehtë të pranohet një gjë e tillë, dhe kjo e vështirson vendosjen e një sistem unik të vlerave dhe traditave. Kjo na shpije në përfundim se çdo shtet në mënyrë të ndryshme bënë rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve ku disa parashohin vetëm regjim ligjor e disa edhe regjimet e kontraktuara (subsidijare).

Rregullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve është më specifik për shkak të lidhjes së veçantë e cila egzistonë ndërmjet bashkëshortëve. Në të gjitha shtetet evropiane egziston regjimi pasuror ligjor me të cilin rregullohen marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve me anë të normave imperative ligjore, ndërsa në legjislacionet e shteteve evropiane bashkëkohore gjithnjë e më shumë i kushtohet rëndësi kontratës martesore, me ndihmën e së cilës bashkëshortët në mënyrë të pavarur sipas vullnetit të tyre të përbashkët i rregullojnë marrëdhëniet pasurore ndërmjet vete. Kjo mundësi është si rezultat i liberalizimit të sistemit juridik familjar ku gjithnjë e më shumë i jepet rëndësi vullnetit të lirë të palëve të cilët lidhin martesë.¹²³

„Në shumë shtete evropiane parashihet edhe regjimi i veçantë për banesën e përbashkët martesore, e cila gëzon mbrojtje të veçantë juridike që të përmbushen nevojat e anëtarëve të familjes, a në radhë të parë nevojat dhe intereset e veçanta të fëmijëve. Për shkak të kësaj, për banesën martesore nuk zbatohen normat e përgjithshme për pronësin të cilat zbatohen për sendet e tjera të luajtshme dhe pasuritë e paluajtshme.”¹²⁴

¹²² European civil code – Wikipedia https://en.wikipedia.org/wiki/European_civil_code (parë me 10.02.2020)

¹²³ Lilana Spiroviq Trpenovska, Dejan Mickoviq, Angel Ristov: “Semejno Pravo” – Shkup, 2013, fq.315

¹²⁴ Dejan Mickoviq, Angel Ristov: Semejno parvo – Skopje 2015, fq.330

Regjimet pasurore ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore në martesë nuk janë identike, në të gjitha shtetet evropiane, por në mes tyre egzistojnë dallime të mëdha të cilat vinë si rezultat i specifikave historike, juridike, ekonomike, politike, kulturore dhe kushteve tjera karakteristike për vendin e caktuar.¹²⁵ Regjimi pasuror ligjor mund të parashifet në disa lloje varësisht nga shteti i konkret, mirëpo më të pranishme janë këto regjime:

1. Regjim i pasurisë së përbashkët – është regjim dominant në të sistemet juridiko-familjare bashkëkohore, ky regjim thuaj se është i pranishëm në të gjitha shtetet e ish-jugosllavisë, shtetet e Evropës lindore dhe qendrore si: Bullgaria, Çekia, Rusia, Hungaria, Slovakia, po ashtu edhe në disa shtete të Evropës perendimore si: Franca, Italia, etj.
2. Regjimi i prolonguar i pasurisë së përbashkët – është i pranishëm në shtetet skandinave, po ashtu në Gjermani, Hollandë, etj...
3. Regjimi i pasurisë së veçantë – si regjim është karakteristik në shtetet e të drejtës anglosaksone, si dhe në ndonjë shtetet të së drejtës kontinentale si: Austria.

2. Aspektet krahasuese të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në sistemet juridike bashkëkohore

Në të drejtën komparative bashkëkohore egzistojnë disa modele të regjimeve pasurore të bashkëshortëve, të cilat do të vështrohen nëpërmjet dispozitave të kodeve civile më të rëndësishme evropiane.¹²⁶ Në grupin e kodeve më të rëndësishme të shekullit 19 dhe fillimit të shekullit 20, hynë Kodi civil Frances, Kodi civil Gjerman, Kodi i përgjithshëm civil Austriak, Kodi civil Zvicran, këto kode kanë qenë kryesisht nën ndikimin e të drejtës romake dhe të drejtës kanonike, vetëm disa prej tyre pjesërisht kanë gjetur mbështetje në të drejtën zakonore.¹²⁷

Edhe përkundër dallimeve që i kanë pasur në sistemet juridike këto shtete disa çështje siç janë edhe marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve i kanë trajtuar në të njëjtën mënyrë, pasi që si burim kanë pasur të njëjtat rregulla, pra ato të drejtës romake dhe të drejtës kanonike – fetare. Duke pasur parasysh sistemet juridike të cilat këto shtete i kanë marrë si mostër apo model gjatë përpilimit të legjisllacioneve

¹²⁵ Po aty, fq.330

¹²⁶ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve I – 2017, fq.49

¹²⁷ Po aty, fq.51

të tyre, që në fillim janë shfaqur disa pengesa apo thënë më ndryshe mangësi, siç është mos respektimi i barazisë gjinore, pastaj mos respektimi i vullnetit të lirë të palëve sa i përketë martesës, ndalesa e shkurorizimit e shumë të tjera.

Mirëpo në dekadat e fundit të gjitha shtetet e Evropës gjithnjë e më shumë i kanë kushtuar rëndësi ndryshimeve në sferën e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, ku të gjitha shtetet kanë inkorporuar në legjislacionet e tyre principin e barazisë në mes burrit dhe gruas si një ndryshim themelor, po ashtu kanë paraparë normë me të cilën si kontribut në fitimin e pasurisë të llogaritet edhe kryerja e punëve të shtëpiake, si dhe ruajtja dhe edukimi i fëmijëve, dhe një ndër ndryshimet më të rëndësishme është njohja e parimit të autonomis së vullnetit pra mundësia që bashkëshortët marrëdhëniet e tyre pasurore ti regullojnë sipas vullnetit të lirë të tyre me anë të kontratës.¹²⁸

2.1. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik Gjerman

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në të drejtën Gjermane rregullohen me Kodin Civil Gjerman (KCGJ)¹²⁹ i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1900. Dispozitat të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve janë të përfshira në sferën e dispozitave të së drejtës familjare, të cilat në KCGJ janë të vendosura në *librin e katërt* i emëruar si Ligji për Familjen i cili përmban 624 nene, prej të cilave 200¹³⁰ nene janë përkushtuar rregullimi të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, ku nga ky fakt mund të nxjerrim përfundim se marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve ju është kushtuar një rëndësi e veçantë duke i trajtuar në mënyrë kaq të hollësishme.

Kodi civil Gjerman gjatë rregullimit të marrëdhënieve juridiko pasurore të bashkëshortëve ka pranuar parimin e vullnetit të lirë të palëve (autonomis së vullnetit) dhe në këtë mënyrë j'u ka mundësuar bashkëshortëve që me anë të kontratës t'i shmangen regjimit ligjor duke u përcaktuar për ndonjë regjim tjetër subsidiar, pra si në të gjitha sistemet juridike bashkëkohore edhe në sistemin juridik

¹²⁸ Lilana Spiroviq Trpenovska, Dejan Micković, Angel Ristov: "Semejno Pravo" – Shkup, 2013, fq.316

¹²⁹ German Civil Code (BGB) – 01.01.1900 https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/index.html#gl_p4886 parë me 10.01.2020

¹³⁰ German Civil Code (BGB) – 01.01.1900 - Titulli 6: Regjimi i pasurive martesore, Nenet 1363 deri në nenin 1563.

gjerman kemi regjimin ligjor dhe regjimin e kontraktuar (subsidiar). KCGJ me dispozita juridike rregullon tri regjime pasurore:

2.1.1. Regjimi i bashkësisë së vlerës së shtuar (ose siç njihet ndryshe edhe si regjim i prolonguar i pasurisë së përbashkët) – regjim ligjor

Regjimi ligjor i bashkësisë së vlerës së shtuar zbatohet vetëm në situatat kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë me të cilën i rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore ndryshe nga ajo që parasheh regjimi ligjor ose në mënyrë vullnetare kanë zgjedhur këtë regjim. Ky regjim është mjaft karakteristik pasi që për aq kohë sa zgjatë martesë nuk mund të vërehet natyra e vërtetë e tij pasi ai funksionon si regjim i pasurisë së ndarë.

Pasurinë të cilën bashkëshortët e kanë pasur në momentin e lidhjes së martesës ngelet pasuri e veçantë e tyre, po ashtu edhe pasuria të cilën do ta fitojnë gjatë kohëzgjatjes së martesës do të udhëhiqet si pasuri e veçantë e tyre që domethënë ata pavarësisht nga njëri tjetri të vetëm administrojnë dhe disponojnë me pasurinë e tyre të krijuar gjatë bashkësisë martesore. Mirëpo ky disponimi i tyre ka edhe kufizime kur bëhet fjalë për disponimin e pasurisë në tërësi ose disponimi me sendet e amvisërisë që i shfrytëzojnë bashkërisht, ky kufizim del nga nenin 1365 të KCGJ ku thuhet: (1) Bashkëshorti mund vetëm me pëlqimin e bashkëshortit tjetër të pranojë (pajtohet) që të disponojë me pasurin e tij në tërësi. Kur ai është pajtuar pa miratimin (pëlqimin) e bashkëshortit tjetër, ai mund të kryejë atë detyrë vetëm nëse bashkëshorti tjetër do pajtohet. (2) Kur veprimi (transaksioni) përputhet me parimet e administrimit të duhur, gjykata familjare, me kërkesën e bashkëshortit, mund të zëvendësojë aprovimin e bashkëshortit tjetër nëse kjo e fundit nuk pranon atë pa shkaqe adekuate ose është parandaluar nga sëmundja ose mospasja e mundësisë për të dhënë një deklaratë dhe rrezikun që sjell shtyerja.¹³¹

Efekti i vërtetë i këtij regjimi shfaqet në momentin e pushimit të martesës, ku pasuria e krijuar apo vlera e shtuar që nga momenti i lidhjes së martesës e deri në pushimin e saj do të mbledhet e pastaj do të ndahet ndërmjet bashkëshortëve, apo thënë më sakt bashkëshorti pasuria e të cilit është rritur gjatë kohëzgjatjes së martesës, ka për obligim që gjysmën e vlerës së shtuar t'ia jep bashkëshortit tjetër. Që të zbatohet kjo procedurë është e nevojshme që të realizohet regjistrimi dhe

¹³¹ Neni 1365 i Kodit Civil Gjerman - 1900

vlërësimi i gjendjes pasurore të secilit nga bashkëshortët në fillimin të martesës dhe në fund të martesës.

Çdonjëri prej bashkëshortëve gëzon të drejtën e kërkesës për barazim – ku në neni 1378 të KCGJ thuhet se: Nëse fitimet e vlerësuara të njërit bashkëshort tejkalojnë fitimet e përlogaritur të bashkëshortit tjetër, gjysma e tepricës i takon bashkëshortit tjetër si kërkesë për barazim. Kërkesa për barazim lind me përfundimin e regjimit të pasurisë dhe nga kjo datë e tutje është e trashëgueshme dhe e transferueshme. Ky regjim është i favorshëm për bashkëshortin i cili nuk mund të realizoj të ardhura të majme krahasuar me bashkëshortin tjetër.¹³²

2.1.2. Regjimi i pasurisë së ndarë – regjim kontraktor (subsidiar)

Regjimi i pasurisë së ndarë mund të zbatohet vetëm në situat kur bashkëshortët me kontratë kanë përzgjedhur këtë regjim subsidiar. Sipas të drejtës gjermane, regjimi i pronësisë së ndarë, përjashtimisht mund të krijohet edhe në bazë të ligjit, kjo ndodh në rastet kur regjimi ligjor i bashkësisë së vlerës së shtuar ndërmjet bashkëshortëve me vendim të plotëfuqishëm anulohet para kohe, atëherë zbatohet regjimi i pasurisë së ndarë pasi njihet si regjim ligjor subsidiar¹³³. Sipas këtij regjimi bashkëshortët edhe pas lidhjes së martesës vazhdojnë të kenë pasurinë e tyre të ndarë, pra çdonjëri vetë administron dhe disponon me pasurinë e tij. Për të realizuar bashkësinë e tyre dhe për të plotësuar nevojat jetësore të veta dhe të fëmijëve të tyre bashkëshortët me mjete të përbashkëta krijojnë banesën e përbashkët (mbi të cilën krijohen raporte të bashkëpronësisë) dhe ndërmarin të gjitha masat për ngritjen dhe udhëheqjen e amvisërisë së përbashkët.¹³⁴ Ky regjim përfundon në rast se bashkëshortët me kontratë përcaktohen që në të ardhmen të zbatohet një regjim tjetër pasuror ose kur pushon martesa pushon edhe regjimi i pasurisë së ndarë.

2.1.3. Regjimi i pronësisë së përbashkët – regjim kontraktor (subsidiar)

Regjimi i pronësisë së përbashkët do të zbatohet vetëm atëherë kur të dy bashkëshortët me kontratë janë përcaktuar për këtë regjim pasurorë.¹³⁵ Sipas këtij regjimi bashkëshortët që nga momenti i lidhjes së martesës bashkojnë pasurinë e

¹³² Ibid., Neni 1678

¹³³ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.21

¹³⁴ Po aty, fq.21

¹³⁵ Neni 1415 i Kodit Civil Gjerman - 1900

tyre që kanë pasur dhe krijojnë pasurinë e tyre të përbashkët të cilën e administrojnë të dytë së bashku ose me marrëveshje i besohet njërit prej tyre.

Në pronën e përbashkët të bashkëshortëve hynë: a) pasuria e burrit dhe pasuria e gruas të cilën e kanë pasur në momentin e lidhjes së martesës pavarësisht asaj a bëhet fjalë për sende të luajtshme apo të paluajtshme, e që si rezultat i bashkimit të pasurisë, ajo shëndrohet në pasuri e përbashkët e të dy bashkëshortëve (pasuri martesore), b) pasuria e përbashkët e bashkëshortëve përfshinë gjithashtu edhe pasurinë që burri ose gruaja do e fitojnë gjatë periudhës sa zgjat bashkësia e pasurisë; c) sendet individuale bëhen pronë e përbashkët, nuk është e nevojshme transferimi i tyre me transaksione ligjore.¹³⁶ Po ashtu nëse një e drejtë që është regjistruar në regjistrin e tokës ose mund të regjistrohet në regjistrin e tokës bëhet pasuri martesore, secili bashkëshort mund të kërkojë nga bashkëshorti tjetër të bashkëpunojnë në korrigjimin e regjistrit të tokës, dispozita të ngjashme zbatohen nëse një e drejtë që është regjistruar në regjistrin e anijeve.¹³⁷

Në kontratën e martesore në të cilën ata bien dakord për bashkësinë e pasurisë (pronësinë e përbashkët), bashkëshortët duhet të specifikojnë nëse pasuria martesore do menaxhohet nga burri ose nga gruaja ose nga të dy bashkërisht. Nëse kontrata martesore nuk përmban ndonjë dispozitë për këtë, bashkëshortët menaxhojnë bashkërisht pasurinë martesore.¹³⁸ Bashkëshorti që administron pasurinë martesore mund të pajtohet që të disponojë me pasurinë martesore në tërësi vetëm me pëlqimin e bashkëshortit tjetër, kur ai është pajtuar pa miratimin e bashkëshortit tjetër, ai mund të kryejë detyrën vetëm nëse bashkëshorti tjetër pajtohet¹³⁹.

Bashkëshorti që administron pasurinë martesore mund të pajtohet vetëm me pëlqimin (miratimin) e bashkëshortit tjetër, për të disponuar një paluajtshmëri që është pjesë e pasurisë martesore; përveç kësaj, ai mund të pajtohet me një gjendje të tillë vetëm me pëlqimin e bashkëshortes së tij. E njëjta gjë vlen nëse një anije e regjistruar ose anije në ndërtim e sipër është pjesë e pasurisë martesore.¹⁴⁰ Kur një veprim juridik (shitblerje) që duhet të ndërmeret vetëm me pëlqimin e

¹³⁶ Ibid., Neni 1416

¹³⁷ Neni 1416 i Kodit Civil Gjerman - 1900

¹³⁸ Ibid., Neni 1421

¹³⁹ Ibid., Neni 1423

¹⁴⁰ Ibid., Neni 1424

bashkëshortit tjetër, është i domosdoshëm për administrimin e duhur të pasurisë martesore, gjykata familjare, me kërkesë të bashkëshortit që administron me pasurinë, mund të zëvendësojë miratimin e bashkëshortit tjetër nëse kjo e fundit e refuzon atë pa ndonjë shkak adekuat (të arsyshëm) ose parandalohet nga sëmundja ose mungesa e bërjes së një deklarate dhe vonesa sjell rrezik.¹⁴¹

Në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve nuk përfshihen vetëm:

1. *Pasuria e veçantë (sondergut)* - pasuria e veçantë përjashtohet nga pasuria martesore, si pasuri e veçantë llogariten sendet që nuk mund të barten me anë të punëve juridike. Secili bashkëshort administron në mënyrë të pavarur pasurinë e tij të veçantë, ai e menaxhon atë për llogari të pasurisë martesore;¹⁴² dhe

2. *Pasuria e rezervuar* - pasuria e rezervuar për njërin bashkëshort është e përjashtuar nga pasuria martesore. Si pasuri e rezervuar konsiderohen:

- a) Sendet që me kontratë martesore janë deklaruar si pasuri e rezervuar e njërit bashkëshort;
- b) Pasuria që bashkëshorti e fiton si pasojë e vdekjes testamentlënësit ose që i është dhuruar atij nga një person i tretë, me kusht që testatori ta ketë specifikuar në dispozitat e testamentit ose dhuratëdhënësi në dispozitën e kontratës për dhuratë, që ajo pasuri e fituar të llogaritet si pasuri e rezervuar;
- c) Pasuria që bashkëshorti e fiton mbi bazën e një të drejte që është pjesë e pasurisë së tij të rezervuar ose si kompensim për shkatërrimin, dëmtimin ose heqjen e një sendi që është pjesë e pasurisë së rezervuar ose nga një punë juridike që ka të bëjë me pasurinë e rezervuar.¹⁴³

Secili bashkëshort administron në mënyrë të pavarur pasurinë e tij të rezervuar, ai/ajo e menaxhon atë për llogari të vet.

Edhe në të drejtën gjermane egzistojnë rregulla të posaçme për **banesën familjare** (martesore), në rastë shkurorëzimit të martesës, bashkëshortët mund bashkërisht dhe me marrëveshje të vendosin se kujt do t'i takojë banesa familjare, mirëpo në situatat kur ato nuk mund të merren vesh, atëherë me kërkesë të tyre do të vendos gjykata e cila është kompetente për marrëdhëniet familjare, në përputhje

¹⁴¹ Ibid., Neni 1426

¹⁴² Ibid., Neni 1417

¹⁴³ Neni 1418 i Kodit Civil Gjerman - 1900

me rregullat e përcaktuara në Ligjin Hausratsverordnung¹⁴⁴ i cili nuk është i inkorporuar në KCGJ.¹⁴⁵ Gjykata gjatë sjelljes së vendimit se cilit do ti takoj banesa familjare, nuk udhëhiqet gjithmonë nga marrëdhëniet pronësore, por e merr parasyshë principin e drejtëshmërisë.¹⁴⁶

2.2. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik Francez

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në të drejtën Franceze rregullohen me Kodin Civil Francez (KCF)¹⁴⁷ i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1804, i cili me disa ndryshime dhe plotësime të kohëpaskohshme mbetet kodi më i vjetër në botë, që sot e kësaj dite ende zbatohet. Dispozitat të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve nuk janë të përfshira në sferën e dispozitave të cilat rregullojnë të drejtën familjare, por ato janë të vendosura në *librin e tretë* i emëruar si “Mënyrat e ndryshme se si fitohet pronësia” i cili përmban 1572 nene, prej të cilave 194 nene të cilat ndodhen në titullin 5 të emëruar si “Marrëveshjet Martesore (ANTE-NUPTIAL) dhe regjimet martesore”¹⁴⁸ janë të përkushtuara rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, ku nga ky fakt mund të nxjerrim përfundim se marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve ju është kushtuar një rëndësi e veçantë duke i trajtuar në mënyrë kaq të hollësishme.

Reformat në marrëdhëniet juridiko-pasurore të bashkëshortëve në të drejtën franceze u realizuan në bazë dispozitave të ligjit për reformimin e regjimit pasuror bashkëshortor, të datës 13 korik të vitit 1965, këto reforma u mbështetën në idenë e solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve.¹⁴⁹ Po ashtu Kodi civil Francez gjatë rregullimit të marrëdhënieve juridiko pasurore të bashkëshortëve ka pranuar parimin e lirisë së kontraktimit ndërmjet bashkëshortëve dhe në këtë mënyrë j'u ka mundësuar bashkëshortëve që me anë të kontratës ti shmangen regjimit ligjor duke u përcaktuar për ndonjë regjim tjetër subsidiar ose ta modifikojnë regjimin ligjor deri sa nuk bie ndesh me ligjin, pra si në të gjitha sistemet juridike bashkëkohore edhe në sistemin

¹⁴⁴ Ligji Hausratsverordnung - https://www.sadaba.de/GSBT_HausratsVO.html

¹⁴⁵ Dejan Micković, Angel Ristov: Semejno parvo – Skopje 2015, fq.332

¹⁴⁶ Po aty, fq.332

¹⁴⁷ French Civil Code - 21.03.1804

https://www.legifrance.gouv.fr/content/download/1950/13681/version/3/file/Code_22.pdf

¹⁴⁸ French Civil Code - 21.03.1804, prej nenit 1387 deri në nenin 1581

¹⁴⁹ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.1-2

juridik francez kemi regjimin ligjor dhe regjimin e kontraktuar (subsidiar). KCF me dispozita juridike rregullon 4 regjime pasurore:

2.2.1. Bashkësia e pasurisë së krijuar - regjimi pasuror ligjor

Regjimi ligjor i bashkësisë së pasurisë së krijuar zbatohet vetëm në situatat kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë me të cilën i rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore ndryshe nga ajo që parasheh regjimi ligjor duke zgjedhur një prej regjimeve tjera të parashikuara me kodin civil francez ose në mënyrë vullnetare kanë zgjedhur këtë regjim¹⁵⁰. Regjimin e bashkësisë së pasurisë së krijuar të bashkëshortëve e përbëjnë të mirat të cilat i kanë fituara bashkëshortët bashkërisht si dhe të mirat e fituar në mënyrë të veçantë nga secili prej bashkëshortëve gjatë kohëzgjatjes së martesës si dhe të mirat që vijnë si nga veprimtaria e tyre personale, ashtu edhe nga kursimet e bëra nga frutat dhe të ardhurat e pasurisë së tyre personale.¹⁵¹

Sipas regjimit ligjor të bashkësisë së pasurisë së krijuar, në çdo martesë egzistojnë tri masa pasurore: a) Pasuria e veçantë e gruas, b) Pasuria e veçantë e burrit, dhe c) Bashkësia e pasurisë së krijuar.¹⁵²

2.2.1.1. Pasuria e veçantë e gruas dhe burrit

Pasuri e veçantë e bashkëshortëve konsiderohet: ajo pasuri që bashkëshortët e kishin në pronësi ose posedim ditën e lidhjes së martesës ose të cilën ata e fitojnë gjatë martesës përmes trashëgimisë, dhuratës ose legut, mirëpo nga dhuratëdhënësi ose trashëgimlënësi varet se kjo pasuri a do të hyjë në pasurinë e veçantë apo të përbashkët pasi ato mund të përcaktojnë që ajo pasuri a do t'i takojë bashkësisë apo do ti dedikohet vetëm njërit nga bashkëshortët.¹⁵³

Në pasurinë e veçantë gjithashtu hynë: rrobat dhe sende për përdorimin personal të njërit bashkëshort, kërkesat për kompensimin e dëmit trupor ose moral, kërkesat e patjetërsueshme (detyrushme) dhe pensionet, në përgjithësi, të gjitha pasuritë që kanë karakter personal dhe të gjitha të drejtat e bashkangjitura ekskluzivisht për personin pavarësisht asaj se a janë fituar para apo gjatë

¹⁵⁰ Neni 1393 – Kodi Civil Francez 1804

¹⁵¹ Neni 1401 - Kodi Civil Francez 1804

¹⁵² Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.4

¹⁵³ Neni 1405 – Kodi civil Francez

martësës.¹⁵⁴ Po ashtu, pasuri e veçantë llogaritet edhe pasuria që i është dorëzuar ose transferuar njërit prej bashkëshortëve nga babai ose nëna, me kusht që ai të përmbushu atë që i detyrohet atyre, ose nën detyrimin e pagimit të borxheve të dhuruesit ndaj të huajve, ajo mbeten pasuri e veçantë si subjekt për rimbursim.¹⁵⁵

Sendet që njërit bashkëshortë i shërbejnë për ushtrimin e veprimtaris profesionale, gjithashtu bëjnë pjesë në pasurin e veçant të bashkëshortit i cili ushtronë veprimtari profesionale. Këto do të llogariten si pasuri e veçantë vetëm nëse vlera e tyre nuk është shumë e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së krijuar, e nëse vlera e këtyre sendeve është në disproporcion të madhë me pasurin e krijuar atëher kjo vlerë do të llogaritet si pasuri e përbashkët.¹⁵⁶

Bashkëshortët janë pronarë absolut të sendeve të cilat bëjnë pjesë në pasurinë e veçantë të tyre, dhe atë gëzojnë të drejtën që në mënyrë të pavarur të administrojnë dhe disponojnë me pasurin e vetë pa pasur nevojë për pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Bashkëshortët mund të lidhin marrëveshje në mes tyre që njëri prej tyre të administroj edhe me pasurin e veçantë të bashkëshortit tjetër. Gjatë bashkësis martesore ato kanë të drejtë vetëm për frutat e mbledhura dhe jo të konsumuara nga pasuria e veçant. Në qoftë se bashkëshorti nuk ka arritur t'i mbledhë frutat ose i ka konsumuar me mashtrime, ai mund të obligohet të kompenzoj frutat në momentin e shpërbërjes së bashkësisë, megjithatë, çdo hetim është i pranushëm për pesë vitet e fundit.¹⁵⁷

2.2.1.2. Pasuria e krijuar

Pasuria e krijuar përbëhet nga të gjitha fitimet e realizuara gjatë kohëzgjatjes së martësës qoftë nga të dy bashkëshortët së bashku ose veçmas, dhe mund të jenë si nga veprimtaria e tyre personale, ashtu edhe nga kursimet e bëra nga frutat dhe të ardhurat e pasurisë së tyre personale.¹⁵⁸ Çdo pronë, qoftë e luajtshme ose e paluajtshme, do të konsiderohet si pasuri e krijuar derisa nuk vërtetohet se është pronë e veçantë e njërit prej bashkëshortëve, në përputhje me dispozitat e ligjit.¹⁵⁹

¹⁵⁴ Ibid., Neni 1404

¹⁵⁵ Ibid., neni 1405

¹⁵⁶ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.4

¹⁵⁷ Neni 1403 – Kodi Civil Francez 1804

¹⁵⁸ Ibid., Neni 1401

¹⁵⁹ Ibid., Neni 1402

Po ashtu si pasuri e krijuar do të konsiderohet edhe pasuria e cila me testament u është lënë në emër të të dyve bashkëshortëve si trashëgimi e përbashkët.

Në këtë regjim bashkëshortët administrojnë dhe disponojnë vetë me pasurinë e krijuar, pra çdonjëri prej tyre ka fuqinë të administrojë vetëm pasurinë e përbashkët dhe ta disponojë atë, përveç që përgjigjet për gabimet që do të kishte bërë gjat menaxhimit të tij.¹⁶⁰ Veprimet e kryra pa mashtim nga një bashkëshort janë të zbatueshëm ndaj tjetrit. Një bashkëshort, i cili ka një profesion të veçantë ka fuqinë të kryejë aktet e administrimit dhe disponimin e domosdoshëm në atë profesion.¹⁶¹ Pëlqimi i bashkëshortit tjetër kërkohet vetëm në rastet e lidhjes së punëve juridike që kanë të bëjnë me shfrytëzimin dhe disponimin e paluajtshmërive, pra kur bëhet fjalë për çështje që kanë rëndësi të madhe ekonomike.¹⁶²

Bashkëshortëve u lejohet që me marrëveshje të vendosin vetëm njëri prej bashkëshortëve të administrojë dhe disponojë me pasurinë e krijuar, pra në këtë mënyrë njërit bashkëshortë i jepet autorizim.¹⁶³

2.2.2. Bashkësia e të mirave pasurore – Regjim kontraktor (subsidiar)

Regjimi i bashkësisë së të mirave pasurore do të zbatohet vetëm atëher kur të dy bashkëshortët me kontratë janë përcaktuar për këtë regjim pasuror. Ky regjim mund të kontraktohet në dy mënyra si:

a) Regjimi i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe pasurisë së krijuar – regjimi kontraktor (subsidiar)

Bashkëshortët këtë regjim mund ta zgjedhin vetëm me kontratë, në situatat kur bashkëshortët përcaktohen për bashkësinë e sendeve të luajtshme dhe pasurisë së krijuar. Bashkësia e sendeve të luajtshme dhe pasurisë së krijuar përbëhet nga:

a) bashkësia e sendeve të luajtshme të cilët bashkëshortët i kanë pasur në pronësi ose i kanë poseduar në momentin e lidhjes së martesës, si dhe ato sende të cilat do t'i fitojnë gjatë martesës me anë të suksedimit ose dhuratës; b) të gjitha sendet e luajtshme që fitohen gjatë kohëzgjatjes së martesës me anë të punëve juridike pa shpërblim (dhurata, testamenti, legu); c) pasurinë të cilën do ta fitojnë gjatë

¹⁶⁰ Ibid., Neni 1421

¹⁶¹ Ibid., Neni 1421

¹⁶² Neni 1422 – Kodi Civil Francez 1804

¹⁶³ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.5

kohëzgjatjes së martesës dhe të gjitha frutat, të ardhurat, kamatat nga sendet e fituara gjatë martesës¹⁶⁴.

Kur njëri nga bashkëshortët fiton një paluajtshmëri pas lidhjes së kontratës martesore (ante-nuptial), dhe para ceremonis së martesës, ajo paluajtshmëri e fituar gjatë këtij intervali hyn në bashkësi, përveç nëse blerja ishte bërë në ekzekutim të ndonjë klauzole të kontratës martesore, në këtë rast ajo rregullohet sipas marrëveshjes.¹⁶⁵

Bashkëshortët mund të bien dakord që ata të administrojnë bashkërisht me pasurinë e tyre të përbashkët, në atë rast veprimet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë së bashkësis duhet të bëhen me nënshkrimin e përbashkët të të dy bashkëshortëve, dhe ato përfshijnë si të drejta të përbashkëta dhe disa përgjegjësi të bashkëshortëve.¹⁶⁶

b) Bashkësi univerzale pasurore - regjim kontraktor (subsidiar);

Edhe ky regjim do të zbatohet vetëm atëher kur bashkëshortët me kontratë do të përcaktohen për këtë regjim. Në bashkësinë univerzale përfshihen të gjitha sendet e luajtshme dhe të paluajtshme pavarësisht asaj se a janë të fituara para martesës apo gjatë martesës. Nga pasuria e përbashkët veçohen vetëm sendet për përdorim personal (neni 1404), të cilat ngelin në pasurinë e veçantë të bashkëshortëve. Bashkësia universale mbart përfundimisht të gjitha borxhet e bashkëshortëve, egzistuese apo të ardhmshme.¹⁶⁷ Me pasurinë e përbashkët administrojnë dhe disponojnë me marrëveshje bashkëshortët.

2.2.3. Regjimi i pasurisë së ndarë – regjim kontraktor (subsidiar)

Regjim i pasurisë së ndarë mund të zbatohet vetëm në situat kur bashkëshortët me kontratë kanë përzgjedhur këtë regjim subsidiar. Sipas këtij regjimi bashkëshortët edhe pas lidhjes së martesës vazhdojnë të kenë pasurinë e tyre të ndarë, pra çdonjëri vetë administron dhe disponon me pasurinë e tij, dhe secili përgjigjet vetëm për borxhet që lindin në vetvete, para ose gjatë martesës.¹⁶⁸

¹⁶⁴ Po aty, fq.7

¹⁶⁵ Neni 1498 – Kodi Civil Francez 1804

¹⁶⁶ Neni 1503 – Kodi Civil Francez 1804

¹⁶⁷ Ibid., Neni 1526

¹⁶⁸ Ibid., Neni 1536

Po ashtu bashkëshortët do të kontribuojnë në shpenzimet e martesës në përputhje me kushtet e marrëveshjes së tyre, a në qoftë se nuk ekziston një marrëveshje e tillë në këtë drejtim, atëherë zbatohet neni 214 ku thuhet: “Kur një marrëveshje martesore (para-nuptive) nuk rregullon kontributet e bashkëshortëve në shpenzimet e martesës, ata do të kontribuojnë në to në proporcion me mjetet e tyre përkatëse. Kur njëri prej bashkëshortëve nuk i përmbush detyrimet e tij / saj, ai ose ajo mund të detyrohen nga tjetri që këtë ta realizojnë në mënyrën e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile”.

Bashkëshorti që administron dhe disponon me sendin, me të gjitha mjetet mund të provojë se ai është pronarë ekskluziv i ndonjë sendi, nëse ai nuk arrin të provojë këtë fakt, do të konsiderohet se sendi u takon të dyve përgjysëm.¹⁶⁹ Gjatë kohëzgjatjes së martesës bashkëshortët kanë mundësi që administrimin dhe disponimin me pasurinë e tyre tja besojnë bashkëshortit tjetër, e në këtë rast zbatohen rregullat për kryerjen e punëve juridike me autorizim, bashkëshorti të cilit i jështë dhënë autorizimi për të administruar dhe disponuar me pasurinë e veçantë të bashkëshortit tjetër përgjigjet para tij për pakujdesitë eventuale gjatë administrimit të pasurisë.¹⁷⁰

2.2.4. Regjimi i vlerës së shtuar – regjim kontraktor (subsidiar)

Ky regjim do të zbatohet vetëm nëse bashkëshortët përcaktohen për këtë regjim i cili është marrë nga sistemi gjerman edhe është identik me regjimin ligjor gjerman. Ky regjim për aq kohë sa zgjat martesa funksion si regjim i pasurisë së ndarë të bashkëshortëve, ku secili ka pasurinë e tij të veçantë me të cilën administron dhe disponon vetë në mënyrë të pavarur. Mirëpo efekti i vërtetë i këtij regjimi shfaqet në momentin e pushimit të martesës, ku pasuria e krijuar apo vlera e shtuar që nga momenti i lidhjes së martesës e deri në pushimin e saj do të mbledhet e pastaj do të ndahet ndërmjet bashkëshortëve, apo thënë më saktë bashkëshorti pasuria e të cilit është rritur gjatë kohëzgjatjes së martesës, ka për obligim që gjysmën e vlerës së shtuar t’ia jep bashkëshortit tjetër. E drejta për të marrë pjesë në fitime nuk mund të transferohet derisa të shpërndahet regjimi martesorë. Nëse

¹⁶⁹ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.8

¹⁷⁰ Neni 1539 / 1540 – Kodi Civil Francez 1804

shpërbërja ndodh me vdekjen e një bashkëshorti, trashëgimtarët e tij, në fitimet neto të bëra nga tjetri, kanë të njëjtat të drejta si paraardhësi i tyre.¹⁷¹

Për banesën familjare në Francë janë paraparë rregulla të posaçme juridike, këto rregulla janë të karakterit imperativ të cilat bashkëshortët nuk mund ti ndryshojnë me kontratë, por janë të obliguar ti zbatojnë pa marrë parasysh regjimin pasuror i cili zbatohet. Ligjdhënësi kërkon që bashkëshortët të kenë banesë të përbashkët, e cila konsiderohet si ponësi e përbashkët e bashkëshortëve dhe me të ata mund të administrojnë dhe të disponojnë vetëm bashkërisht dhe me marrëveshje.¹⁷² Pra asnjëri nga bashkëshortët nuk mundet që pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër të disponojë me banesën e përbashkët, pa marrë parasysh se a paraqet pasuri të përbashkët apo pasuri të veçantë.

“Me sjelljen e ligjit prej vitit 2004 ligjdhënësi francez, vendosi rregulla të veçanta për mbrojtje juridike të banesës në rast të shkurorëzimit të martesës. Pas shkurorëzimit të martesës, banesa familjare i takon bashkëshortit i cili ka qenë pronar i shtëpisë ose banesës, mirëpo gjykata mund me vendimin e vetë të themelojë të drejtën e qirasë në të mirë të bashkëshortit tjetër të cilit i janë dhënë fëmijët në kujdestari ose kujdestarinë e realizojnë bashkërisht për njërin apo për më shumë fëmijë, derisa ajo është në interes të fëmijëve.”¹⁷³ E drejta e qirasë do të vlejë për aq kohë sa ky bashkëshort nuk lidh martesë, ose nuk hynë në bashkësi jashtëmartesore.

Ndërsa kur banesa familjare hynë në pasurinë e përbashkët, atëherë gjykata mund të sjell vendim për shitjen ose ta prolongojë ndarjen e sajë për një afat prej 5 vitesh, po ashtu gjykata mund të vendos që njërit prej bashkëshortëve t'i bartet e drejta e pronësisë mbi banesën familjare, me obligim që ai bashkëshortit tjetrit ti paguaj shumë të caktuar parash.¹⁷⁴

2.3. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik Anglez

Anglia bën pjesë në grupin e shteteve anglo-saksone i cili ndryshe quhet edhe common law ku si e drejtë më autoritative është “Statute Law”, i cili përfshin Aktet e Parlamentit, rregulloret dhe aktet nënligjore. Në mungesë të ndonjë “Statute Law”,

¹⁷¹ Ibid., 1569

¹⁷² Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve II – 2017, fq.6

¹⁷³ Dejan Micković, Angel Ristov: Semejno parvo – Skopje 2015, fq.331

¹⁷⁴ Po aty, fq.332

atëher sistemi common law me parimin e tij të vendosjes së ngulitur formon burimin e mbetur të ligjit, bazuar në vendimet gjyqësore dhe zakonet. Common Law bëhet nga gjyqtarët në senaca gjyqësore, të cilët zbatojnë edhe Statute Law edhe parimet e përcaktuara që rrjedhin nga arsyetimi i vendimeve të mëparshme, mirëpo Common Law mund të ndryshohet ose shfuqizohet nga Parlamenti.¹⁷⁵

Duke pasur parasysh që Anglia nuk bënë pjesë në sistemin juridik kontinental, ai nuk ka një kodifikim gjithëpërfshirës e as kodifikim të së drejtës civile (private), në këtë sistem gjykatësit vendimin e vet për çështje civile e bazon në vendimet gjyqësore, në rastet e gjykuara që konsiderohen precedent. Prandaj regullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në të drejtën Angleze është më i komplikuar krahasuar me të drejtën tonë pasi shtetet e sistemit anglo-sakson ku bënë pjesë edhe Anglia nuk kanë regulla të shkruara siç janë kodet civil apo ligjet në sistemin kontinental.

Që nga fillimi i shekullit të trembëdhjetë deri në vitin 1870 sipas të drejtës angleze burri kishte të drejtën absolute mbi tërë pasurinë e gruas që nga momenti kur ato hynin në martesë, ndërsa gruaja nuk gëzonte të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për të trashëguar. Para vitit 1870, çdo pasuri e fituar nga një grua qoftë përmes pagës, nga investimi, dhurata ose përmes trashëgimisë, që nga momenti i lidhjes së martesës shëndrohet automatikisht në pronë të burrit të saj, kështu identiteti i gruas u përvetësua me ligj në atë të burrit të saj, duke i bërë ato në mënyrë efektive një person sipas ligjit. Pasi një grua martohet, ajo nuk kishte pretendime për pasurinë e saj pasi burri i saj kishte kontroll të plotë dhe mund të bënte gjithçka që i përshtatet lidhur me pasurinë, me ligj ai ishte i lejuar të dispononte me pasurinë në çdo kohë gjatë martesës. Edhe në rast të vdekjes bashkëshorti i gruas vazhdonte të kishte kontroll mbi pasurinë e saj të mëparshme.¹⁷⁶

“Married Women’s Property Act” (akti për pronën e grave të martura) i vitit 1870 parashikonte që pagat dhe pasuritë që një grua i fitonte përmes punës së vet ose të cilat do t’i trashëgonte, do të konsideroheshin si pronë e saj e veçantë, dhe me aktin për pronën e grave të martuar të vitit 1882, ky parim u shtri mbi të gjithë

¹⁷⁵ English law / Wikipedia - https://en.wikipedia.org/wiki/English_law (parë me 01.02.2020)

¹⁷⁶ Married Women's Property Act 1870 / Wikipedia
https://en.wikipedia.org/wiki/Married_Women%27s_Property_Act_1882 (parë me 02.02.2020)

pronën e guras, pavarësisht asaj se nga buron ose kohën e fitimit të pasurisë. Akti gjithashtu mbrojt gruan jo vetëm nga burri i saj duke marrë nën kontroll pronën e saj, por edhe nga njerëzit që punuan për të, kreditori i tij: "Këto akte zakonisht përjashtonin pronat e grave të martuara nga mundësia që kreditorët e burrave të tyre t'u merrnin për realizmin e kërkesave të tyre". Kjo u dha grave të martuar një pasuri të veçantë ligjore, dhe i liroi ata nga hija e burrave.¹⁷⁷

Që pas sjelljes së aktit "Married Women's Property Act - 1882" regullimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në Angli dallon nga ai i shteteve të Europës kontinentale, pasi që e drejta angleze nuk njeh regjime pasuror martesor pra nuk egziston regjimi i pasurisë së përbashkët, por atje kemi ndarjen absolute të pasurisë në mes bashkëshortëve dhe kështu martesë në parim nuk krijonë efekte pronësore. Sipas këtij regullimi bashkëshortët edhe pas lidhjes së martesës vazhdojnë të kenë pasurinë e tyre të ndarë, pra çdonjëri vet administron dhe disponon me pasurinë e tij, po ashtu secili prej bashkëshortëve për borxhet egzistuese dhe ato që mund të lindin më vonë përgjigjet vetë me pasurinë e tij, qoftë para martesës ose gjatë martesës.

Për marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve zbatohen regullat e përgjithshme të së drejtës pronësore të cilat zbatohen për të gjithë personat tjerë, me disa përjashtime: a) njëri përjashtim ka të bëjë në rast të vdekjes së njërit prej bashkëshortëve i cili nuk ka lënë testament, kur pasuria e tij ndahet sipas regullave të veçanta; dhe b) përjashtimi tjetër ka të bëjë me ndarjen e pasurisë në rast të shkurorëzimit të martesës.¹⁷⁸ Në rast se bashkëshortët nuk kanë mundur të arrijnë marrëveshje ndërmjet tyre sa i përket ndarjes së pasurisë në rast të shkurorëzimit të martesës, atëherë gjykata ka të drejtë diskrecionale të sjellë vendim për ndarjen e pasurisë pavarësisht regullave të së drejtës pronësore.

Në të drejtën angleze egzistojnë regulla të posaçme të cilat i dedikohen institutit banesa familjare. Me ligjin për familje të vitit 1996 (Family Law Act) regullohen të drejtat e bashkëshortëve martesorë lidhur me jetesën në shtëpinë e përbashkët, kur ajo është në pronësi të njërit prej bashkëshortëve ose sipas ndonjë baze tjetër ai/ajo ka të drejtë të jetojë në të, e drejta për të banuar në rast të shkurorëzimit të martesës, të drejtat e partnerëve jashtëmartesorë gjatë kohëzgjatjes

¹⁷⁷ Pa aty, (parë me 02.02.2020)

¹⁷⁸ Dejan Micković, Angel Ristov: Semejno parvo – Skopje 2015, fq.334

dhe pas pushimit të bashkësisë jashtëmartesore, statusi i bashkëshortit martesor ose partnerit jashtëmartesorë deri sa asnjëri prej tyre nuk ka të drejtën e banimit.¹⁷⁹ Sipas këtij ligji derisa bashkëshorti martesor ose partneri jashtëmartesor ka qëndruar (banuar) në shtëpinë, ata nuk mund të nxiren jashtë ose t'ju ndalohet hyrja në shtëpinë e përbashkët nga ana e bashkëshortit tjetër, përveç se me vendim gjyqsor.¹⁸⁰ Nëse nuk kanë jetuar në shtëpinë e përbashkët, ata me vendim të gjykatës kanë të drejtë të hyjnë në shtëpi dhe të jetojnë në të, gjatë sjelljes së vendimit gjykata duhet posaçërisht të mbajë llogari për nevojat dhe mundësitë lidhur me qëndrimin e çdonjërës prej palëve, mundësitë financiare të çdonjërës prej palëve, efekti i supozuar i vendimit mbi shëndetin, siguria dhe përfitimi i çdonjërës prej palëve dhe fëmijëve, natyra e marrëdhënieve të palëve, kohëzgjatja e marrëdhënieve dhe ngjajshëm, këto vendime kanë karakter të masave të përkohëshme dhe zgjasin më së shumti 6 muaj me mundësi për shpalljen e tyre përsëri.¹⁸¹

Në rast të shkurorëzimit, gjykatave u jepet një diskrecion shumë i gjerë për të bërë një gamë të gjerë urdhrash, duke përfshirë shitje të pronave, vendosjen e pronave në besim, pagesa të një shume, pagesa periodike, urdhra në lidhje me pensionet etj. Mirëpo gjatë ndarjes së pasurisë gjykata merr parasysh disa rethana siç janë: rritja dhe edukimi i fëmijëve, mirëmbajtja e shtëpisë, kohëzgjatja e martesës, gjendja materiale e bashkëshortëve, kërkesat dhe borxhet që i kanë bashkëshortët etj.

Bashkëshortët në Angli mund të lidhin një marrëveshje martesore e cila lidhet dhe modifikohet para dhe gjatë martesës (dhe madje edhe pas martesës). Efektet e tij natyrisht varen nga rrethanat, por shumë shpesh kushtet apo marrëdhëniet e dakorduara do të jenë efektive vetëm në rast shkurorëzimi pasi që Anglia nuk ka një regjim pasurorë martesorë. Është mjaft e zakonshme që bashkëshortët të lidhin marrëveshje në lidhje me pasurinë e tyre, në atë moment kur ata kanë vendosur të shkurorëzohen (të ashtuquajturat marrëveshje ndarjeje), këto më pas mund të pranohen në urdhrat e gjykatës. Një marrëveshje e drejtë ndërmjet bashkëshortëve në lidhje me shpërndarjen e pasurisë së tyre në rast shkurorëzimi megjithatë mund

¹⁷⁹ Po aty, fq.334

¹⁸⁰ Po aty, fq.334

¹⁸¹ Po aty, fq.334-335

të ketë një rëndësi të konsiderueshme dhe sigurisht është një faktor i rëndësishëm që duhet të merret parasysh nga gjykata kur ushtron diskrecionin e saj.

Kapitulli - IV

1.Kontrata Martesore

Kontrata martesore është një dokument apo akt i shkruar që çiftet mund ta krijojnë - para se të martohen nëse planifikojnë të martohen ose pasi të lidhin martesën. Kontrata martesore (pacta nuptialia), është akt juridik me anë të së cilës bashkëshortët përcaktojnë regjimin e tyre pasuror martesor, para ose pas lidhjes së martesës.¹⁸² Kontrata martesore përkufizohet si një marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve për të përcaktuar mënyrën e rregullimit të aspekteve pasurore gjatë martesës si dhe kryesisht destinacionin e pasurisë në rastin konkret të zgjidhjes së martesës.¹⁸³

Kontrata martesore është një kontratë që lidhet ndërmjet bashkëshortëve apo bashkëshortëve të ardhshëm, me të cilën ata mund të përcaktohen për regjimin pasuror martesorë, të rregullojnë marrëdhëniet juridiko-pasurore dhe marrëdhëniet personale e të përditshme ndërmjet tyre, si dhe mund të bien dakord se si do t'a ndajnë pasurin dhe borxhet e tyre në rast të shkurorëzimit. Kontrata martesore mund të lidhet si para martesës po ashtu edhe pas lidhjes së martesës, mirëpo në disa legjislacione është paraparë që kontratë martesore mund të lidhin vetëm bashkëshortët e ardhshëm një ndër to është shteti ynë fqinjë Shqipëria, ku kodi i familjes në paragrafin e parë të nenit 69 thotë: “Kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre.”¹⁸⁴ pra kodi e thekson në mënyrë të prerë që kontratë martesore mund të lidhin vetëm bashkëshortët e ardhshëm, po ashtu në paragrafin e tretë të nenit 69 - noteri obligohet që një kopje të kontratës martesore ta depozitojë në zyrën e gjendjes civile para se të lidhet martesa. Shumica e kontratave martesore hartohen dhe nënshkruhen përpara datës së martesës dhe kjo periudhë zakonisht është një ide shumë e mirë. Kontratat e martesës zakonisht kanë për qëllim të

¹⁸² Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve I – 2017, fq.21

¹⁸³ Blerina Dodaj: “Kontrata E Martesës, Zhvillimi Dhe Aplikimi I Saj Në Republikën E Shqipërisë” - Tiranë, 2019, fq.66

¹⁸⁴ “KODI I FAMILJES” – Republika e Shqipërisë Ligji Nr.9062, data 08.05.2003

merren me çështjet ligjore në rast se martesë shkëputet, por ato gjithashtu mund të merren edhe me mënyrën se si gjërat e përditshme do të trajtohen gjatë martesës.¹⁸⁵

Kontratat e martesore në momentin që lidhen nga bashkëshortët marri fuqinë e ligjit dhe ato janë të detyrueshme për palët në bazë të parimit “pacta sunt servanda”. Ata mund të zbatohen me ndihmën e gjykatës nëse ndonjëra nga palët përpiqet t’i shmanget ose të ndryshojë një detyrim për të cilin kanë rënë dakord. Nuk ka ligji apo nen me të cilin bashkëshortët mund të detyrohen që me rastin e lidhjes së martesës të lidhin kontratë martesore, por ajo është në dispozicion të palëve.

Nëse një kontratë martesore është e përshtatshme dhe e dëshirueshme, bashkëshortët e ardhshëm do të negociojnë kushtet e marrëveshjes dhe njëra ose të dyja palët do të hartojnë një marrëveshje me shkrim, mirëpo është shumë e rëndësishme që të dyja palët të bëjnë paraqitjen (zbulimin) e plotë pasurore dhe të marrin këshilla të pavarura ligjore për atë se çfarë saktësisht do të thotë marrëveshja, si ndikon në të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre aktuale ndaj njëri-tjetrit dhe se si do të ndikojë në po ato të drejta dhe përgjegjësitë nëse vjen deri te shkëputja e martesës.¹⁸⁶ Vlen të theksohet se kontratat martesore janë shumë të komplikuar dhe për tu hartuar duhet një njohuri e mirë e së drejtës familjare në përgjithësi dhe marrëveshjeve martesore në veçanti, në rastin kur çiftet përcaktohen të lidhin kontratë martesore është mirë që të angazhojnë një avokat, i cili do të hartonte kontratën në mënyrën më të mirë të mundëshme.

1.1. Dallimi në mes Kontratës paramartesore dhe kontratës martesore

Kontrata paramartesore (prenuptial agreement) është një kontratë e shkruar e krijuar nga dy persona para se të martohen. Në një kontratë paramartesore çiftet zakonisht e paraqesin të gjithë pasurinë që e posedojnë çdonjëri prej tyre (si dhe borxhet që kanë) dhe mund të specifikojnë se cilat do të jenë të drejtat e pronësisë të secilit prej tyre pas martesës. *Kontrata martesore* e quajtur në disa vende si “kontratë pas-martese” është e njejtë me një kontratë paramartesore, përveç se ajo është lidhur pasi palët të jenë martuar.

Mirëpo duhet pasur parasyshë se termi kontratë martesore ose kontratë paramartesore dallon varësisht nga shteti në shtet pasi që në disa shtete, ajo njihet

¹⁸⁵ Boyd, J.-P.: “Marriage Agreements” (2017, May 26). *Wiki Clicklaw*.

¹⁸⁶ Boyd, J.-P.: “Marriage Agreements” (2017, May 26). *Wiki Clicklaw*.

si: "kontratë prenuptial" ose si një "kontratë antenuptial", ndërsa në terma më moderne ajo njihet si një "kontratë paramartesorë" mirëpo ndonjëherë ka raste kur fjala "kontratë" zëvendësohet me fjalën "marrëveshje", si në "marrëveshje paramartesorë". Po ashtu kemi situata kur kontratat lidhen edhe gjatë martesës në këto situata kontrata e lidhur gjatë martesës është e njohur si një kontratë: "pas-nuptial", "pas-martese" ose "martesorë".

Në këtë punim gjatë trajtimit të kontratës martesore si koncept, termi kontratë martesore do të përdoret njëllë për të dy rastet (situatat), pra edhe për "kontratat paramartesorë" dhe "kontrata pas-martese", pasi që kanë të njëjtën përmbajtje, por ndryshojnë vetëm në kohën e përpilimit të tyre.

2. Elementet thelbësore të përgjithshme të kontratës martesore

Kontrata është një insitucion i cili themelohet nën kushtet e parapara me ligj, ku thuajse në të gjitha legjislacionet e shteteve për lidhjen e kontratës kërkohen të plotësohen kushtet e caktuara me ligj. Edhe për kontratën martesore vlen e njëjta, mirëpo duke pasur parasysh që nuk ka rregulla të veçanta, për sa i përket lidhjes dhe plotëfuqishmëris së kontratës martesore, atëher vlejnë dhe zbatohen rregullat e përgjithshme mbi kontratat detyrimore. Kontrata martesore lidhet me pajtimin e vullnetshëm të palëve kontraktuse lidhur me elementet thelbësore të kontratës, mirëpo për të krijuar efekte juridike duhet të përmbushen kushtet e caktuara me ligj.

Kështu si kushte për kontratë quhen ato elemente thelbësore të përgjithshme, mungesa e të cilave bën që kontrata martesore të jetë e pavlefshme, kushtet janë elemente me ngarkesë positive, të cilat duhet të përmbushen, të ekzistojnë, të plotësohen prej bashkëshortëve të ardhshëm, pra, kjo do të thotë se rendi juridik i ka përcaktuar këto kushte si elemente thelbësore të përgjithshme.¹⁸⁷ Elementet thelbësore të përgjithshme të kontratës martesore janë: 1. Zotësia e palëve për lidhjen e kontratës martesore, 2. Pëlqimi i vullnetit, 3. Objekti i kontratës, si dhe 4. Forma e kontratës.

¹⁸⁷ Blerina Dodaj: "Kontrata E Martesës, Zhvillimi Dhe Aplikimi I Saj Në Republikën E Shqipërisë" - Tiranë, 2019, fq.113

2.1. Zotësia e palëve për lidhjen e kontratës martesore

Zotësia e veprimit e palëve kontraktuse në këtë rast e bashkëshortëve martesorë është kusht i cili kërkohet për lidhjen e kontratës. Zotësia (aftësia) që me deklarimin e vullnetit të vet të fitojë të drejta dhe detyrime në mënyrë të pavarur dhe përgjithësisht të ndërmarr punë juridike quhet zotësi (aftësi për të vepruar).¹⁸⁸ Kontrata martesore lidhet në bazë të vullnetit të lirë dhe të pavarur të vetë bashkëshortëve me zotësi veprimi, të cilët kanë aftësi për të gjykuar, respektivisht për të kuptuar rëndësinë dhe pasojat e kontratës.¹⁸⁹

Zotësia e veprimit fitohet me arritjen e moshës madhore (moshën 18 vjeçare), mirëpo egziston një përjashtim kur zotësia e veprimit mund të fitohet edhe para arritjes së moshës madhore nëpërmjet institutit juridik të emancipimit. Me institutin juridik të emancipimit kuptojmë që çiftet mund të lidhin martesë që në moshën 16 vjeçare me leje të organit kompetent, dhe me lidhjen e martesës bashkëshortët fitojnë edhe zotësin e veprimit që në moshën 16 vjeçare. Nëse lidhet kontrata martesore nga partnerët të cilët nuk kanë aftësi (zotësi) për të vepruar, kontrata e këtillë nuk do të krijojë efekte juridike dhe do të konsiderohet si kontratë nule.

2.2. Pëlqimi i vullnetit

Pëlqimi i vullnetit është kusht i tjetër i cili kërkohet për lidhje e kontratës martesore. Pëlqimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, sepse që të lidhet kontrata vullnetit i dy palëve kontraktuse duhet të jetë i përputhur.¹⁹⁰ Kur vullneti i tyre përputhet, konsiderohet se kontrata është lidhur duke u marrë vesh për elementet thelbësore të saj.¹⁹¹ Tek ky lloj i kontratës vullneti i palëve në këtë rast i bashkëshortëve duhet të jetë i deklaruar shprehimisht, që nënkupton se ai është dhënë me fjalë gojarisht ose me shkrim.

Vullenti i bashkëshortëve ose bashkëshortëve të ardhshëm duhet të jetë i lirë, kjo nënkupton që kontrata martesore nuk duhet të lidhet me ndonjë imponim të shprehur në formë të lajthimit, mashtimit ose dhunës. Në qoftë se pëlqimi për lidhjen e kontratës martesore është dhënë përmes kërcnimit, lajthimit, mashtimit atëherë ajo kontratë martesore nuk është e plotëfuqishme. Vullneti duhet të jetë vullnet i vërtetë

¹⁸⁸ Abdulla Aliu: E drejta Civile – Prishtinë, 2013, fq.232

¹⁸⁹ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve I – 2017, fq.21

¹⁹⁰ Nerxhivane Dauti: E drejta e Detyrimeve – Prishtinë, 2001, fq.64

¹⁹¹ Po aty, fq.64

që do të thotë vullneti i shprehur (deklaruar) duhet të përputhet me vullnetin e brendshëm.

Pëlqimi i bashkëshortëve duhet kuptuar në të dy anët e shprehjes së vullnetit edhe në lidhje me mosshprehjen e vullnetit për zgjedhjen e një regjimi dhe për rrjedhojë aplikimin e regjimit të bashkësisë ligjore si dhe shprehja e vullnetit për regjimin me kontratë.¹⁹²

2.3. Objekti i kontratës martesore

Objekti i kontratës është kushti kryesor i cili kërkohet për lidhjen e kontratës martesore, ajo është lënda për të cilën palët meren vesh ose për çka lidhet kontrata. Objekti i kontratës është qëllimi i subjekteve për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie juridike civile duke përputhur vullnetin e tyre në të njëjtin drejtim.¹⁹³ Gjithashtu duhet mbajtur në konsideratë se objekti i kontratës së martesës është i kushtëzuar edhe nga fakti i vetë institutit të martesës.¹⁹⁴

Kontrata martesore është një akt juridik kompleks, që parasëgjithash ka për qëllim të caktojë statusin financiar të ekonomisë së ardhshme të familjes, respektivisht të pozitës juridiko-pasurore të bashkëshortëve në martesë.¹⁹⁵ Kontrata martesore është instrument i cili u shërben bashkëshortëve që marrëdhëniet e tyre pasurore t'i rregullojnë sipas interesit të tyre, bashkëshortët nëpërmjet kontratës martesore shprehin vullnetin e tyre të lirë duke i përcaktuar për ndonjërin prej regjimeve pasurore të cilat i ofron ligji si regjime të mundshme për tu kontraktuar. Po ashtu bashkëshortët me ndihmën e kontratës martesore mund të merren vesh edhe për çështje tjera, përderisa ato nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Kontrata martesore si e tillë, karakteristikat janë të kushtëzuara nga martesja dhe prandaj objekti përveç se i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të caktohet, duhet të jetë në kufijtë e caktimit të pasurive ndërmjet bashkëshortëve, nuk mund të shmangë detyrimet reciproke të bashkëshortëve që burojnë nga martesja si dhe nuk mund të cënojë në asnjë rast parimin e interesit më të lartë të fëmijës.¹⁹⁶

¹⁹² Blerina Dodaj: "Kontrata E Martesës, Zhvillimi Dhe Aplikimi I Saj Në Republikën E Shqipërisë" - Tiranë, 2019, fq.91

¹⁹³ Po aty, fq.97

¹⁹⁴ Omari, S.: E drejta familjare – Tiranë, 2012, fq. 90

¹⁹⁵ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve I – 2017, fq.22

¹⁹⁶ Blerina Dodaj: "Kontrata E Martesës, Zhvillimi Dhe Aplikimi I Saj Në Republikën E Shqipërisë" - Tiranë, 2019, fq.91

Objekt i kontratës martesore mund të jetë identifikimi dhe ndarja e pasurive të veçanta dhe atyre martesore – duke pasur parasysh që kur çiftet shkurorezohen, një nga detyrat e para është identifikimi dhe ndarja e pasurisë së veçantë dhe asaj martesore. Nga kjo nënkuptojmë që secilit prej bashkëshortëve u bje bara që ta dëshmojnë se atë pronë e kanë fituar para se të martohen, e në ato raste ajo do të mbetet pronë e tyre e veçantë, dhe gjykata nuk do t'i jepte asnjë prej tyre bashkëshortit tjetër. Mirëpo nëse hartohet siç duhet kontrata martesore, me ndihmën e saj mund të identifikojmë pronën e veçantë të secilit bashkëshort dhe të konfirmojë se si do të trajtohet ajo pronë pas divorcit, gjithashtu në kontratën martesore mund të vendosni paraprakisht se si do të ndani pasuritë tuaja martesore.

Po ashtu objekt i kontratës martesore mund të jetë identifikimi dhe caktimi i borxheve personale dhe atyre martesore - Nuk egziston dyshim se problemet me paratë mund të jenë shkak i shumë shkurorezimeve, mirëpo nëse një çiftë dëshiron të shmangë rënien në të njëjtën grackë në të cilën bien shumë çifte, atëher mund të shtojnë një dispozitë në kontratën e tyre paramartesore për të adresuar borxhin. Po ashtu në kontratën martesore mund të identifikohen edhe detyrime e ndara personale dhe detyrimet martesore dhe për atë se si do ta ndanin secilin borxh. Kontratat martesore janë veçanërisht të dobishme nëse një bashkëshort sjell me vete një sasi të konsiderueshme borxhi në bashkësinë martesore, dhe në këto raste bashkëshorti tjetër me një dispozitë të veçantë në kontratën paramartesore mund të sigurohet që nuk do të jetë përgjegjës për borxhin dhe zakonet e këqija të partnerit të tij.

“Me anë të kontratës martesore bashkëshortët mund:

- Të ndryshojnë regjimin pasuror ligjor, ose të kontraktojnë njërin prej regjimeve subsidijare të mundshme;
- Të kontraktojnë mirazin, dhuratën e mëngjezit;
- Të përcaktojnë se çka numërohet në pronësi të veçantë dhe çka në pronësi të krijuar;
- Të ndanë një pjesë nga pronësia e krijuar dhe t'ia bashkojnë pronësisë së veçantë të njërit bashkëshort, ose të meren vesh që të ardhurat nga pronësia e veçantë mos të përfshihen në pronësinë e krijuar;
- Të ndryshojnë rregullat lidhur me administrimin dhe disponimin me pasurinë;

- Të merren vesh që pjesë e pasurisë së krijuar të jenë edhe të gjitha sendet e luajtshme;
- Të merren vesh që pasurinë ta ndajnë në një mënyrë tjetër;
- Të merren vesh për rikthimin e regjimit të mëparshëm ose për caktimin e një regjimi të ri kontraktor.¹⁹⁷

2.4. Forma e kontratës martesore

Forma e kontratës është manifestim i jashtë i përmbajtjes së kontratës.¹⁹⁸

Forma e kontratës është kusht i përgjithshëm i cili kërkohet për lidhjen e kontratës martesore, nga kjo nënkuptojmë që kontrata martesore duhet të ketë formën dhe përmbajtjen e caktuar me ligj që të mund të prodhojë efekt juridik. Forma e kontratës është veshja e jashtme e vullnetit të palëve, që për efekt të provueshmërisë dhe për efekt të vlefshmërisë merr rëndësinë e duhur dhe sipas rastit ka funksione të ndryshme.¹⁹⁹

Kontrata martesore duhet të lidhet në formë të dokumentit publik, që domethën ajo lidhet në formë të shkruar në praninë e të dy bashkëshortëve të cilët duhet të nënshkruajnë përpara autoritetit publik, i cili në shumicën e shteteve është noteri.

Qëllimi kryesor, i parashikimit të formës noteriale, për kontratën martesore është mbrojtja e palëve kontraktore.²⁰⁰ Nëpërmjet formës noteriale dhe pjesëmarrjes së njëkohshme të të dy bashkëshortëve ose përfaqësuesve të tyre për lidhjen e kontratës martesore, duket që ligjvënësi ka dashur të bëjë të mundur që bashkëshortët të kuptojnë “pasojat” që mund të sjellë për to zbatimin e regjimit ligjor dhe zbatimin e regjimit të ri kontraktor si dhe të realizojë një shprehje reale dhe serioze të vullnetit të tyre, të pandikuar nga faktorë të tjerë²⁰¹. Noterit ka detyrimin të sqarojë palët mbi pyetjet apo paqartësitë që ato mund të kenë.

Forma si kusht për plotfuqishmërinë e kontratës martesore është paraparë për arsye të sigurisë juridike, respektivisht, kompleksitetit të problemeve që lidhen

¹⁹⁷ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve I – 2017, fq.22

¹⁹⁸ Nerxhivane Dauti: E drejta e Detyrimeve – Prishtinë, 2001, fq.73

¹⁹⁹ Blerina Dodaj: “Kontrata E Martesës, Zhvillimi Dhe Aplikimi I Saj Në Republikën E Shqipërisë” - Tiranë, 2019, fq.103

²⁰⁰ Eniana Qarri: Kontrata Martesore – Tiranë, 2014, fq.98

²⁰¹ De Rubertis, Giovanni: “Le convenzioni matrimoniali in generale”. Vita Notarile, Studi, Problemi e lettere del notariato, Palermo 1975, fq. 940

me zgjedhjen e një regjimi pasuror, mbrojtjes së interesave të bashkëshortëve, mbrojtjes së interesave të personave të tretë, për shkak të argumentimit më të lehtë në rast të konfliktit ndërmjet bashkëshortëve, respektivisht në rast të egzistimit të borxheve të njërit bashkëshort ndaj personave të tretë.²⁰²

Bashkëshortët mund të lidhin kontrata në lidhje me administrimin dhe disponimin me pasurinë, dhe për to nuk kërkohet forma e kualifikuar (me shkrim), kjo për arsye që të mos pengohet qarkullimi juridik dhe të mbrohen interesat e personave të tretë. Nuk është praktike që për çdo kontratë që lidhet ndërmjet bashkëshortëve të kërkohet forma formale, që kontrata të lidhet në formë të shkruar përpara noterit pasi kjo kërkesë do të shkel parimin e “lirisë së formës kontraktore”. Forma e shkruar e kontratës dhe verifikimi nga ana e noterit, kërkohet vetëm te kontratat me të cilat bëhet përcaktimi i regjimit pasuror, ndryshimet e tij të parapara me ligj, respektivisht heqja dorë nga regjimi i kontraktuar.²⁰³

3. Anët pozitive dhe negative të kontratës martesore

E vërteta është se martesa nuk është vetëm një marrëdhënie romantike, emocionale, e spirituale, por ajo është edhe një lloj marrëdhënie ekonomike apo biznesi. Natyra dhe qëllimi i dyfishtë i martesës ka çuar në rritjen drastike të numrit të qytetarëve të cilët e pranojnë apo njohën së njëjti Kontrate martesore (e quajtur gjithashtu një kontratë paramartesorë ose pasmartesorë) e cila mund të jetë e dobishme për të mbrojtur interesat financiare të secilit bashkëshort.

Megjithëse shoqëria shpesh kontratën martesore e mendon si diçka që u shërben ose është vetëm për të pasurit, mirëpo kjo kontratë është një mundësi apo opcion që për disa struktura familjare mund të konsiderohet si tepër të dobishme. Kontrata martesore mund të përdoret për t'i kaluar një pjesë të pasurisë së veçantë, fëmijëve nga martesat e mëparshme, ose për të shmangur apo zvogëluar problemet që mund të sjellë shkurorëzim i martesës, pasi gjithçka është përshkruar tashmë dhe në mesë të bashkëshortëve nuk ka çështje diskutabile.

Më poshtë është realizuar një ekzaminim se: 1) pse kontrata martesore është ide e mirë për tu lidhur dhe 2) pse kontrata martesore nuk është ide e mirë për tu lidhur,

²⁰² Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve I – 2017, fq.23

²⁰³ Po aty, fq.24

megjithëse variantet në legjislacionet e shteteve janë gjithashtu të rëndësishme për t'u marrë parasysh.

3.1. Kontrata martesore konsiderohet si ide e mire për tu lidhur – avantazhet e kontratës martesore

- Me kontratë martesore mund të mbrohet e drejta e trashëgimisë së fëmijëve dhe nipërve nga martesa e mëparshme;
- Me kontratë martesore mund të mbrohet interesi i njërit bashkëshortë, në mënyrë që biznesi ose puna profesionale e tij të mos ndahet dhe të mos i nënshtrohet kontrollit nga bashkëshorti tjetër në rast të shkurorëzimit;
- Nëse njëri bashkëshort ka borxhe dukshëm më shumë se tjetri, atëherë me kontratë martesore bashkëshorti i cili nuk ka borxhe, mund të mbrohet nga obligimi që të merret me borxhet e bashkëshortit tjetër;
- Nëse njëri bashkëshortë planifikon të heq dorë nga një karrierë fitimprurëse pas lidhjes së martesës, atëherë ai bashkëshortë me anë të kontratës martesore mund të sigurohet që do të kompensohet për atë sakrificë nëse martesa nuk zgjat – ndërpritet;
- Me kontratë martesore nuk trajtohen vetëm aspektet financiare të martesës, por shumë aspekte tjera, gjithashtu kontrata martesore mund të mbulojë cilindo nga detajet e vendimmarrjes dhe ndarjen e përgjegjësisë për të cilat bashkëshortët bien dakord paraprakisht;
- Me kontratë martesore mund të kufizohet sasia e shumës së mbështetjes që një bashkëshort do të duhet t'i paguajë tjetrit pas shkurorëzimit. Edhe pse disa shtete, kanë ligje që diktojnë faktorët që duhet të merren parasysh, kur të caktohet një pagesë alimentacioni për mbështetjen e bashkëshortëve në rast të shkurorëzimit;
- Me kontratë martesore mund të mbrohen interesat financiare të bashkëshortëve të moshuar, atyre që hyjnë në martesa të dyta, dhe personave me pasuri të konsiderueshme;
- Me kontratë martesore reduktohet konflikti në të ardhmen. Pasi që me përpilimin e një kontrate martesore, aty përcaktohet se si do të trajtohen apo rregullohen çështjet që mund të jenë konfliktuoze mes bashkëshortëve në rast

të shkurorëzimit. Gjithashtu mund të ndihmojë për të zvogëluar kohën që duhet harxhuar për të zgjidhur çështjen e shkurorëzimit;

- Kontrata martesore lehtëson shkurorëzimin, pasi që lidhja e një kontrate martesore mund të ndihmojë në shmangien e proceseve gjyqësore të zgjatura, të cilat sjellin shpenzime të shumta (si pagesa e avokatëve për aq kohë sa ka zgjatur procedura e shkurorëzimit), duke pasur parasysh që pritjet nga të dy bashkëshortët janë të qarta që nga momenti kur hynë në martesë;
- Kontrata martesore mbron pasuritë e fituara para lidhjes së martesës;
- Me kontratë martesore mund të përcakohet se cilat pasuri dëshiron njëri bashkëshort t'u jep fëmijëve ose anëtarëve të tjerë të familjes në rast të vdekjes.²⁰⁴

3.2. Kontrata martesore nuk konsideohet ide e mire për tu lidhur – disavantazhet e kontratës martesore

- Me kontratë martesore mund të kërkohet nga njëri bashkëshortë që të heq dorë nga e drejta e tij për të trashëguar pasurinë e bashkëshortit të tij, kur ai ose ajo të vdes. Edhe pse sipas ligjit, bashkëshorti ka të drejtë në një pjesë të pasurisë së bashkëshortit tjetër, përderisa nuk është përfshi një dispozitë e tillë në kontratë;
- Kur marrëdhënja fillon me një kontratë martesore, e cila përcakton detajet e asaj se çka do të ndodhë në rast të vdekjes ose shkurorëzimit, kjo mund të krijojë një ndjenjë të mungesës së besimit në mes bashkëshortëve;
- Mund të jetë e vështirë të projektohet për të ardhmen, për atë se si duhet të trajtohen çështjet e mundshme, pasi që edhe ajo që mund të duket si një kompromis i parëndësishëm në periudhën romantike paramartesore, më vonë mund të duket më monumentale dhe më e rëndë;
- Me kontratë martesore mund të kufizohet sasia e shumës së mbështetjes së bashkëshortit për të cilën ka të drejtë njëri bashkëshortë, dhe në këtë situatë nëse vin deri tek shkurorëzimi bashkëshorti jo i punësuar ose me të ardhura të ulta, mund të mos jetë në gjendje të mbajë stilin e jetës për të cilën ai ose ajo është mësuar gjatë martesës;

²⁰⁴<https://www.google.com/> Google Search: “Pros and Cons marital agreements”, “Pros and Cons prenuptial agreements” – 02/2020.

- Shumë kontrata martesore lidhen gjatë asaj faze që quhet "muaji i mjaltit - i një marrëdhënieje", kjo është një periudhë kur dashuria dhe pasioni për njëri-tjetrin janë në nivelin më të fortë, duke krijuar një lidhje emocionale që mund të kemi frikë ta humbim. Kur jemi në këtë fazë, është më lehtë të biem dakord me terma që nuk janë në interesin tonë më të mirë, sepse ndjehemi sikur është më e rëndësishme të jemi me atë person sesa të kujdesemi për gjendjen tonë të mundshme financiare në të ardhmen;
- Me lidhjen e kontratës martesore, bashkëshortit i cili udhëheq biznes mund të vendos dispozitë me të cilën pengon (ndalon) bashkëshortin e tij të hyjë në këtë vlerë, edhe për kundër faktit që ai bashkëshort kontribuon në suksesin e vazhdushëm dhe rritjen e biznesit ose punës profesionale të partnerit të tij dhe ka të drejtë të marrë pjesën e tij të fitimeve që vijnë si rezultat i kontributit të tij, pasi shumë shtete rritjen e vlerës e konsiderojnë si pasuri martesore të ndashme gjatë shkurorëzimit;
- Lidhja e kontratës martesore konsiderohet si një vrasës romance, edhe pse martesë është një partneritet që tejkalon romancën dhe përfshin çështje serioze siç janë prona dhe financa, për disa çifte diskutimi i këtyre çështjeve mund të sjellë një të metë në këtë periudhë emocionuese;
- Krijimi i një kontrate martesore, nga disa partner shikohet si "planifikimi i shkurorëzimit" para "planifikimit të dasmës";
- Lidhja e kontratës martesore krijon ndjenjën e mosbesimi dhe mosigurisë në mes partnerëve,²⁰⁵


Të mirat dhe të këqijat e një kontrate martesore përfshini atë që dëshironi të jetë situata juaj e ardhshme financiare, në rast se ndodh diçka në marrëdhënien tuaj aktuale. Disa njerëz nuk mund ta imagjinojnë që martesë e tyre mund të përfundojë një ditë, kështu që ata nuk e marrin seriozisht këtë kontratë ligjore. Nëse keni fëmijë nga një martesë e mëparshme të cilët duhet të përfshihen në pasurinë tuaj, keni pasuri të majme, para të gatshme, prona për t'u mbrojtur, ose doni një strukturë të plotë në vend përpara se të martoheni, atëherë do të doni t'i jepni kësaj kontrate një vështrim më të afërt.

²⁰⁵ <https://www.google.com/> Google Search: "Pros and Cons marital agreements", "Pros and Cons prenuptial agreements" – 02/2020.

4.Përpunimi i të dhënave të fituara nga anketa e realizuar me qytetarët


Në kuadër të këtij hulumtimi shkencor autori ka përpiluar një pyetësor të cilin e ka realizuar në pjesën veri-perëndimore të RMV-së. Realizimi i kësaj ankete është bërë me të vetmin qëllim për të kontribuar në përmisimin e kualitetit të këtij hulumtimi shkencor si dhe për nxjerjen e të dhënave se çfarë mendimesh kanë qytetarët e RMV-së për regjimin pasurorë, kontratën martesore, administrimin dhe disponimin me pasurinë, si dhe a kanë njohuri dhe informacione për këto. Ky pyetësorë përbëhet nga dy pjesë, pjesa parë përmban 3 pyetje për të dhënat e anketuarit si: Mosha, Gjinia, Statusi martesor., ndërsa pjesa e dytë përmbanë 12 pyetje të cilat janë në lidhje me temën e hulumtimit.

Realizimin i këtij pyetësori është bërë në dy mënyra në formë elektronike dhe në formë të shkruar, në këtë pyetësorë kanë kontribuar gjithsej 475 qytetarë duke dhënë mendimet e tyre, mirëpo kemi situata kur të anketuarit kanë refuzuar të plotësojnë ndonjë pyetje ose janë përgjigjur duke i selektuar të gjitha opcionet e dhëna, e në këto situata konsiderohet se nuk është dhënë fare përgjigje. Me përpunimin e të gjitha anketave janë fituar rezultatet në vijm:




Grafikoni 1 - Mosha e të anketuarve

Në pyetjen se cilës moshe i takojnë të anketuarit nga gjithësej 475 të anketuar, 20 janë nën moshën 18 vjeçare, 315 janë të moshës 18-29 vjet, 106 janë të moshës 30-45 vjet, dhe 34 janë mbi moshën 45 vjeçare.



Grafikoni 2- Gjinia e të anketuarve

Në pyetjen se cilës gjini i takojnë të anketuarit përgjigje kanë dhënë gjithsej 473 të anketuar, prej të cilëve 288 janë të gjinis Femrore, ndërsa 185 të gjinis mashkullore.



Grafikoni 3- Statusi Martesor i të anketuarve


Në pyetjen për statusin martesor të të anketuarve përgjigje kanë dhënë gjithsej 474 të anketuar, prej të cilëve 162 janë të martuar, 6 janë të shkurorëzuar, 137 janë në lidhje, ndërsa 169 janë beqarë.



Grafikoni 4- Regjimi pasuror i bashkëshortëve

Në pyetjen se a kanë dëgjuar ndonjëherë për regjimin pasuror të bashkëshortëve, janë përgjigjur gjithsej 473 të anketuar, prej të cilëve 308 kanë


deklaruar se kanë dëgjuar për regjimin pasuror, ndërsa 165 jo nuk kanë degjuar për regjimin pasuror.



Grafikoni 5- Ndarja e pasurisë së përbashkët në mes bashkëshortëve

Në pyetjen se a janë të informuar që pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ndahet përgjysë në mes burrit dhe guras, janë përgjigjur gjithsej 475 të anketuar prej të cilëve 386 të anketuar janë përgjigjur se po janë të informuar, ndërsa 89 të anketuar nuk janë të informuar.

3. Në cilat nga situatat e mëposhtme mendoni se njërit bashkëshort do ti takojë më tepër se gjysa e pasurisë?



Grafikoni 6- Situata kurrë bashkëshorti fiton më tepër se gjysa e pasurisë

Në pyetjen se në cilat situata njërit bashkëshortë do ti takojë më tepër se gjysa e pasurisë, janë përgjigjur gjithsej 465 të anketuar prej të cilëve 142 mendojnë vetëm në situatë kur njëri bashkëshortë punon ndërsa tjetri kujdeset për fëmijët dhe punët e shtëpisë, 86 të anketuar mendojnë që kur janë të punësuar të dy mirëpo njëri realizon të hyra më të mëdha, ndërsa 237 mendojnë që vetëm në situatën kur njëri nga bashkëshortët do të mund të dëshmojë se ka fituar dhe ka sjellur më shumë të ardhura në familje.


4.A jeni të interesuar të dini se cilat pjesë të pasurisë martesore u takojnë juve?



Grafikoni 7- Interesimi për pjesët e pasurisë martesore


Në pyetjen se a jeni të interesuar të dini se cilët pjesë të pasurisë martesore u takojnë juve, janë përgjigjur gjithsej 474 të anketuar prej të cilëve 379 janë shprehur se po duan të kenë më tepër informacione lidhur me pasurinë martesore, ndërsa 95 e të anketuarve janë shprehur se nuk janë të interesuar.

5.Si mendoni, kush menaxhon me pasurinë gjatë martesës?



Grafikoni 8- Menaxhimi me pasurin gjatë martesës


Në pyetjen se kush menaxhon me pasurinë gjatë martesës, janë përgjigjur gjithsej 471 të anketuar, prej të cilëve 94 të anketuar mendojnë që burri, 15 të anketuar mendojnë që gruaja, ndërsa 362 të anketuar mendojnë që burri dhe gruaja bashkërisht.



Grafikoni 9- Disponimi me pasurin pa lejen e njërit bashkëshortë

Në pyetjen se a ju ka ndodhur që bashkeshorti/ja të disponojë me pasurinë e përbashkët pa lejen tuaj, ose a keni ndëgjuar ndonjë rast të tillë, përgjigje kanë dhënë gjithsej 473 të anketuar, prej të cilëve 22 të anketuar janë deklaruar që po ju ka ndodhur që bashkeshorti/ja të disponoj me pasurinë pa lejen e tyre, 227 të anketuar janë përgjigjur që nuk ju ka ndodhur një rast i këtillë, e as që kanë ndëgjuar ndonjëher për ndonjë rast të këtillë, ndërsa 224 janë përgjigjur se po kanë dëgjuar për raste të këtilla në rrethin e tyre të afërt.


7.A keni dëgjuar ndonjëherë për kontratën martesore (Ku në shumë shtete bashkëshortët kanë mundësi që me kontratë të përcaktojnë se cilat sende do të përfshihen në pasurinë e përbashket dhe cilat në pasurinë e veçantë, kush do të administroj me pasurinë



Grafikoni 10- Kontrata martesore

Në pyetjen se a kanë dëgjuar ndonjëherë për kontratën martesore, gjithsej janë përgjigjur 473 të anketuar, prej të cilëve 364 të anketuar janë përgjigjur se po kanë dëgjuar për kontratën martesore, ndërsa 109 janë përgjigjur se nuk kanë dëgjuar për kontratën martesore.


8.A e dini nëse është e lejuar lidhja e kontratës martesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?



Grafikoni 11- Kontrata martesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut


Në pyetjen se a është e lejuar lidhja e kontratës martesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë përgjigjur gjithsej 258 të anketuar, prej të cilëve 274 të anketuar janë përgjigjur se është e lejuar kontrata martesore në RMV, ndërsa 184 të anketuar janë përgjigjur se nuk është e lejuar kontrata martesore në RMV.

9.A mendoni se me lidhjen e kontratës martesore, marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve mund të transferohen nga ato emocionale(emotive) në pasurore. Me arsye se, që në momentin e lidhjes së martesës fokusi është në ndarjen e pasurisë?




Grafikoni 12- Me lidhjen e kontratës martesore, a humbet lidhja emocionale dhe i jepet rëndësi asaj pasurore

Në pyetjen se me lidhjen e kontratës martesore, marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve mund të transferohen nga ato emocionale(emotive) në pasurore me arsye se, që në momentin e lidhjes së martesës fokusi është në ndarjen e pasurisë, janë përgjigjur gjithsej 470 të anketuar, nga të cilët 218 të anketuar janë përgjigjur që zbehet lidhja emotive, pasi i jepet më tepër rëndësi aspektit pasuror dhe kjo reflekton në mosbesim në mes bashkëshortëve, ndërsa 252 të anketuar janë përgjigjur jo pasi me kontratën martesore rregullohen shumë aspekte gjatë martesës jo vetëm çështja pasurore.



Grafikoni 13- Lidhja e kontratës martesore


Në pyetjen se a do të kishit lidhur një kontratë martesore, janë përgjigjur gjithsej 474 të anketuar, nga të cilët 258 të anketuar janë përgjigjur se po do të kishin lidhur një kontratë martesore, ndërsa 216 të anketuar janë përgjigjur jo, nuk do të kishin lidhur kontratë martesore.



Grafikoni 14- Arsyet për të mos lidhurë kontratë martesore

Në pyetjen se cilat janë arsyet që të mos lidhni kontratë martesore, janë përgjigjur gjithsej 120 të anketuar nga 216 të anketuar të cilët janë përgjigjur se nuk do të kishin lidhur kontratë martesore, siç mund të shihet në grafikunin lartë 35 të anketuar janë përgjigjur se nuk do të kishin lidhur K.M për shkak të *besimit* që kanë ndërmjet vete ose për të mos humbur besimin ndërmjet tyre, 24 të anketuar janë përgjigjur që përshkak të *dashurisë* së madhe apo pasi që dashuria vlen më shumë se gjithçka, 14 të anketuar janë përgjigjur se nuk ju intereson *pasuria* apo nuk duan martes për pasuri, 11 të anketuar janë përgjigjur që K.M është e *panevojshme* pasi ligji i mbron interesat apo kur në mes bashkëshortëve ka marrëveshje, 6 të anketuar janë përgjigjur që *ska arsye* thjesht zduan të lidhin K.M, 4 të anketuar janë përgjigjur që *sjanë të interesuar* për K.M, 4 të anketuar janë përgjigjur që për ta K.M është *çështje interesi*, 3 të anketuar janë përgjigjur që lidhja e K.M e *shkatron efektin emotiv shpirtëror* tek bashkëshortët, ndërsa 19 të anketuar janë përgjigjur në mënyra të ndryshme duke dhënë këto arsye të ndryshme: gjatë martesës gjithçka është e përbashkët çka është e imja është e të dyve, mosbesimi në K.M si institut, jeta

martesore stabile, martesë nuk është biznes, planifikohet ndarja, martesë lidhje tjetër jo pasurore, K.M i kufizon disa liri dhe të drejta tjera, besnikëria ndaj njëri tjetrit, nuk më pëlqen K.M, dispozitat fetare islame rregullojnë gjithçka skam nevojë për K.M, të ardhurat në jetën bashkëshortore janë të përbashkëta dhe ndahen me marrëveshje etj., ndërsa 96 të anketuarit tjerë kanë lënë të shprazur këtë pyetje ose kanë dhënë përgjigje jashtë temës dhe të pakuptimtë.



Grafikoni 15- Shkaqet për të cilat lidhet kontrata martesore

Në pyetjen se për cilat shkaqe lidhet kontrata martesore, janë përgjigjur gjithsej 450 të anketuar, prej të cilëve 151 të anketuar mendojnë që kontrata martesore lidhet që të mbrohen personat e pasurë nga lidhja e martesave për para, 159 të anketuar mendojnë që kontrata martesore lidhet që të rregullohen marrëdhëniet e përditshme të bashkëshortëve si: administrimi me pasurinë, menaxhimi me të ardhurat, mirëmbajtja e shtëpisë etj, ndërsa 140 të anketuar mendojnë që kontrata martesore lidhet që të zvoglohet numri i procedurave gjyqësore për ndarjen e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, të cilat janë të gjata, të mundimshme dhe me kosto të lartë.

Përfundimi dhe Rekomandimet

Në prag të euro integritimeve duhet që legjislacionet e shtetit tonë të harmonizohen me legjislacionet evropiane, të cilat prioritet kryesor i japin autonomisë së vullnetit, pavarësisht faktit a bëhet fjalë për marrëdhëniet familjare, detyrimore apo trashëgimore. Duke pasur parasysh faktin që martesë është akt individual e personal, rezultat i dëshirës dhe vullnetit të dy personave me vetëdije të plotë që dëshirojnë të lidhin martesë, është e patjetërsueshme atyre t'ju lejohet që vetë të përcaktohen se si do të rregullojnë marrëdhëniet e tyre familjare e pasurore.

Duke pasur në konsideratë atë që u tha më sipër, autori vjen në përfundim se legjislacioni me të cilën rregullohen marrëdhëniet juridiko pasurore të bashkëshortëve duhet të reformohet dhe të harmonizohet me legjislacionet evropiane, duke inkorporuar në legjislacion disa regjime subsidiare si dhe kontratën martesore e cila është e patjetërsueshme t'ju ofrohet bashkëshortëve si mundësi për rregullimin e marrëdhënieve juridiko pasurore, si mënyrë apo formë për modifikimin e regjimit ligjor apo nëpërmjet kontratës martesore bashkëshortët do mund të përcaktoheshin për ndonjërin nga regjimet subsidiare të cilat i ofron ligji.

Edhe pse kontrata martesore apo thënë më saktë termi “kontrat martesore” është i pa pranueshëm për numrin më të madh të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pasi që në momentin që dëgjohet termi kontratë martesore tek qytetarët krijohet apo shfaqet bindja se me kontratën martesore bëhet transferimi i marrëdhënieve bashkëshortore nga ato personale, emotive, shpirtërore në ato pasurore, pra theksi vendoset në interesin pasurorë. Ku edhe nga rezultatet e anketës mund të shihen mendimet që kanë qytetarët për kontratën martesore.

Duke u bazuar në hipotezat e parashtruara rezultojnë konkluzionet vijuese:

- Dispozitat ligjore të cilat rregullojnë marrëdhëniet juridiko pasurore të bashkëshortëve nuk janë të mjaftueshme si dhe duhet të bëhen ndryshime në dispozitat ligjore në fuqi - duke filluar me inkorporimin e kontratës martesore në legjislacion, parashikimin e regjimeve subsidiare, njohjen e institutit të banesës familjare, definim më i detajuar dhe sqarim më i mirë i dispozitave

ligjore, po ashtu më tepër rëndësi duhet ti kushtohet rregullimit të marrëdhënieve juridiko pasurore të partnerëve jashtëmartesorë duke përcaktuar se si dhe kur themelohet bashkësia jashtëmartesore, e kështu me radhë;

- Kontrata martesore ndikonë në uljen e shkurorëzimit pasi ajo u mundëson bashkëshortëve që të jenë të hapur ndaj njëri tjetrit që në fillim e lidhjes së tyre, të sigurojnë barazi dhe solidaritet ndërmjet tyre, duke hapur çdo kart që në fillim, e në këtë mënyrë eliminohen konfliktet në të ardhmen.
- Me vendosjen e regjimeve subsidiare në dispozitat ligjore apo inkorporimin e kontratës martesore në legjislacion, do të evitoheshin procedurat e gjata gjyqësore për shkurorëzim pasi që aspekti pasuror nuk do të ishte konfliktuoz, pasi që bashkëshortët ose bashkëshortët e ardhshëm do të rregullonin marrëdhëniet e tyre martesore po ashtu edhe ato pasurore sipas dëshirës apo vullnetit të tyre, në këtë mënyrë ato me kontratë martesore mund të përcaktojnë që në fillim se si do të ndahet pasuria në rast të shkurorëzimit, duke përcaktuar cilit se çka do ti takoj.
- Duke pasur parasysh që marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve janë specifike pasi që në mes këtyre palëve në këto marrëdhënie përveç lidhjes pasurore, të dretjave dhe detyrave, egziston edhe lidhja shpirtërore e emocionale, po ashtu është edhe ndërlidhja familjare pasi që në mënyrë indirekte ndikohet e tërë familja e cila është element thelbësor i shoqëris, duke pasur parasysh këtë nuk është në rregull që marrëdhëniet juridiko-pasurore të bashkëshortëve të rregullohen me po të njejtin ligji pra ligjin për pronësi dhe të drejta tjera sendore me të cilën rregullohen marrëdhëniet juridikio pasurore ndërmjet palëve të tjera, por ato duhet të rregullohen me ligjin për familje, pasi që këto marrëdhënie zhvillohen mbrenda martesës i cili është institut tepër i rëndësishëm i familjes.
- Në rastë të vazhdimëve të punimeve për përpilimin e Kodit Civil, do të ishte më e pranushme dhe më e arsyeshme që marrëdhëniet juridiko-pasurore të bashkëshortëve të përfshihen në kaptinën e cila do të rregullojë lëmin e të drejtës familjare.
- Me lidhjen e kontratës martesore, martesa nuk e humb efektin emotiv e personal dhe nuk merr karakter pasuror, por mungesa e informatave rreth

kontratës martesore shpien drejt ideve se me lidhjen e kontratës martesore martesa konkrete nuk do zgjasë shumë sepse, që në momentin e lidhjes së martesës bashkëshortët merren vesht për ndarjen. Mirëpo për të shuar këtë pesimizëm për kontratën martesore duhet që qytetarët të njoftohen më saktë se termi kontratë martesore nuk është akt që u vesh karakterin material marrëdhënieve bashkëshortore por përkundrazi kontrata martesore duhet të shihet me optimizëm pasi që ndihmon në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë në mes bashkëshortëve. Njerëzit shpesh e mendojnë kontratën martesore si mjet mbrojtës për persona shumë të pasur për të mbajtur kontrollin mbi pasurinë e tyre, por kjo është larg situatës kur kontrata martesore është vërtetë e dobishme. Situatat më poshtë vërtetojnë dobinë e kontratave martesore:

1. Bashkëshortët me kontratë martesore vendosin se a do të administrojnë me pronën bashkarisht apo çdonjëri vetë;
 2. Si do e ndajnë pasurin dhe borxhet e tyre pas përfundimit të martesës;
 3. A do ti takojë bashkëshortit një pjesë e pasurisë të cilën bashkëshorti tjetër e ka sjellur në martesë nga pasuria e veçantë;
 4. Vendosin se pasuria e fituar nga trashëgimia apo nga lojrat e fatit – a do konsiderohet pasuri e veçantë apo pasuri e përbashkët;
 5. Si do të ndahen punët e shtëpisë gjatë martesës;
 6. Vendosin se si do të paguhet shpenzimet për amvisëri gjatë martesës: A do të kontribuojnë të dy bashkëshortët për faturat apo do të ndahen faturat mes tyre;
 7. Si do të menaxhojnë kursimet, apo sa të holla do të ndahen për çdo muaj për kursime;
 8. Vendosin se si do të trajtohen fëmijët e sjellur në martesë nga një martesë e mëhershme; dhe
 9. Vendosin se si do të kujdesen për fëmijët e lindur në martesë në rastë të shkurorëzimit.
- Kontrata martesore konsiderohet si instrument që ndikon në zvogëlimin e konflikteve eventuale në të ardhmen pavarësisht asaj a në aspektin pasuror apo në administrimin e punëve të përditshme, pasi që marrja e kohës për të hartuar paraprakisht një marrëveshje të qartë mund të zvogëlojë konfliktet e mundshme në të ardhmen pasi vihen në dukje disa prioritete:

- “1.Diskutimet lidhur me marrëdhëniet pasurore nxisin transparencën dhe besimin ndërmjet bashkëshortëve të ardhshëm;
- 2.Fakti se marrëdhëniet pasurore janë të rregulluara me kontratë mund të zvoglojnë numrin e konflikteve pas pushimit të martesës dhe të ndikojnë në ndarje më të qetë;
- 3.Me lidhje ne kontratës martesore bashkëshortët evitojnë procedurat gjyqësore të cilat janë të gjata e të mundimshme, prej të cilave së paku njëra prej palëve del e pakënaqur;
- 4.Shmangen shpenzimet e larta gjyqësore dhe rruhet vlera e pasurisë;
- 5.Kontrata martesore ndihmon edhe sigurinë juridike, qartësinë në marrëdhëniet e ndërsjellta të bashkëshortëve, në radhë të parë ato pasurore e më pas edhe ato personale etj.”²⁰⁶

- Po ashtu edhe mosnjohja e dispozitave ligjore konsiderohet si një ndër shkaktarë kryesorë për problemet juridiko-pasurore të bashkëshortëve, pasi që ata nuk i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre me të cilat ngarkohen me lidhjen e martesës, nuk janë të informuar për regjimin ligjorë, për pasurin e tyre të përbashkët e të veçant, për atë se si ndahet pasuria dhe kush në cilat situata mund të fitojë më shumë, për atë se si dhe nga cili bashkëshortë bëhet administrimi dhe disponimi me pasurin e përbashkët, po ashtu këto vërtetohen edhe në bazë të rezultateve të fituara nga anketa, ku mbi 80% e të anketuarve janë deklaruar se do të kishin dashur të kenë më shumë informacione për regjimin pasurorë – pasuritë martesore se çka, sa dhe kujt i takon.

Është e ditur se asnjëri nuk hynë në martesë duke menduar se ajo mund të përfundojë me shkurorëzim, por realiteti është se kohëve të fundit është rritur numri i martesave që përfundojnë me shkurorëzim, e cila verifikohet nga statistikat ku në vitin 2007 për 1000 martesë të lidhura 91.5 janë shkurorëzuar; ndërsa në 2017 nga 1000 të lidhura 144.7 janë shkurorëzuar.²⁰⁷ Kjo paraqet një numër goxha të madhë për mentalitetin dhe traditën e shoqërisë sonë, dhe për këtë arsye paraqitet nevoja për ndryshime në dispozitata që rregullojnë marrëdhëniet juridiko pasurore të

²⁰⁶ Emine Zendeli: Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve I – 2017, fq.16

²⁰⁷ Women and Men in North Macedonia, Skopje 2019 - Publisher: The State Statistical Office, Skopje, Dame Gruev 4

bashkëshortëve, që të mund të ndikohet në ndaljen dhe zvoglimin e këtij trendi të rritjes së shkurorëzimeve.

Rekomandohet që të krijohen dy regjime subsidiare përkrahë regjimit ligjor, pra 1.Regjimi i pasurisë së ndarë dhe 2.Regjimi i bashkësisë së vlerës së shtuar, gjatë përpilimit të këtyre dy regjimeve mund të meret si shembull sistemi Francez apo sistemi Gjerman, bashkëshortëve t'ju jepet mundësia që vetë të përcaktohen për ndonjërin nga regjimet që kanë në dispozicion.

Ose së paku bashkëshortëve t'ju jepet mundësia që të lidhin kontratë martesore, me të cilën do mundenin ta modifikonin regjimin ligjor, ku më së paku do të përcaktonin pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët. Po ashtu me kontratë martesore do të kishin mundësi që të ndryshojnë statusin e sendeve të caktuara të cilat edhe përkundër faktit që duhet të regjistrohen si pjesë e pronësisë së përbashkët, ata sende do të regjistrohen apo konsiderohen si pronësi e veçantë e vetëm njërit prej tyre. Për këtë rekomandim duhet të meret parasysh legjislacioni Kroat ku në Ligjin për familje e rregullon në mënyrë shumë të qartë kontratën martesore.

Rekomandim i fundit është që dispozitata me të cilat rregullohen marrëdhëniet juridiko pasurore të bashkëshortëve të përfshihen apo të vendosen në “Ligjin për Familje” e jo në “Ligjin për pronësi dhe të drejta tjera sendore”, ose në rastë të përpilimit të Kodit Civil të përfshihen apo të vendosen në pjesën e të drejtës familjare.

Bibliografia

Tekste, monografi, artikuj

1. Sonila Omari - *“E drejta familjare”*, Tiranë, 2012
2. Hamdi Podvorica, - *“E drejta e Familjare”* (Botimi i IV), Prishtinë, 2011
3. Dejan Micković dhe Angel Ristov, - *“Семејно право”*, Shkup, 2015.
4. Liljana Spiroviq Terpenovska, Dejan Micković dhe Angel Ristov, - *“Семејно право”*, Shkup, 2013
5. Marien Bler dhe Merl H. Vajner - *“Меѓународно семејно право: конвенции, статуту и регулаторни материјали”*, 2009.
6. Dominik Buro dhe Horacia Muri Bar, - *“Меѓународно приватно право”*, Том 2 - 2011
7. Emine Zendeli, - *“Marrëdhëniet Juridiko-Pasurore Bashkëkohore të Bashkëshortëve”*, Tetovë, 2017
8. Gorgiev Dimitar - *„Основи На Имотно Право,, , 1977.*
9. Jean-Louis Halperin - *“Historia e së drejtës private franceze që nga 1804”*, Paris 2001
10. Abdulla Aliu dhe Haxhi Gashi, - *“E drejta familjare”*, Prishtinë, 2007
11. Abdulla Aliu, - *“E drejta civile”*, Prishtinë, 2013
12. Abdulla Aliu, - *“E drejta sendore”*, Prishtinë, 2014
13. Arta Mandro-Balili, - *“E drejta Familjare”*, Tiranë, 2009
14. Gavella Nikola; Josipović Tatjana; Gliha Igor; Belaj Vlado; Stipković Zlatan; - *“Stvarno parvo”*, Zagreb 2007.
15. Obren Stanković dhe Miodrag Orlić – *“Stvarno parvo”*, 2014
16. Miloš Živković – *“Stvarno parvo”*, 2009
17. Emine Zendeli, Adnan Jashari - *„Overview about the property regime of spouses in the German legal system”* , 2013.
18. Emine Zendeli - *“Modelet e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në sistemin juridik francez”*, 2013.
19. Emine Zendeli, Nagip Zendeli - *“Contraction property regime of spouses - Comparative Overview”* 2014.
20. Emine Zendeli, N. Zendeli – *“Perspectives Of Regulation Of Property Relations Of Spouses In The Legal System Of The Republic Of Macedonia”* 2014.

21. Emine Zendeli - „*Unification of norms on property regime of the spouses at the European level*” 2015.
22. Emine Zendeli – “*The Right To Dispose Of An Item Of Property Acquired In Marriage*” 2016.
23. J. von Staudingers – “*Bazat e së drejtës civile*”, Berlin 2008
24. Giovanni Bonilini – “*Manual i së drejtës familjare*”, Tiranë 2005
25. Kiril Çavdar, Cvetanka Silanoska-Kostadinovska – “*Zakon za Semejstvoto - Komentari, Sudska Praktika, Predmeten regishtar, Primeri za praktična primena, Pridružni propisi i literatura*”, Skopje 2013
26. Nerxhivane Dauti – “*E drejta e detyrimeve*”, Prishtin 2001
27. Blerina Dodaj – “*Kontrata E Martesës, Zhvillimi Dhe Aplikimi I Saj Në Republikën E Shqipërisë*”, Tiranë 2019
28. Eniana Qarri: “*Kontrata Martesore*” – Tiranë, 2014
29. Albana Metaj-Stojanova - “*Regjimet Pasurore Martesore Jo Me Kontratë. Rasti I Republikës Së Maqedonisë Së Veriut Me Fokus Krahasues Me Legjislacionin Shqiptar*”, Tiranë 2019
30. Bojan Pajtić – “*Bračni Imovinski Ugovor*”, Novi Sad 2008
31. Hadživasilev, Mile – “*Semejno pravo*” Shkup 1990
32. Marina Janjić-Komar; Radoje Korać; Zoran Ponjavić – “*Porodično pravo*” Beograd 1999
33. Sejjid Sabik - “*Fikhus Sunne*” – Sarajevë, 2008
34. Branka Rešetar – “*Matrimonial Property in Europe: A Link between Sociology and Family Law*”, 2008
35. “Përmbledhje e punimeve të konferencës shkencore të studentëve të fakulteteve të drejtësisë me temë: “E drejta, drejtësia dhe sfidat e reformimit të sistemit juridik në epokën e globalizimit”” - Konferencë me karakter rajonal - ISSN 2545-4943, Tetovë 2018

Akte ligjore, Konventa, Direktiva

1. “*Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*” Numër 08-4642/1 - 17 nëntor 1991

2. “*Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore*” (Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.18/ 05 Mars 2001) – Tekst i konsoliduar.
3. “*Ligji për familje*” (Gazeta Zyrtare e RMV, Nr.80/ 22 Dhjetor 1992) – Tekst i konsoliduar.
4. “*ОСНОВЕН ЗАКОН ЗА БРАКОТ - 1946*” ((„Службен лист на ФРНЈ”, бр. 29/46) и неговите измени и дополненија објавени во „Службен лист на Социјалистичка Федеративна Република Југославија ”, бр. 36/48, 44/51 и 18/55 и
5. “*ОСНОВЕН ЗАКОН ЗА БРАКОТ - 1965*” во пречистен текст „Службен лист на Социјалистичка Федеративна Република Југославија ”, бр. 28/65,).
6. “*Закомот за брак*” – 1973 (Создавање на Сл. весник / СРМ / 1973 / 35 - Закон за бракот)
7. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950.
8. Kodi Civil Gjerman (“**BGB**” 01/Janar/1900 – Libri katërt / E drejta Familjare).
9. Kodi Civil Francez (“**Code Napoléon**” 21/Mars/1804 – Titulli pestë / Martesa).
10. Legjislacioni Angelz, e drejta anglosaksone, Ligjet i Bashkimit Evropian.
11. Married Women’s Property Act, 1882 - England.
12. Family Law Act, 1996 - England.
13. Matrimonial Causes Act - England.
14. Universal Declaration of Human Rights 1948
15. Kodi Civil Sërb 1844

Burime nga interneti

1. <http://www.slvesnik.com.mk/>
2. <http://pravo.org.mk/>
3. <https://akademik.mk/>
4. https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/
5. <https://www.justia.com/family/marriage-prenuptial-agreements/>
6. http://wiki.clicklaw.bc.ca/index.php?title=Marriage_Agreements
7. <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/Gender2019.pdf>
8. <http://www.legislation.gov.uk>
9. <http://www.echr.coe.int/>
10. <http://ec.europa.eu/>

11. <http://www.mywedding.com/wedding-ideas/advice/prenup-agreement-the-pros-and-cons/>
12. <https://www.lawteacher.net/free-law-essays/contract-law/marriage-contracts-in-form-of-marriage-agreements-law-contract-essay.php>
13. https://en.wikipedia.org/wiki/Prenuptial_agreement
14. <https://family.findlaw.com/marriage/pros-and-cons-premarital-agreements-prenuptials.html>
15. https://www.academia.edu/29400667/Kontrata_Martesore..docx
16. <https://www.nolo.com/legal-encyclopedia/prenuptial-agreements-what-law-allows-30283.html>
17. <https://www.degruyter.com/downloadpdf/j/iclr.2016.16.issue-2/iclr-2016-0026/iclr-2016-0026.pdf>
18. <https://stepstojustice.ca/questions/family-law/what-is-a-prenup-or-marriage-contract>
19. [https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/1-590-4465?transitionType=Default&contextData=\(sc.Default\)&firstPage=true&bhcp=1](https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/1-590-4465?transitionType=Default&contextData=(sc.Default)&firstPage=true&bhcp=1)
20. <https://institutedfa.com/Prenuptial-Agreements-Marriage-Contracts-1/>
21. <https://www.nolo.com/legal-encyclopedia/prenuptial-agreements-overview-29569.html>
22. <https://www.clarionsolicitors.com/blog/property-and-divorce-matrimonial-property-regimes>
23. <https://www.co-oplegalservices.co.uk/media-centre/articles-may-aug-2017/matrimonial-and-non-matrimonial-assets/>
24. <http://www.coupleseurope.eu/en/united-kingdom/topics/5-what-are-the-consequences-of-divorce-separation>
25. https://en.wikipedia.org/wiki/Married_Women%27s_Property_Act_1870
26. https://en.wikipedia.org/wiki/English_law
27. <http://www.coupleseurope.eu/en/united-kingdom/topics/3-how-can-the-spouses-arrange-their-property-regime>
28. https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/index.html#gl_p4886
29. <https://www.mekulipress.com/disa-karakteristika-te-sistemit-juridik-anglez-me-theks-te-vecante-e-drejta-procedures-penale/>
30. <http://www.coupleseurope.eu/en/united-kingdom/topics/2-is-there-a-statutory-matrimonial-property-regime-and-if-so-what-does-it-provide/>
31. <http://www.ejtn.eu/Documents/Zupan%20The%20interplay%20between%20the%20Regulations%20on%20property%20regime.pdf>

32. https://www.familylaw.co.uk/news_and_comment/EU-Matrimonial-Property-Regime-Regulation
33. https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/civil-justice/family-law/property-international-couples-marriages-and-registered-partnerships_en
34. <https://ilirianews.mk/stojanoviq-grate-myslimane-ne-ish-jugosllavi-kane-pasur-me-shume-te-drejta-sesa-serbet-sot-ne-serbi/>
35. <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=8911>
36. http://pfk.uklo.edu.mk/portal/upload/magisterski/JovanaAdzioska_kic_mart19.pdf
37. https://www.researchgate.net/publication/276230358_Critiques_of_Serbian_Civil_Code_of_1844_with_special_reference_to_provisions_on_zadruga
38. <http://www.fao.org/3/v3960e/v3960e03.htm>
39. https://en.wikipedia.org/wiki/Matrimonial_regime
40. https://wiki.p2pfoundation.net/Common_Property_Regime
41. <https://www.ijser.org/paper/Overview-about-the-property-regime-of-spouses-in-the-German-legal-system.html>
42. https://www.researchgate.net/publication/311207907_Regjimet_pasurore_martesore_ne_t_e_drejte_shqiptare
43. <https://drive.google.com/file/d/1nsAcYcuUigJM8MIbNtDxH2MUBsCrTiBw/view>

Shtojcë

Anketë mbi regjimin pasuror të bashkëshortëve dhe kontratën martesore

Ky pyetësor është pjesë përbërëse e punimit të magjistraturës **“REGJIMI PASUROR I BASHKËSHORTËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE NË TË DREJTËN EVROPIANE”**. Duke pasur parasysh që sot ndodhemi në epokën e kapitalizimit, çdo individ gëzon kapitalin e tij. Më saktë çdonjëri nga bashkëshortët ka pasurinë e vetë me të cilën administron dhe disponon vetë. Për këtë shkak rregullimi i marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve ka rëndësi të veçantë, marë parasysh edhe jetën dinamike ku të drejtat pronësore apo pasuria e bashkëshortëve mund të ndryshojnë në çdo moment, sepse numri më i madh i tyre zhvillojnë veprimtari të ndryshme që sjellin të ardhura financiare jo të njëjta.

Ju lutemi që të plotësoni anketën anonime të cilën mund të gjeni më poshtë. Pergjigjet e juaja do të kontribuojnë në përmisimin e kualitetit të këtij hulumtimi shkencor në lidhje me regjimet pasurore dhe kontratën martesore në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ju faleminderit!

Autor: **Bardhyl Limani**, Student i ciklit të dytë,

Fakulteti Juridik – E drejta civile, Universiteti i Evropës Juglindore

Të dhëna për të Anketuarin:

- **Mosha**

- a) Deri 18
- b) 18-29
- c) 30-45
- d) Mbi 45

- **Gjina**

- a) Femër
- b) Mashkull

- **Statusi Martesor**

- a) I/E Martuar

- b) I/E Shkurorëzuar
- c) Në Lidhje
- d) Beqarë/e

Anketa

Bardhyl Limani

- 1. A keni ndëgjuar ndonjëherë për regjimin pasuror të bashkëshortëve?**
 - a) Po
 - b) Jo

- 2. A jeni të informuar se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ndahet përgjysë në mes burrit dhe gruas (50% i takon burrit dhe 50% i takonë gruas)?**
 - a) Po
 - b) Jo

- 3. Në cilat nga situatat e mëposhtme mendoni se njërit bashkëshort do ti takojë më tepër se gjysa e pasurisë?**
 - a) Kur është i punësuar vetëm njëri nga bashkëshortët, ndërsa tjetri kujdeset për fëmijët dhe punët e shtëpisë
 - b) Kur janë të punësuar të dy, mirëpo njëri realizon të hyra më të mëdha
 - c) Vetëm në situatën kur njëri nga bashkëshortët do mund ta dëshmojë se ka fituar dhe ka sjellur më shumë të ardhura në familje

- 4. A jeni të interesuar të dini se cilat pjesë të pasurisë martesore u takojnë juve?**
 - a) Po, do kisha dashur më tepër informacione lidhur me pasurin martesore
 - b) Jo, nuk jam e interesuar

- 5. Si mendoni, kush menaxhon me pasurinë gjatë martesës?**
 - a) Burri
 - b) Gruaja
 - c) Burri dhe Gruaja bashkërisht

- 6. A ju ka ndodhur që bashkeshorti/ja të disponojë me pasurinë e përbashkët pa lejen tuaj, ose a keni ndëgjuar ndonjë rast të tillë?**
- a) Po, më ka ndodhur që bashkëshorti/ja të disponoj me pasurinë pa lejen time
 - b) Jo, nuk më ka ndodhur një rast i këtillë, e as që kam ndëgjuar ndonjëher për ndonjë rast të këtillë
 - c) Po kam dëgjuar se ka pasur raste të këtilla, në rrethin tim të afërt
- 7. A keni dëgjuar ndonjëherë për kontratën martesore (Ku në shumë shtete bashkëshortët kanë mundësi që me kontratë të përcaktojnë se cilat sende do të përfshihen në pasurinë e përbashket dhe cilat në pasurinë e veçantë, kush do të administroj me pasurinë etj)?**
- a) Po
 - b) Jo
- 8. A e dini nëse është e lejuar lidhja e kontratës martesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?**
- a) Po, është e lejuar
 - b) Jo, nuk është e lejuar
- 9. A mendoni se me lidhjen e kontratës martesore, marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve mund të transferohen nga ato emocionale(emotive) në pasurore. Me arsye se, që në momentin e lidhjes së martesës fokusi është në ndarjen e pasurisë?**
- a) Po, zbehet lidhja emotive, pasi i jepet më tepër rëndësi aspektit pasuror dhe kjo reflekton në mosbesim në mes bashkëshortëve
 - b) Jo, pasi me kontratën martesore rregullohen shumë aspekte gjatë martesës, jo vetëm çështja pasurore
- 10. Ju a do të kishit lidhur një kontrat martesore ?**
- a) Po
 - b) Jo

11. Nëse JO, cilat janë arsyet që mos të lidhni kontratë martesore?

12. Sipas jush për cilat shkaqe lidhet kontrata martesore?

- a) Që të mbrohen personat e pasur, nga lidhja e martesave për para
- b) Që të rregullohen marrëdhëniet e përditshme të bashkëshortëve si:
administrimi me pasurinë, menaxhimi me të ardhurat, mirëmbajtja e
shtëpisë, etj
- c) Që të zvoglohet numri i procedurave gjyqësore për ndarjen e pasurisë
ndërmjet bashkëshortëve, të cilat janë të gjata, të mundimshme dhe me
kosto të lartë